



Studim mbi Vetëqeverisjen Lokale Llogaridhënëse Transparente dhe Përgjegjëse (LOTOS)

IPA TAIB 2009 Programi Nacional

Projekti: Shkëmbimi i praktikave më të mira të BE-së në Monitorimin e atnikorrupsionit në nivelin lokal

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

Qendra për hulumtime dhe krijim të politikave

1/1/2014

Autorët: Dr. Marija Risteska, Mr. Aleksandar Cekov



Ky publikim është realizuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij publikimi janë përgjegjësi e vetme të Qendra për hulumtime dhe hartimin e politikave dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merren si reflektim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

Ky studim analizon rezultatet e hulumtimit LOTOS 2014, një shqyrtim i parë sistematik i zbatimit të parimeve të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Hulumtimi i LOTOS 2014 ka qenë i zbatuar nga partnerët e QHKP-së (CRPM): Qendra për Zhvillim dhe Integrim Evropian (CERI), Manastir – Diogen Haxhi Kosta Milevski, hulumtues në rajonin e Pellagonisë

Organizata Edukative-Humanitare - EHO Shtip - Beti Pejeva dhe Julijana Davkova, hulumtuese në rajonet: Jug-lindor dhe Lindor

Shoqata për Zhvillim Lokal Rural (ZLRR) Bogovinë – Rudina Pasholi, hulumtuese në rajonin e Pollogut

Shoqata qytetare “Bujrum”, Kriva Palankë – Gabrijela Boshkov, hulumtuese në rajonin Veri-perëndimor

Agjencia lokale për zhvillim (LDA), Strugë – Elena Mihajlovska, hulumtuese në rajonin Jug-perëndimor

Grupacioni ekologjik Grin Pauer (Green power), Veles - Igor Smilev, hulumtues në rajonin e Vardarit

Ekipi i QHKP-së për hulumtimin LOTOS 2014 përbëhej nga Petranka Miladinova Delova, Martin Pezijareski dhe Qendresa Sulejmani, me ndihmë administrative nga Zharko Cvetkovski dhe Bozhana Risteska.

Përmbajtja

Kapitulli i parë – Hyrje.....	9
Pyetjet hulumtuese	9
Korniza konceptuale	10
Kuantifikimi i indikatorëve	11
Metodat e hulumtimit	12
Kufizimet në metodat e hulumtimit	13
Kapitulli i dytë - Përmbledhje e rezultateve të LOTOS-it	14
Kapitulli i tretë – Përmbledhja e rezultateve për dimensionin 1 - transparenca lokale	21
Kapitulli i katërt – dimensionin 1 i dytë i qeverisjes së mirë – participimi	26
Kapitulli i pestë – Përmbledhje e rezultateve në dimensionin 3 - administratë lokale përgjegjëse dhe llogaridhënëse	31
Kapitulli i gjashtë - Dimensionin 1 i katërt i qeverisjes së mirë – Llogaridhënie, efektshmëri dhe efikasitet	33
Konkluzion.....	37
Kapitulli i shtatë - praktikat e mira në nivelin lokal	39
Dimensionin 1 - transparenca lokale	39
Dimensionin 2 – pjesëmarrja	39
Dimensionin 3–përgjegjëshmëria në nivelin lokal	40
Dimensionin 4 – Llogaridhënia dhe efektshmëria në nivelin lokal	41
Analiza e të dhënave sipas rajoneve	43
Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar të Shkupit.....	45
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	45
2. Rezultatet e hulumtimit	47
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Shkupit	47
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve.....	49
2.3 Rezultatet sipas indikatorëve	54
Rekomandimet	55
Rekomandimet për komunat	56
Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar juglindor	61
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	61
2. Rezultatet e hulumtimit	63
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin juglindor	63
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve	65
Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar të Pellagonisë	73
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	73
2. Rezultatet e hulumtimit	74
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Pellagonisë	74
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve	76

Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar të Pollogut	83
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	83
2. Rezultatet e hulumtimit	84
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Pollogut	84
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve	86
Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar verilindor	92
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	92
2. Rezultatet e hulumtimit	93
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin verilindor	93
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve	95
Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar të Vardarit	101
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	101
2. Rezultatet e hulumtimit	103
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Vardarit	103
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve	105
Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar lindor	110
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	110
2. Rezultatet e hulumtimit	112
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin lindor	112
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve	115
Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar jugperëndimor	121
1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave	121
2. Rezultatet e hulumtimit	122
2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin jugperëndimor	122
2.2 Rezultatet sipas dimensioneve	124
Bibliografia	131

Kapitulli i parë – Hyrje

Republika e Maqedonisë konsiderohet të ketë kornizë ligjore dhe institucionale më të përparuar kundër korrupsionit nga të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Kjo është relevante për vullnetin dhe angazhimin politik të shprehur publikisht për të luftuar korrupsionin. Strategjia vendit kundër korrupsionit është zhvilluar në bazë dhe të përvojave të Rumanisë në luftën për të ndaluar korrupsionin dhe është lehtësuar përmes kampionit të saj në luftën kundër korrupsionit, Deputeti aktual Monika Makovej që ka vepruar si këshilltar i Kryeministrit për këtë çështje. Në 2011, qasja e vendit kundër korrupsionit është përmirësuar me miratimin e Programit të ri Shtetëror për Parandalimin dhe Shtypjen e Korrupsionit dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesave (2011-2015), i cili pasoi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi konfliktin e interesave (në 2009). E-geveria është promovuar si një mjet për të rritur transparencën dhe për të parandaluar korrupsionin e përmasave të vogla. Kultura për zero tolerancë ndaj korrupsionit kohët e fundit është fuqizuar përmes shqiptimit të dënimeve të rrepta për veprat penale që lidhen me korrupsionin, por edhe aktivitetet e organizatave të ndryshme monitoruese (watch-dog organizations) dhe ngritjes së vetëdijes publike.

Në vend gjithsej 102 institucioneve dhe organizatave iu është dhënë mundësia për të zbatuar, monitoruar dhe raportuar mbi politikën anti-korrupsion (SEELDI, 2014). Megjithatë, komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) mbetet të jetë organi kryesor për zbatim. Që nga viti 2009, kompetencat e KSHPK-së u forcuan me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi konfliktin e interesave duke futur detyrimin e zyrtarëve të paraqesin një deklaratë mbi konfliktin e interesave në KSHPK dhe sigurimin që KSHPK të zbatojë sanksione kundërvajtëse për mosrespektimin e ligjit. Si rezultat, në 2014 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nisi procedurat për kundërvajtje kundër 32 gjykatësve për dështimin për të paraqitur deklaratat e interesit të kërkuara me ligj.

Kompetenca të rëndësishme për parandalimin dhe dënimin e korrupsionit kanë Enti Shtetëror i Revizionit, policia financiare, Drejtoria e të hyrave publike dhe gjykatat. Megjithatë, mungesa e IT lidhjes ndërmjet gjykatave dhe shërbimit të prokurorisë dhe mungesa e një regjistri qendror të zyrtarëve publikë, konsiderohet ta pengojë punën mbikëqyrëse të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.

Përpjekjet për të luftuar korrupsionin kanë rezultuar në renditje më të mirë të vendit mbi indeksin e perceptimit të korrupsionit. Në dhjetë vitet e fundit vendi ka lëvizur nga vendi i 103 në IPK në vitin 2005 kur fitoi statusin e vendit kandidat për në BE, në vendin e 64 në IPK në vitin 2015. Gjithashtu, sistemi i matjes së Korrupsionit ka progres në Maqedoni, ashtu që vendi ngrihet në rangun e dytë në rajonin e Ballkanit Perëndimor (përfshirë Turqinë) në aspektin e të anketuarve të cilët i janë nënshtruar presionit për t'iu dhënë ryshfet zyrtarëve administrativë. Kjo tregon se ka "qëndrimet shoqërore mbizotëruese ndaj integritetit"².

Pyetjet hulumtuese

Qytetarët nuk kanë traditë për të monitoruar dhe mbajtur qeverinë përgjegjëse, ndonëse në vitin e kaluar organizatat e shoqërisë civile kanë rritur aktivitetet e tyre monitoruese, veçanërisht në nivelin lokal. Në vitin 2014 ka pasur një iniciativë nga organizatat e shoqërisë civile për monitorimin e transparencës së buxhetit në nivelin lokal. Në lidhje me këtë, studimi i LOTOS-it

¹ Raporti i progresit i KE-së për vitin 2014

² SEELDI (2014), Anti-korrupsioni – faza e ardhshme: Vlerësim i bërë për Evropën Jug-Lindore

mbi transparencën, llogaridhënien, përgjegjësinë në nivelin lokal është shqyrtimi i parë sistematik se si parimet e qeverisjes së mirë të përcaktuara me ligj janë vënë në praktikë nga komunat e Maqedonisë të dala nga qytetarët përmes ndërmjetësve të tyre -OJQ-ve.

Pyetja kryesore hulumtuese në LOTOS 2014 është: deri në cilën masë parimet e qeverisjes së mirë, veçanërisht ato për transparencë, përgjegjshmëri, sinqeritet, pjesëmarrje, llogaridhënie dhe efektivitet, implementohen në nivel lokal në Maqedoni?

Përveç kësaj, ekipi analitik i QHKP-së ka përcaktuar këto detyra me hulumtim:

- T'i identifikojë sfidat kryesore në zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë
- T'i identifikojë praktikatat më të mira në zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në nivel lokal
- Ta stimulojë shkëmbimin e praktikave më të mira në mes të komunave për të përmirësuar cilësinë e qeverisjes së mirë në Maqedoni
- Të sigurojë të dhëna të krahasueshme në fushën e qeverisjes së mirë në nivel lokal që të mund të përdoren të njëjtat në një krahasim ndërmjet komunave.

Kjo metodologji është e bazuar në përvojën kroate, e përshtatur për kontekstin maqedonas me qëllim që të përfshihen më shumë dimensione të qeverisjes së mirë në nivel lokal në krahasim me hulumtimin e zbatuar në Kroaci.

Korniza konceptuale

Hulumtimi është bazuar në konceptin e qeverisjes së mirë e cila në kuptimin e saj administrativ paraqet një "shërbim publik efikas, të pavarur, llogaridhënës dhe të sinqertë, të pa korruptuar dhe të përkushtuar për të mirën publike" (Leftwich, 2000: 121). Qeverisja e tillë siguron stabilitet dhe parashikueshmëri të procedurave, si dhe një sistem funksional të kontrollit dhe balancimit, duke siguruar kështu besimin e qytetarëve dhe bizneseve në sistemin e përgjithshëm të qeverisjes.

Parimet e qeverisjes së mirë ashtu si janë definuar me Dokumentin e Bardhë të BE-së për Qeverisjen (2001) përfshijnë sinqeritet, participim, llogaridhënie, efikasitet dhe koherencë. Duke shtuar transparencën dhe përgjegjësinë si parime shtesë, ata në fakt përmbledhen në realizimin e demokracisë në praktikë (Miošić-Lisjak, 2005: 19-20).

Vlerësimet e cilësisë së demokracisë gjithnjë e më shumë mbështeten në gjykimet cilësore, dhe si të tilla janë të ndjeshëm ndaj faktorëve kontekstualë (kulturës, përvojës, pritjeve të qytetarëve, etj), e që është dhe arsyeja pse ndërtimi i treguesve dhe interpretimi i rezultateve më së miri është ti lihen njerëzve që jetojnë dhe punojnë në vend (Beetham, 1994: 41). Në këtë kuptim, indekset e tilla janë në asnjë mënyrë "objektiv" në kuptimin pozitivist, por në të vërtetë është "subjektivizmi" i tyre që iu mundëson studiuesve për të vendosur kriteret e duhura sipas të cilave do ti gjykojnë sistemet e tyre politike (ibid.).

Në rastin e Maqedonisë, ekipi hulumtues ka vendosur që parimet e mëposhtme ishin më të rëndësishme për vlerësimin e funksionimit të demokracisë në nivelin lokal në Maqedoni: sinqeriteti dhe transparenca, pjesëmarrja e qytetarëve, përgjegjësia, efektshmëria, efikasiteti dhe llogaridhënia e qeverive lokale. Hulumtimi është dizajnuar në kuadër të skemës së grantit kundër korrupsionit të zbatuar në Maqedoni, me supozimin themelor që një shoqëri e vërtetë demokratike është ajo ku nuk ka korrupsion dhe që parimet e zgjedhura veprojnë si një pengesë për praktikatat korruptive nga ana e zyrtarëve.

Këto parime pastaj janë operacionalizuar përmes një sërë indikatorësh që sipas ekipit hulumtues

janë të rëndësishme për Maqedoninë në nivelin aktual të zhvillimit të saj demokratik. Vetë indikatorët janë një kombinim i praktikave të përcaktuara me ligj dhe ato që janë "mbi dhe përtej" kërkesave minimale ligjore, me këto të fundit duke vepruar si një mekanizëm motivimi për ata që akoma nuk i zbatojnë ato dhe si një mekanizëm të dobishëm për ata që tanimë i promovojnë praktikatat më të mira të qeverisjes së mirë në nivelin lokal.

Kuantifikimi i indikatorëve

Siç mund të shihet nga lista e indikatorëve, indikatorët janë të grupuara në katër dimensionet e qeverisjes së mirë, dhe çdo indikator sjell pikë të caktuara. Indikatorët e papërmbushur sjellin 0 pikë, ndërsa indikatorët e përmbushur sjellin 1 pikë, ose në disa raste, 2 pikë. Nëse indikator i sjell 1 ose 2 pikë, varet nga fakti nëse përmbushja e tij është një detyrim ligjor (1 pikë), ose përmbushja e tij është rezultat i praktikave të mira në këtë fushë (2 pikë). Nëpërmjet këtij sistemi të dhënies së pikëve, ekipi analitik donte t'i njihte përpjekjet e komunave që shkojnë një hap më tej në zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në nivel vendor, për dallim nga zbatimi strikt të detyrimeve ligjore.

Sipas pikëve të dhëna për secilin indikator, çdo dimension ka numrin maksimal të pikëve që komuna mund t'i fitojë. Kështu, në dimensionin e parë komunat mund të fitojnë 44 pikë maksimale, në dimensionin e dytë - 22 pikë, në të tretin - 14 dhe në të katërtin -8 apo gjithsej 88 pikë në të gjitha katër dimensionet. Në bazë të pikëve të fituara në çdo dimension, ekipi analitik e ka llogaritur përqindjen e suksesit në çdo dimension, përkatësisht pikët e fituara të pjesëtuara me pikët maksimale të mundshme në këtë dimension.

Pastaj, ekipi analitik i QHKP-së ka përdorur mendime në mënyrë që të sigurojë vlera të ndryshme të rezultateve për secilin nga katër dimensionet. Siç tregoi hulumtimi i LOTOS-it, shumica e parimeve të qeverisjes së mirë ligjërisht detyruese kanë të bëjnë me dimensionin e parë - transparencën-të cilën ekipi vendosi ta vlerësojë me 15%, për dallim nga dimensionin 2 dhe 3 (participimi, gjegjësisht përgjegjësia), të cilat u vendos të vlerësohen me 25% në rezultatet e përgjithshme për studimin e LOTOS-it. Në këtë mënyrë kemi dëshiruar që ta forcojmë konkurrencën mes pushteteve lokale për çështjet si participimi i qytetarëve në hartimin e politikave lokale dhe krijimin e mekanizmave dhe vënien e tyre në praktikë për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve në nivelin lokal. Më në fund indikatorët për efektshmëri, efikasitet dhe llogaridhënie nuk janë të shumtë në numër (p.sh. 6 indikatorë prej gjithsej 74), por që janë vlerësuar më së larti në studimin e LOTOS-it - ato përbëjnë 35% të rezultatit përfundimtar për secilën komunë meqë këta indikatorë zbulojnë përpjekjet e komunës për të ofruar më shumë shërbime me më pak para dhe japin llogari për punën e tyre para qytetarëve. Qasja gjithashtu përpiqet të bëjë balancimin midis indikatorëve që përforcojnë inputin (të dhënat) dhe ato që fokusohen më shumë mbi legjitimitetin outputit (e prodhimit) të qeverisjes së pushtetit vendor. Perspektiva e inputit fokusohet në atë nëse interesi i qytetarëve merret parasysh kur merren vendimet, ndërsa perspektiva e outputit fokusohet në atë nëse vendimet që janë zbatuar dhe shërbimet që janë ofruar janë perceptuar të jenë në interes të qytetarëve (Risteska, 2013).

³ Janë në dispozicion në <http://lotos.crpm.org.mk/>

Metodat e hulumtimit

Gjatë kërkimeve për përpunimin e studimit të LOTOS-it janë grumbulluar të dhëna primare dhe sekondare. Të dhënat sekondare janë mbledhur përmes kërkimeve në zyrë. Hulumtuesit janë mbështetur në të dhënat arkivore, të dhënat administrative, raportet narrative, ligjet, aktet nënligjore, statutet, rregulloret, statistikat zyrtare, strategjitë, programet lokale, dhe Planet e Veprimtë që janë në dispozicion në faqet e internetit të komunës, në gazetën zyrtare të komunës dhe/ose të fituara nga komuna përmes kërkesës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.

Të dhënat primare janë mbledhur duke përdorur metoda të shumta: (i) intervistë ballë-për-ballë me nëpunësit civilë që punojnë në vetëqeverisjet lokale dhe që janë subjekt i hulumtimit pilote; (ii) studim për grumbullimin e të dhënave sasiore nga vetëqeverisjet lokale duke përdorur një pyetësor anketues; (iii) blerje të fshehta për të matur cilësinë e shërbimit, ose pajtueshmërinë me rregulloren, apo për të mbledhur informacione konkrete në lidhje me shërbimet dhe informacione që komuna është duhet të ofrojë; dhe (iv) kërkim në terren që lejon kontroll të zastit (në vend të ngjarjes) për disponueshmërinë e shërbimeve, informacionet dhe dokumentet relevante të komunës.

Hulumtimi është kryer nga tetë hulumtues, secili prej tyre i vendosur në një nga tetë rajonet administrative të Maqedonisë: të Lindjes, të Veri-Perëndimit, Pellagonisë, Pollogut, Shkupit, Jug-Lindjes, Jug-Perëndimit, dhe të Vardarit. Duke pasur parasysh natyrën dhe kontekstin e hulumtimit, me qëllim që këto metoda të përdoren në tërësi, studiuesit vendas ishin të aftë në gjuhët lokale.

Hulumtimi është kryer në periudhën Maj - Tetor 2014. Viti i studimit ishte 2014-ta, me përjashtim të dokumenteve që lidhen me llogaridhënien, dmth raportet vjetore, llogaritë vjetore për të cilat viti referues ishte 2013-ta. Të dhënat e grumbulluara në periudhën Nëntor - Dhjetor 2014 janë futur në bazën e të dhënave LOTOS-it dhe kanë qenë subjekt recensim i gjatë periudhës Janar-Shkurt 2015. Recensimi është kryer nga katër recensues, secili prej tyre duke i shqyrtuar rezultatet e të dy rajoneve. Hulumtuesit u janë përgjigjur komenteve të recensuesve në Mars 2015, kur rezultatet para-përfundimtare janë dërguar nëpër komuna për miratim. Një e treta e komunave pati komente për rezultatet para-përfundimtare dhe ofruan të dhëna shtesë dhe dëshmi të cilat u futën në bazën e të dhënave të LOTOS-it dhe reflektuan në rezultatet përfundimtare të qeverisjes së mirë komunale.

Kufizimet në metodat e hulumtimit

Një hulumtim i tillë në mënyrë të pashmangshme përballet me një numër kufizimesh që duhet të merren parasysh gjatë nxjerrjes së konkluzioneve relevante dhe hartimit të rekomandimeve. Ka çështje që dalin nga zgjedhjet metodologjike të aplikuara për hulumtim. Kufizimi i parë ka të bëjë me mbledhjen e të dhënave në kërkimin që shërben për të matur përmbushjen e indikatorëve. Duke pasur parasysh se mbledhja e të dhënave në shkallë të madhe varet nga përgjegjshmëria së komunave për atë hulumtim, mund të ndodhë që disa komuna i përmbushin disa indikatorë por pasi që ata nuk kanë ofruar dëshmi, atyre ju janë ndarë 0 pikë indikatorin konkret. Megjithatë, pasi që të siguruarit e dëshmimeve është e lidhur drejtpërdrejt me përgjegjshmërinë dhe transparencën e komunave ne konsiderojmë se kjo është mënyrë e përshtatshme për të përmendur një papërgjegjësi të tillë.


Për më tepër, përdorimi i intervistave ballë për ballë, për shembull, paraqet një numër të problemeve: besueshmërinë e informacionit, njohuritë faktike të pjesëmarrësve si dhe pikëpamjet e tyre individuale subjektive për çështje dhe të marrëdhënie të caktuara, gjithashtu, mund të paraqesin rrezik për cilësinë e rezultateve. Prandaj për të ulur kufizimet e kësaj metode kërkimore studiuesit kanë synuar intervistimin e personit për marrëdhënie publike të komunës që pothuajse në të gjitha rastet ke lejuar krijimin e të gjitha informacioneve të nevojshme nga departamentet e ndryshme të komunave që janë subjekt i hulumtimit të LOTOS-it.

Kapitulli i dytë

- Përmbledhje e rezultateve të LOTOS-it

Indeksi i LOTOS-it për qeverisje të mirë në nivelin lokal paraqet matjen e qeverisjes në një shkallë nga 0 deri në 10. Rezultati mesatar nga komunat e të studiuara në rrethin e parë të hulumtimit të LOTOS-it është 3,53. **Rezultatet e pilot** hulumtimit tregojnë se shumica e pilot-komunave (**53% nga 43 komunat**) kanë rezultat më të ulët se mesatarja prej 3,53. Për më tepër, rezultati mesatar është shumë më i vogël se rezultati i komunës më të zhvilluar (3,53 në krahasim me 8,48 pikët e ndara të Strumicës në indeksin e LOTOS-it). Kjo sugjeron që: (i) ka hapësirë për përmirësimin e qeverisjes në mënyrë që të rritet rezultati mesatar i komunave; por edhe (ii) ka nevojë për rritjen e qeverisjes për të ulur dallimin ndërmjet komunës më të zhvilluar dhe rezultatit mesatar të komunave.


Grafiku 1: Krahasimi i rezultatit më të lartë me atë mesatar nga LOTOS



Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Studimi i LOTOS-it komunat studiuara i ndan në gjashtë kategori të qeverisjes së mirë: (i) Qeverisje e shkëlqyer - shënon nga 9,51 deri në 10; (ii) të qeverisje shumë e mirë - shënon nga 7,51 deri në 9,50; (iii) qeverisje e mirë - shënon nga 5,51 deri në 7,50; (iv) qeverisje e mjaftueshme - shënon nga 3,51 deri në 5,50; (v) qeverisje e pamjaftueshme - shënon nga 1,51 deri në 3,50 dhe (vi) qeverisje shumë e keqe - shënon nga 0 deri 1,50. Ushtrimi i LOTOS-it në vitin 2014 nuk shpërbleu asnjë komunë në kategorinë e qeverisjes së shkëlqyer. Megjithatë, LOTOS 2014 identifikon një grup prej katër komunave: Strumicën, Qytetin e Shkupit, Velesin dhe Ilindenin të cilat kanë qeverisje shumë të mirë. Ne konsiderojmë që këto komuna kanë praktikën më të mirë në mostrën e studiuar dhe duhet të shërbejë si shembull për të tjerat.

Grafiku 2: Kategoritë e qeverisjes së mirë



Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Nga një mostër prej 43 komunave asnjëra nuk funksionon në mënyrë që të jetë e kualifikuar si qeverisje e shkëlqyer; 9% e komunave qeverisen shumë e mirë; 14% qeverisen mirë; 21% qeverisen mjaftueshëm dhe 30% qeverisen pamjaftueshëm dhe ka një grup prej 11 komunave që janë etiketuar si komuna të qeverisura shumë keq. Këto madje nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara me ligj si të detyrueshme.

Është interesant fakti që LOTOS 2014 tregon se niveli i qeverisjes nuk është relevant për madhësinë e komunës apo për nivelin e zhvillimit të saj. Gjegjësisht, në top 4 e komunave që qeverisen shumë mirë gjendet komuna e Ilindenit që ka tre herë më pak banorë sesa e para dhe e treta në listën e LOTOS 2014, dhe 20 herë më pak se Qyteti i Shkupit. Komuna e Ilindenit së bashku me Komunën e Radovishit dhe Bogdancit në top dhjetë komunat (shih tabelën më poshtë) janë kategorizuar si komuna rurale⁴ dhe me performancën e tyre në indeksin e LOTOS 2014 të qeverisjes së mirë thyjnë stereotipin se qeverisja e mirë është karakteristikë e komunave të zhvilluara mirë dhe urbane.

⁴ Sipas urdhërësës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në dispozicion këtu:

http://www.mzsv.gov.mk/files/Spisok_na_ruralni_sredini_i_ruralni_zaednici_vo_Republika_Makedonija.pdf
(së fundi e vizituar 30/03/2015)

Tabela 1: Dhjetë komunat më të mira

Komuna	LOTOS 2014 rezultatet	Numri i banorëve ⁵	Urbane/Rurale	Buxheti ⁶ në MKD
Strumicë	8.48	56615	Urban	821.191.745
Qyteti i Shkupit	8.09	320150	Urban	3.677.941.296
Veles	7.95	54878	Urban	614.887.671
Ilinden	7.88	16736	Rural	234.211.008
Ohër	7.22	52734	Urban	371.374.384
Manastir	7.22	92777	Urban	564.365.828
Karposh	6.46	60550	Urban	542.219.619
Bogdanci	6.31	8329	Rural	35.279.469
Radovish	6.01	28915	Rural	357.730.396
Shtip	5.99	48590	Urban	638.339.001

Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Më në fund, rezultatet e LOTOS 2014 tregojnë se **pasuria e komunës nuk përcakton nivelin e saj të qeverisjes**. Komuna e Bogdancit është në top dhjetë komunat me qeverisje të mirë, ndonëse, siç paraqet tabela e mëposhtme, është komuna me popullatë më të vogël përreth dhe ka një buxhet shumë modest që është 10 herë më i vogël se buxheti i një komune tjetër rurale, d.m.th Radovish, dhe njëqind herë më të vogël se kryeqyteti Shkupi. Megjithatë mund të vërehet se vetëm njëra nga top dhjetë komunat më të zhvilluara, ka qendrën e saj në fshat - ajo është komuna e Ilindenit.

Megjithatë, duke kombinuar të dhënat mbi buxhetin dhe popullsinë do të mund të përshkruajmë se me çfarë efikasiteti komunat përdorin buxhetin e tyre në zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Në grafikun e mëposhtëm janë kombinuar të dhënat e LOTOS-it me buxhetin për kokë banori për të përcaktuar lidhjen e brendshme ndërmjet qeverisjes së mirë dhe "pasurisë" së komunës.

Kolonat e kuqe paraqesin buxhetet komunale për kokë banori, vlerat e tyre janë paraqitur në boshtin e majtë X. Ndërsa, vija e kaltër paraqet rezultatet komunale në hulumtimin e LOTOS 2014, vlerat e tyre janë treguar në boshtin e djathtë X. Top dhjetë komunat janë paraqitur në boshtin Y, duke filluar me Strumicën në të majtë e cila ka rezultatin më të mirë në LOTOS 2014, duke lëvizur kah e ana e djathtë tek komunat me rezultat më të ulët.


Pikat e kryqëzimit në mes të kolonave të kuqe dhe linjës së kaltër tregojnë përdorimin optimal të burimeve buxhetore në zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë. Nëse pika e buxhetit komunal është më e lartë se rezultati i saj në LOTOS 2014 atëherë komuna nuk është duke i përdorur plotësisht burimet buxhetore për qeverisje të mirë. Dhe anasjelltas, nëse pika e buxhetit komunal për kokë banori është më e ulët sesa rezultati i saj në LOTOS 2014 do të thotë se komuna në

⁵ Sipas vlerësimeve të Entit statistikor shtetëror në dispozicion në bazën e të dhënave Makstat http://makstat.stat.gov.mk/pxweb2007bazi/Dialog/varval.asp?ma=Popis_Ops_NasPolStar_eng&ti=Population (last visited 30/03/2015)

⁶ Këtu kemi përdorur buxhetin ekzekutiv 2013 si referencë në dispozicion në llogaritë përfundimtare të secilës nga komunat

mënyrë optimale i përdor burimet buxhetore për zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë në nivelin lokal.

Grafiku 3: Krahësimi midis rezultateve të LOTOS-it dhe buxhetit komunal për kokë banori



Burimi: QHKP, LOTOS 2014


Nëse i krahasojmë rezultatet e komunës së Manastirit dhe Shtipit, në shembull do të shohim se Manastiri ka performuar më mirë se Shtipi, edhe pse buxheti i Manastirit për kokë banori është më i vogël se ai që ka Shtipi. Shtipi, Radovishi, Ilinden dhe Strumica janë komunat që nuk i përdorin në mënyrë optimale burimet e tyre buxhetore për zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë. Komuna e Bogdancit është kampioni absolut në këtë çështje, e ndjekur nga Manastiri, Karposhi, Velesi dhe Qyteti i Shkupit.

Pas miratimit të Strategjisë për zhvillimin rajonal në vitin 2009 nga Parlamenti, vendi ishte ndarë në 8 rajone statistikore në përputhje me Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistika të BE-së (NUTS-3 nivel NNTS -3). Ndarja në këtë nivel është bërë për qëllime statistikore, ndërsa ndarja kryesore administrative është në nivelin e Njësive Administrative Lokale (Lau-1 - NAL), e cila numëron gjithsej 80. Rajonet përfshijnë: Shkupin, Pollogun, Pellagoninë, rajonin e Vardarit, rajonin e Mesëm, rajonin Veri-lindje, Jug-lindje dhe rajonin Jug-perëndim. Studimi LOTOS merr qasjen rajonale në analizën e të dhënave për qeverisje të mirë të mbledhura gjatë hulumtimi. Grafiku i mëposhtëm tregon se rajoni me rezultate më të mira është rajoni i Jug-lindjes, i ndjekur nga Pellagonia, rajoni i Jug-perëndimit, i Vardarit, Lindjes, Shkupit, Veri-perëndimit dhe në rajoni i Pollogut.

Nëse i analizojmë rezultatet e LOTOS-it nga perspektiva rajonale mund të konkludohet se derisa suksesi i rajonit të Jug-perëndimit bazohet në faktin që tre nga katër komunat e studiuara në këtë rajon janë në top dhjetëshin e më të mirave; dështimi i rajonit të Pollogut qëndron në faktin që katër nga pesë komunat e studiuara rezultojnë nën mesataren.

⁷ Strategjia për zhvillimin rajonal të Republikës së Maqedonisë 2009-2019, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

Grafiku 3: LOTOS 2014 - rezultatet për secilin rajon




Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Një tjetër konkluzion që mund të nxjerrim është se në tre nga pesë komunat në rajonin e Pollogut qendra e komunës është në fshat, një faktor që lidhet me nivelin e qeverisjes së mirë, ashtu siç LOTOS 2014 tregon të gjitha komunat në kategorinë e qeverisjes shumë të keqe qendrën e tyre e kanë në fshat. Rezultatet e rajonit të Pellagonisë në anën tjetër na lejojnë që të nxjerrim një përfundim se kur dy prej katër komunave të studiuara kanë performancë mesatare të qeverisjes së mirë, atëherë rajoni ka prirje të mirë. Rezultatet nga rajoni i Shkupit megjithatë tregojnë se nuk mjafton që të kemi dy prej komunave të renditura si shumë mirë të qeverisura, d.m.th Qyteti i Shkupit dhe Ilinden, kur shtatë nga dhjetë komuna të studiuara kanë qeverisje shumë të keqe.

Tabela 2: Komunitat sipas kategorisë së qeverisjes

Qeverisje shumë e mirë	Good governance	Sufficient governance	Non-sufficient governance	Bad governance
Strumicë	Ohër	Qendër	Kumanovë	Zërnovc
Qyteti i Skopje	Manastir	Tetovë	Çashkë	Studenicani
Veles	Karposh	Sveti Nikole	Kërçovë	Novo Sellë
Ilinden	Bogdanci	Negotinë	Bogovinë	Bërvenicë
	Radovish	Kriva Palankë	Vrapçisht	Shuto Orizare
	Shtip	Strugë	Dollnen	Gradsko
		Aerodrom	Çair	Çuqer Sandevë
		Krushevë	Karbinci	Staro Nagorçane
		Demir Hisar	Kisela Vodë	Saraj
			Qendër Zhupa	Zelenikovë
			Lipkovë	
			Vevçani	
			Gostivar	
			Llozovë	

Burimi: QHKP, LOTOS 2014




Kapitulli i tretë

– Përmbledhja e rezultateve për dimensionin 1 - transparencja lokale

Rezultati mesatar i komunave të studiuara në dimensionin e parë - transparencja në punën e vetëqeverisjes lokale është 0,36 ose 36%. Rezultatet e hulumtimit pilot tregojnë se shumica e pilot komunave (54% e 43 komunave) kanë rezultat më të ulët se mesatarja 0,36. Për më tepër rezultati mesatar është mbi 3 herë më i ulët se rezultati i komunës më të suksesshme - Strumica me 1,24. Ashtu sikur rezultatet e përgjithshme kjo sugjeron se ka mjaft vend për përmirësimin e nivelit të transparencës së komunave.

Dhjetë më të mirat në dimensionin e parë sipas hulumtimit pilot LOTOS 2014 janë Strumica e ndjekur Velesi, Ohri, Manastiri, Bogdanci, Ilinden, Sveti Nikole, Radovishi, Demir Hisari, Karposhi dhe Aerodromi. Rezultatet e tyre janë mids 83% (Strumica) dhe 53% (Aerodrom). Këto komuna janë konsideruar të kenë praktika të mira për qeverisje lokale transparente dhe duhet të merren si shembuj nga pjesa tjetër e mostrës së komunave të studiuar. Përsëri në mesin e më të mirave kemi komuna që janë të vogla dhe rurale (Bogdanci, Ilinden, Sveti Nikole, Radovishi, dhe Demir Hisari) të cilat sugjerojnë se madhësia dhe niveli i zhvillimit nuk janë të lidhura me transparencën lokale.

Grafiku 5: Dhjetë rezultatet më të mira të komunave në dimensionin e parë - transparencja




Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Megjithatë, nëse qendra e komunës është një qytet apo një fshat, është një faktor që ndikon në mënyrë të ndjeshme në rezultatet e dimensionit 1 - transparencës. Siç tregon grafiku 6 më poshtë të gjitha komunat më pak transparente, me përjashtim të Shuto Orizares, kanë selitë e tyre në fshat. Ndoshta sepse këto janë komunitete të vogla dhe investojnë pak për informimin e

qytetarëve mbi punën e komunës. Prandaj, madhësia e komunës nuk duhet të përdoret për afërsinë e saj ndaj qytetarëve përderisa në mesin e dhjetë më të mirave kemi komuna shumë më të vogla, dmth Bogdanci me vetëm 8000 banorë.

Grafiku 6: Dhjetë komunat me rezultat më të ulët në dimensionin 1- Transparenca




Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Megjithatë nëse shkojmë më thellë në analizën e konstatimeve të LOTOS 2014, do të shohim se ka disa tregues në të cilët pothuajse të gjitha komunat janë suksesshme. Gjegjësisht, në indikatorët që matin nëse statuti i komunës, rregullorja, dhe buxheti janë publikuar 88%, 77% dhe 70% të komunave nga mostrës, respektivisht, pajtohen. Kjo shpjegohet me faktin se dokumentet e sipërpërmendura janë të përcaktuara me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për buxhetet që do të publikohet. Megjithatë mund të vërehet se praktikat e qeverisjes së mirë janë shfaqur në shumë komuna pasi ato kanë caktuar një oficer për marrëdhënie me publikun (84% e komunave) dhe në shumicën e këtyre komunave personi i caktuar është aktiv në informimin e publikut për punët e komunës (67% e komunave). Megjithatë, mund të thuhet se kjo praktikë nuk është vërejtur në komunat e vogla si Krushevë, Zërnovc, Bogovinë, Qendër Zhupa, Vevçani. Nuk ka shpjegim i dyfishtë për këtë gjendje (i) këto komunitete janë aq të vogla sa që gjithkush gjithkënd njihet dhe komuna nuk ka nevojë që të emërojë person të veçantë për të informuar publikun; por gjithashtu (ii) administrata komunale është aq e vogël në mënyrë që secili prej zyrtarëve që punojnë në komunë kryejnë disa detyra, një prej atyre edhe informimin e publikut për punët e komunale. Në fund, rezultatet e LOTOS 2014 tregojnë se gazeta zyrtare e komunës, shërbimet komunale dhe Kryetari të Komunës gjithashtu shpeshherë përdoren si mekanizma përmes të cilëve informohet publiku, pasi 81% e komunave kanë gazetën e tyre zyrtare që është publike në dispozicion të qytetarëve, 58% e komunave kanë informacione për shërbimet e ofruara nga ana e

⁸ Article 62 p.4 of the Law on local self-government (OG n. 5/2002) determines the municipal Statute to be published in the official gazette of the municipality; and Article 54 from the Law on budgets (OG n. 64/05, 04/08, 103/08, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10 156/09, 95/10, 180/11, 180/11 and 171/12) regulates that the annual account and the municipal budget are to be published in the official gazette of the municipality

tyre; si dhe 72% e kryetarëve të komunave kanë praktikë të konsultimit me qytetarët në orar të caktuar për vizitë.

Grafiku 7: Rezultatet më të mira për secilin indikator në dimensionin 1 - transparenca




Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Prandaj treguesit në dimension 1 - transparenca, ku komunat kanë rezultate më të këqija i zbulojnë zonat ku korrupsioni i qeverisjes në nivelin lokal mund të jetë mbizotëruese: (i) përdorimi i financave publike; (ii) punësimi nga ana e komunës / punësim; dhe (iii) të prokurimi publik. Fakti se asnjëra nga komunat në mostër nuk publikon se sa kontrata gjithsej kanë nënshkruar ose anuluar gjatë vitit dhe vetëm 7% kontratave të nënshkruara të prokurimit të publikuara sugjerojnë se prokurimi publik është zona me rrezik më të lartë të korrupsionit. Informacioni mbi mundësitë dhe rezultatet e punësimit në administratën komunale botohet në vetëm 7% të komunave të studiuar. Kjo hap hapësirë për spekulime se punësimi është i njëanshëm dhe për këtë arsye nuk japin llogari para qytetarëve. Raporti për vlerësimin e Korrupsionit e sponson këtë gjendje, duke identifikuar aplikimet për punë ose promovimet në

administratën shtetërore, si një nga situatat kur qytetarët janë të prirë për korrupsion. Studimi paraqet politikanët si ndërmjetës kur bëhet fjalë për të aplikuar për punë në administratë. Së fundi, mënyra se si informacioni i buxhetit është paraqitur nuk ofron hapësirë për qytetarët për të monitoruar shpenzimet e parave publike. Mungesa e përdoruesit të formatit miqësor të buxhetit dhe mungesa e prezantimit të informacionit të buxhetit për secilin përdorues të buxhetit i parandalon qytetarët të dinë se sa para shpenzon komuna për ushqimin që fëmijët e tyre e hanë në kopshtet e fëmijëve në krahasim me paratë e përdorura për udhëtimet e Kryetarit.

Grafiku 8: Rezultatet më të dobëta për secilin indikator në dimensionin 1- transparenca




Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Në përgjithësi, të dhënat e LOTOS 2014 tregojnë se më të suksesshme në dimensionin 1 - transparenca janë komunat e rajonit Jug-lindor, të ndjekura nga komunat e rajonit të Pellagonisë, dhe nga komunat e rajonit Jug-perëndimor. Njëkohësisht bëjnë thirrje për përmirësim të nevojshëm në nivelin e transparencës në mesin e komunave të rajonit Veri-perëndimor, të rajonit të Shkupit, Pollogut dhe rajonit të Vardarit. Informacioni i plotë për performancën komunale në dimension 1- transparenca, është paraqitur më poshtë në grafikun 9.

⁹ MCIC 2014 Raporti për vlerësimin e korrupsionit Maqedonia

Grafiku 9: Dimensioni 1 – transparenca – rezultatet e të gjitha komunave të studiuara



Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Kapitulli i katërt – dimensioni i dytë i qeverisjes së mirë – participimi


Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje e bën demokracinë përfaqësues të vërtetë të popullit. Me të vërtetë aplikimi i kësaj vegje është në të mirë të të gjithë palëve të interesuara: është një mjet për të siguruar politika efikase dhe përgjegjëse duke i njoftuar hartuesit e politikave me nevojat edhe interesat e qytetarëve. Pjesëmarrja e publikut është thelbësore në çdo nivel të vendimmarrjes pasi qytetarët janë të destinuar të jenë përfituesit përfundimtarë të të gjitha vendimeve të hartuesve të politikave; megjithatë, kjo është veçanërisht e vërtetë në nivelin lokal. Për shkak se komunat kanë kompetenca për të vendosur në lidhje me, dhe të administruar, çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me individët dhe bashkësitë - siç janë planifikimi urban, arsimi dhe kujdesin shëndetësor - është thelbësore që qytetarët të demonstrojnë iniciativë për të ndikuar drejtpërdrejt në politikat e këtyre fushave.

Ligji për Vetëqeverisje lokale ju garanton qytetarëve të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrje në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes nismave qytetare, asociacioneve, referendumeve dhe mjeteve tjera (Neni 25). Vetëdija e qytetarëve për këto të drejta në vend është në ngritje të vazhdueshme por, megjithatë, mbetet e ulët. Përveç kësaj, edhe pse obligimet ligjore për të gjitha komunat, qasja të cilën qytetarët e Maqedonisë e kanë në vendimmarrje dallon nga komuna në komunë.

Hulumtimi LOTOS 2014 ka matur performancën komunës në këtë dimension duke përdorur 9 indikatorë dhe 10 nën-indikatorë shtesë. Rezultati mesatar i komunave të studiura në dimensionin e dytë është më i lartë në krahasim me dimensionin e parë - 0.56 ose 56%. Konstatimet e hulumtimit pilot tregojnë se 63% e komunave kanë rezultat nën mesataren. Kjo sugjeron se rezultatet në këtë dimension janë më të dobëta se në dimensionin e parë. Qasja e hulumtimit i LOTOS-it ishte që të inkurajojë komunat që të investojnë në përpjekje shtesë për të forcuar pjesëmarrjen e qytetarëve në hartimin e politikave lokale. Prandaj ky studim rezultatet e LOTOS-it në dimensionin e dytë i vlerësoi me 25% në rezultatin e përgjithshëm.

Grafiku i mëposhtëm paraqet 10 komunat më të mira në këtë dimension. Mund të vërejmë se komunat që janë pozicionuar në krye listës së radhitjes së LOTOS-it kanë ndryshuar. Në këtë dimension Qyteti i Shkupit së bashku me Strumicën kanë rezultate më të mira, të pasuara nga Ohri dhe Velesi, Ilindeni dhe Manastiri, Kërçova dhe Shtipi. Dy komunat me qendrën e tyre në fshat - Ilindeni dhe Bogovina kanë hyrë në listën e 10 më të mirave. Të gjitha këto i konsiderojmë si komuna më praktika më të mira sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave lokale. Disa prej tyre në statutin e tyre kanë rregulluar forumet e komuniteteve siç është rasti me Strumicën, Velesin dhe Bogovinën. Interesant Shkupi, rajoni Lindor dhe ai i Jug-perëndimor në këtë listë janë përfaqësuar me dy komuna ndërsa Pollogu, Pellagonia, rajoni Jug-lindor dhe ai i Vardarit janë përfaqësuar me një komunë. Vetëm rajoni Veri-perëndimor i Maqedonisë nuk ka asnjë komunë përfaqësuese në 10 komunat më të mira në dimensionin e dytë - pjesëmarrja.

Grafiku 10: 10 rezultatet më të mira në dimensionin 2



Burimi: QHKP, LOTOS 20


Nga gjithsej 19 pyetje hulumtuese në këtë dimension mbi 50% e komunave janë përgjigjur drejtë vetëm në tri prej tyre. Grafiku i mëposhtëm tregon se në 65% të komunave pjesëmarrja e qytetarëve është e lehtësuar përmes bashkëpunimit të komunës me Organizatat e shoqërisë civile dhe përmes bashkësive lokale në 58% të komunave. Megjithatë, në vetëm 51% të komunave ekzistojnë prova të dokumentuara që qytetarët kanë ndikuar në hartimin e politikave lokale. Ndërkohë që themelimi i bashkësive lokale është rregulluar si i detyrueshëm me Ligjin për vetëqeverisje lokale (kapitulli XII), bashkëpunimi me Organizatat e shoqërisë civile nuk është i rregulluar dhe për atë shkak atë e konsiderojmë si praktikë të mirë. Në të vërtetë, edhe pse Ligji për Vetëqeverisjen lokale garanton pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje; organizimi i debateve publike dhe konsultimeve nuk është detyrim për komunat. Ligji i njëjtë (neni 30) thekson se këto forma të takimeve me qytetarë mund të organizohen në qoftë se kryetari i konsideron si të domosdoshme. Prandaj, dallimet në mes të komunave, që përdorin këto mjete të pjesëmarrjes dhe të tjerave që nuk bëjnë këtë, janë të mëdha. Disa komuna kanë miratuar strategji dhe doracakë për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe bashkëpunojnë ngushtë me ta - ose me nismën e tyre ose nëpërmjet projekteve të financuar nga të huajt.

Prej këtui del se rezultatet e LOTOS 2014 tregojnë se bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile është 'nga poshtë - lart' e inicuar nga organizatat e shoqërisë civile deri tek komunat dhe në të shumtën e rasteve i nxitur për realizimin e projekteve të financuar nga donatorët gjë që shpjegon ndikimin e dokumentuar mbi rezultatet e hartimit të politikave lokale, pasi që komunat nuk kanë krijuar praktikën e dokumentimit të bashkëpunimit me Organizatat e shoqërisë civile, dhe as të matjes së përfshirjes së qytetarëve në zbatimin e hartimit të politikave lokale ose ofrimin e shërbimeve lokale.

Hulumtimet më cilësore tregojnë se mënyra se si qytetarët janë të ftuar për konsultime është problematike (informacionet vendosen vetëm në panelin informativ të komunës ose në faqen e internetit dhe jo gjithmonë precizojnë se çfarë do të diskutohet në seancën), gjithashtu edhe numri i kufizuar i ulëseve në dispozicion në sallën e mbledhjeve.

¹⁰ CRPM 2014, Open Government Partnership Calls for Participation (Partneriteti i hapur qeveritar thërret për participim), në dispozicion online <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2014/12/Policy-Brief-N.29.pdf> (vizita e fundit më 04/04/2015)


Grafiku 11: Indikatorët në të cilat komunat kanë rezultate më të mira - dimensionin 2 – pjesëmarrja



Burim: QHKP, LOTOS 2014

Hulumtimi LOTOS 2014 gjithashtu i detekton zonat në të cilat patjetër duhet të arrihet progres në dimensionin e dytë - pjesëmarrje. Komunat duhet të jenë në përputhje me rregulloren mbi konfliktin e interesave dhe të publikojnë se me cilat Organizata të shoqërisë civile dhe kompani nuk mund të punojnë për shkak të konfliktit të interesave pasi që vetëm Qyteti i Shkupit ka publikuar këtë informacion në mostrën e 43 komunave. Këshillat rinore si një model i përfshirjes së të rinjve në hartimin e politikave lokale nuk është shfrytëzuar plotësisht vetëm në 3 nga komunat e studiuara: Manastiri, Ohri dhe Shtipi e kanë bërë këtë. Përderisa disa komunë i rregullojnë mënyrat se si sigurohen ndihmat financiare për Organizatat e shoqërisë civile, jo shumë prej tyre e publikojnë informacionin se cilat organizata ishin shpërblyer me grante nga komunat (grafiku i mëposhtëm identifikon se 19% e komunave e bëjnë këtë). Së fundi, edhe pse ka një tendencë të rritjes së përfshirjes së qytetarëve në procesin buxhetit komunal, kryesisht përmes forumeve buxhetore të komuniteteve, qytetarët shpeshherë nuk konsultohen dhe nevojat e tyre nuk merren parasysh kur bëhet rebalanci i buxhetit (vetëm 19% e komunave në mostrën e studiuar i përfshijnë qytetarët në rebalancin e buxhetit për të adresuar nevojat e tyre).

Grafiku 12: Indikatorët në të cilët komunat kanë rezultate më të dobëta - dimensionin 2 – participimi




Burimi: QHKP, LOTOS 2014

Në përgjithësi, të dhënat e LOTOS 2014 tregojnë se më të suksesshme në dimensionin 2 - pjesëmarrja- janë komunat në rajonin e Jug-lindor, të pasuara nga komunat në rajonin Lindor, dhe komunat nga rajoni Jug-perëndimor. Njëkohësisht ftojnë për përmirësime të duhura në nivelin e pjesëmarrjes në mesin e komunave në rajonin Veri-perëndimor, rajonin e Vardarit dhe të Pollogut. Informacioni i plotë mbi performancat në dimensionin 2 - pjesëmarrja është prezantuar në grafikun e mëposhtëm. (grafiku 13)

¹¹ Qendra për komunikime civile (2013), Qeverisje lokale transparente: Gjendja, Rekomandimet dhe Sfidat. 1 Mar. Shkup, Maqedoni

Grafiku 13: Dimenzioni 2 – participimi – rezultatet e të gjitha komunave të studiuara



Kapitulli i pestë

– Përmbledhje e rezultateve në dimensionin 3 - administratë lokale përgjegjëse dhe llogaridhënese

Indikatorët në dimensionin e tretë bëjnë matjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së administratës lokale. Përgjegjshmëria e administratës lokale është një aspekt kyç në mundësimin e qytetarëve për të ushtruar të drejtat e tyre para pushtetit lokal dhe paraqet gatishmërinë e pushtetit lokal për t'u konsultuar me qytetarët e tyre për shërbimet që ai ofron me qëllim të përmirësimit të tyre. Për përmirësimin e shërbimeve, komunat kanë në dispozicion disa instrumente (forma, sondazhet, pyetësorët, konsultimi publik, instrumente për demokraci të drejtpërdrejtë), kështu që përmes këtij dimensionin është matur deri në çfarë mase këto instrumente janë në dispozicion të qytetarëve, gjegjësisht sa komuna është duke përdorur këto mjete në periudhën e mbuluar nga hulumtimi

Në këtë dimension, rezultate më të larta kanë arritur Qyteti i Shkupit dhe komuna e Manastirit me 2,32 që është 93% e suksesit, duke pasur parasysh se 2,5 është rezultati më i lartë i mundshëm në këtë dimension. Qyteti i Shkupit dhe Manastiri janë ndjekur nga 6 komunat me një rezultat prej 2,14, ose 86% e suksesit - Qendër, Ilinden, Ohër, Negotinë, Strumicë, Tetovë. Rezultati mesatar për këtë dimension është 1,22 ose 49% e suksesit. Me rezultate më të dobëta në këtë dimension janë Saraji, Zelenikova dhe Shuto Orizareja me 0 pikë arritura, do të thotë se ata në mënyrë të konsiderueshme dhe urgjentisht duhet ta përmirësojnë bashkëpunimin me sektorin civil me qëllim që të sigurojnë kushte më të mira për pjesëmarrje më efektive të qytetarëve në nivelin lokal.


53% e komunave kanë kaluar pragun e 50% të suksesit, apo kanë arritur rezultate më të larta ose të barabarta me 1,25; 17 komuna kanë arritur një rezultat të kënaqshëm, ndërsa 3 komuna nuk kanë asnjë pikë këtë dimension.

Sa për përmbushjen e treguesve të veçanta në këtë dimension, 72% e komunave kanë siguruar formularë për paraqitjen e kërkesave, ankesave dhe shënime për qytetarët e tyre. 63% e komunave bëjnë vlerësimin e nevojave të qytetarëve, ndërsa deri në 58% e tyre kanë procedurën të vërtetë për organizimin e konsultimeve publike në disa forma.

Tabela 3: Përqindja e përmbushjes së indikatorëve në dimensionin 3

Indikatorët	Përqindja e përmbushjes nga ana e komunave
44 – Formularë në dispozicion të qytetarëve për paraqitjen e kërkesave, ankesave dhe shënimeve	72%
40 – A bën komuna vlerësimin e nevojave të komunitetit	63%
37 – A ka Komuna procedurë të caktuar për organizimin e konsultimeve publike	58%
48 – Komuna ka miratuar Kodin e Etikës dhe ai është shfaqur në vend të dukshëm në komunë	56%
46 – Administrata lokale sipas rregullit ju përgjigjet ankesave dhe shënimeve	53%
47 – Komuna i informon qytetarët e saj për progresin e politikave të caktuara si rezultat i iniciativës qytetare	44%
39 – Komuna përdor pyetësor/sondazhe për të matur kënaqësinë e qytetarëve për shërbimet e ofruara	40%
42 – E drejta për parashtrimin e ankesës dhe shënimeve nga qytetarët respektohet nga komuna	33%
43 – E drejta për qasje të lirë në informacionet me karakter publik respektohet nga komuna	33%
45 – Qytetarët me efikasitet mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre për parashtrimin e ankesave dhe shënimeve në komunë	26%

Grafiku 14: Rezultatet në dimensionin 3



Kapitulli i gjashtë
- Dimensioni i katërt i qeverisjes së mirë – Llogaridhënie, efektshmëri dhe efikasitet

Edhe pse ky dimension përbëhet vetëm prej 6 treguesve, në procesin e matjes së rezultateve 35% të rezultatit kemi atribuuar indikatorëve të këtij dimensioni. Arsyeja është pas që këta indikatorë ligjërisht nuk janë të detyrueshme për komunat, përmbushja e tyre është rezultat i angazhimit të tyre për të zbatuar parimet e qeverisjes së mirë në nivelin lokal të bazuar në praktikat e mira nga vendi dhe rajoni; prandaj ne menduam se duhet të shpërblejmë një angazhim të tillë të ndërmarrë nga anë e komunave.

Në dimensionin e katërt, i cili bën matjen e efektivitetin, efikasitetit dhe llogaridhënies së vetëqeverisjes lokale, më të mirët janë Qyteti i Shkupit, komunat e Strumicës, Velesit dhe Ilindenit me 100% të suksesit në dimensionin ose 3,5 pikë. Mesatarja për këtë dimension është 1,22, dhe kjo mesatare të ulët është në masë të madhe rezultat i faktit shqetësues se deri në 17 komuna kanë 0 pikë, që do të thotë se ata nuk e kanë përmbyshur asnjë indikatorë të vetëm. Përqindja mesatare e suksesit në dimensionin e 4 është 35, që do të thotë se komunat të bëjnë punë shumë të keqe në informimin e qytetarëve për progresin e zbatimit të politikave të caktuara lokale; nuk i publikojnë llogaritë përfundimtare për vitin e fundit ose nuk përgatisin buxhet miqësore për qytetarët.

Tabela 4: 10 Komunitat më të mira në dimensionin 4

Komuna	Rezultate në dimensionin 4	Mesatarja për dimensionin	Rezultati më lartë i mundshëm	% e suksesit
Ilinden	3,50	1,21	3,50	100%
Qyteti i Shkupit	3,50	1,21	3,50	100%
Velesi	3,50	1,21	3,50	100%
Strumica	3,50	1,21	3,50	100%
Karposhi	3,06	1,21	3,50	88%
Manastiri	2,63	1,21	3,50	75%
Ohri	2,63	1,21	3,50	75%
Bogdanci	2,63	1,21	3,50	75%
Radovishi	2,63	1,21	3,50	75%
Qendra	2,19	1,21	3,50	63%

Grafiku 15: Rezultatet e komunave në dimensionin 4




Tabela 6: Përqindja e përmbushjes së indikatorëve në dimensionin 4

Indikatori	Përqindja e përmbushjes
52 - Komuna publikon llogarinë përfundimtare	51%
49 - Komuna publikon programe të punës të sektorëve me afat kohor dhe me indikatorë të suksesit	42%
50 - Për çdo aktivitet të paraparë komuna ka publikuar një buxhet	42%
53 - Komuna publikon rebalancin e buxhetit	40%
54 - Komuna siguron informacion për organet monitoruese në nivel lokal	23%
51 - Komuna monitoron zbatimin e politikës lokale dhe publikon raporte të progresit	19%

Siç mund të shihet nga tabela e mësipërme, indikatori më i përmbushur është ai 52- Komuna publikon llogarinë përfundimtare. Megjithatë, përqindja e komunave që kanë përmbushur këtë indikator është modeste 51%, ose vetëm gjysma e komunave kanë botuar llogarinë përfundimtare për vitin e kaluar. Edhe pse Ligji për buxhetparashikon se llogaria përfundimtare duhet të publikohet vetëm në gazetën zyrtare të komunës, ne e konsiderojmë këtë si një praktikë e mirë që duhet të zbatohet nga ana e komunave në përpjekjet e tyre për të informuar qytetarët e tyre se sa para janë shpenzuar.

Indikatori tjetër në të cilat komunat kryejnë punë relativisht të mirë, është ai 49 - Komunat publikojnë programin e punës së sektorëve për vitin e ardhshëm. 42% e komunave kanë përmbushur këtë tregues, ashtu, si treguesi i ardhshëm në lidhje me publikimin e buxhetit për aktivitetet e parapara. Rebalancin e buxhetit e publikojnë vetëm 40% e komunave, ndërsa informacione kontaktuese për organet monitoruese në nivelin lokal kanë botuar 23% e komunave.

Indikatori i fundit në listë është ai që bën matjen nëse komunat kanë zhvilluar mekanizëm për monitorimin e zbatimit të politikave lokale, dhe nëse ato përgatisin raporte të progresit për këto politika. Sipas rezultateve të hulumtimit, vetëm 19% e komunave kanë përmbushur këto

¹³ Ligji për buxhetin, Gazeta zyrtare e RM-së Nr. 64/05, 04/08, 103/08, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10 156/09, 95/10, 180/11 dhe 171/12 dhe 171/12 dhe 171/12)

indikatorë që i shtohen llogaridhënies së komunës.

Llogaridhënia e agjencive administrative ndaj publikut të gjerë është një "shenjë dalluese e qeverisjes moderne demokratike. Demokracia mbetet një procedurë në letër nëse ata që janë në pushtet nuk mund të mbahen përgjegjës në publik për veprimet dhe mosveprimet e tyre, për vendimet e tyre, politikat dhe shpenzimet e tyre". Llogaridhënia publike ka të bëjë me "sinqeritetin" pasi që dhënia e llogarisë është bërë në publik dhe shpeshherë nga publiku. Thelbi i këtij koncepti është se 'personat' me përgjegjësi publike duhet të shpjegojë dhe të justifikojë / të jetë i përgjegjshëm ndaj "popullit" për kryerjen e detyrave të tyre¹⁵". Ky relacion midis aktorit dhe forumit llogaridhënës të cilit ndaj të cilit aktori jep llogari ka tre elemente: (i) aktori patjetër të ndihet i përgjegjshëm (zyrtarisht ose jo zyrtarisht); (ii) informacioni mund të nxit forumin që të merr në pyetje aktoren dhe të vë në pikëpyetje përshtatshmërinë e veprimit dhe legjitimitetin e sjelljes; (iii) forumi zakonisht kalon gjykimet mbi sjelljen e aktorit duke miratuar llogarinë, denoncuar politikën apo duke publikisht duke dënuar sjelljen¹⁶.

Llogaridhënia publike ka shumë funksione. Para së gjithash funksioni i saj është që të sigurojë kontroll demokratik, pastaj të përmirësohet integriteti i qeverisjes publike. Më në fund, llogaridhënia publike synon përmirësimin e performancës. Në tërësi llogaridhënia publike ndihmon mirëmbajtjen ose përmirësimin e legjitimitetit të qeverisjes publike. Në shumicën e demokracive llogaridhënia publike ka qenë horizontale, e ushtruar përmes llogaridhënies së ministrive ose agjencive ndaj Parlamentit (Kuvendit). Me fjalë të tjera, llogaridhënia horizontale paraqet kapacitetin e institucioneve shtetërore për të kontrolluar abuzimet nga ana e agjencive publike dhe degëve të qeverisë, ose kërkesën që agjencitë të raportojnë abuzimet anësore. Megjithatë, në dekadat e kaluara llogaridhënia hierarkike ofron mënyra për një sërë marrëdhëniesh të llogaridhënies më të larmishme dhe më pluraliste¹⁷. Mund ta shohim ngritjen e llogaridhënies administrative me themelimin e avokatit të popullit, inspektorateve të pavarura, auditit, organeve mbikëqyrëse etj. Këto nuk i përshtaten marrëdhënieve lart-poshtë të ngritjes së llogaridhënies horizontale, por formojnë llogaridhënie diagonale pasi që të gjitha këto organe përgjigjen para Parlamentit dhe ndihmojnë kontrollin parlamentar. Përndryshe, llogaridhënia vertikale është mjeti përmes së cilit qytetarët, mediat dhe shoqëria civile kërkojnë zbatimin e standardeve të performancave të mira për zyrtarët. Më në fund, si reagim ndaj mungesës së besimit në qeverinë shumë demokraci nxisin marrëdhënie më të drejtpërdrejta dhe më të qarta të llogaridhënies ndërmjet institucioneve, shërbimeve publike dhe qytetarëve¹⁸.

¹⁴ Mark Bovens, Llogaridhënia publike, në Doracakun e Oksfordit për menaxhimin publik nagement 182, 182 (Ewan Ferlie, Laurence E. Lynn & Christopher Pollitt eds., 2007);

¹⁵ Ibid fq.185

¹⁶ Ibid, fq.186

¹⁷ Day, P. dhe Klein, R, 1987 Llogaridhëniet: Pesë shërbime publike, Londër: Tavistok

¹⁸ McCandless, H.E., 2001 Udhërrëfyes i qytetarëve për llogaridhënien publike: Duke ndryshuar relacionin ndërmjet qytetarëve dhe Autoriteteve, Vistoria BC, Trafford

Konkluzion

Konstatimet e hulumtimit sugjerojnë se ka mjaft hapësirë për të përmirësuar qeverisjen lokale në Maqedoni përmes fuqizimit proceset demokratike në nivelin lokal dhe për të siguruar shërbime qytetarëve në mënyrë, efikase, llogaridhënese, transparente dhe të përgjegjshme. Për më tepër, komunat mund ta rrisin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal me qëllim të fuqizimit të "pronësisë" së qytetarëve për politikat lokale.

Kjo është bazuar në rezultatin mesatar të arritur nga komunat gjatë hulumtimit prej 3.53 nga maksimumi prej 10 pikëve, për çka mund të themi se mesatarisht, komunat nuk kalojnë prapë prej 50% të rezultatit maksimal për tu kualifikuar për qeverisje të mjaftueshme. Një tjetër fakt shqetësues, bazuar në konstatimet e hulumtimit, është se asnjëra komunë nuk ka arritur rezultat mbi 9.51 që të mund të vihen në grupin e qeverisjes së shkëlqyer, përderisa vetëm 9% e komunave janë të qeverisura mirë.

Në anën tjetër, përqindja relativisht e lartë e komunave në grupin e "qeverisjes jo të mjaftueshme", na orienton drejt nevojës që qeverisja e mirë në fushën e qeverisjes lokale duhet të shkëmbehet midis komunave me qëllim që të zvogëlohet dallimi ndërmjet komunave me performanca më të mira dhe atyre me performanca më të dobëta.

Hulumtimi ka studiuar lidhjen ndërmjet numrit të banorëve dhe "pasurisë" së komunave. Numri i banorëve në komunat është i lidhur me numrin e punonjësve në administratën lokale, pasi që në komunat më të mëdha nevojitet administratë lokale më e madhe për të siguruar shërbime (cilësore) për qytetarët. Për më tepër, administrata lokale më e madhe gjithashtu nënkupton që komuna ka në dispozicion më tepër resurse njerëzore për zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë. Nëse kësaj ia shtojmë "pasurinë" e komunës në kuptimin e më tepër resurse të disponueshme për zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë, atëherë do të mund ti testonim ndikimin e këtyre parametrave në hulumtimin.

Një analizë më e detajuar e konstatimeve të hulumtimit tregon se rezultatet e komunave nuk varen aq shumë nga numri i banorëve të komunës dhe nga buxheti në dispozicion për kokë banori ashtu siç mund të pritet. Ndonëse komunat me numër më të madh të banorëve dhe buxhet më të lartë për kokë banori në dispozicion në përgjithësi kanë arritur rezultate më të mira në krahasim me ato komuna me numër më të vogël të banorëve dhe buxhet më të ulët për kokë banori në dispozicion, ekzistojnë shembuj që kundërshtojnë një tezë të tillë.

Për shembull, komuna e Ilindenit ka tri herë më pak banorë se sa p.sh., komuna e parë dhe e tretë nga më të mirat. Një tjetër shembull i mirë, kur bëhet fjalë për buxhetin për kokë banori, është komuna e Bogdancit, ajo që ka buxhet disa herë më të ulët se çdo komunë tjetër në mesin e dhjetë më të mirave.

Nga ajo që u tha më lartë, mund të konkludojmë që zbatimi i praktikave të qeverisjes së mirë është i lidhur drejtpërdrejt me përdorimin optimal të burimeve njerëzore dhe materiale që komuna i ka në dispozicion, të cilat nga ana tjetër janë të përcaktuara nga vullneti politik i autoriteteve lokale për atë nëse kjo çështje është lartë në agjendën e tyre. Pa dyshim, në kuptimin e kësaj të fundit, është shoqëria civile ajo që duhet të angazhohet për futjen e këtyre çështjeve në agjendë, dhe të luajë rol aktiv në promovimin e parimeve të qeverisjes së mirë në çdo aspekt të jetës shoqërore.

Megjithatë, dallimi nëse selia e komunës është vend rural apo urban duket më e rëndësishme se sa numri i banorëve dhe buxheti në disponim. Në mesin e dhjetë komunave më të mira, vetëm komuna e Bogdancit ka selinë e saj në vendbanim rural. Ky parametër ka më tepër ndikim në rezultatin se sa p.sh. nëse komuna është e tëra rurale ose urbane, sipas klasifikimit rajonal NUTS-3. Duhet të merret parasysh, ndonëse, ajo komunë mund të kenë zhvilluar kanale të ndryshme për

të siguruar shërbime në mënyrë transparente, llogaridhëse dhe të përgjegjshme. Për shembull, qytetarët në këto komuna mund të preferojnë më tepër komunikimin e drejtpërdrejtë me autoritetet lokale, sesa komunikimin përmes internetit, që është mjaft i mundshëm në komunat e vogla. Këto ndërtesa do të testohen në ciklin e ardhshëm të hulumtimit të LOTOS-it, duke testuar perceptimin e publikut për këto çështje.

Përveç kësaj, kemi zgjedhur 3 praktika të mira për secilin dimension, që do të ndahet ndërmjet komunave me qëllim që të avancohet performanca e tyre në kuadër të hulumtimit. Disa nga praktikatat e mira në fakt janë të përcaktuara me ligj, që tregon për faktin se disa dispozita ligjore nuk janë zbatuar nga ana e komunave. Pjesa tjetër e praktikave të mira janë rezultat i përkushtimit të komunave për të avancuar qeverisjen lokale duke forcuar procesin demokratik në nivelin lokal. Ne besojmë fuqishëm se konstatimet e hulumtimit do të shërbejnë si mjete të fuqishëm të avokimit në promovimin e parimeve të qeverisjes së mirë në nivelin lokal dhe njëkohësisht do të kontribuojnë në diskursin e qeverisjes së mirë në Maqedoni.

Kapitulli i shtatë - praktikatat e mira në nivelin lokal

Dimensioni 1 - transparenca lokale

Praktika e mirë 1 – Rregullorja për transparencë në punën e komunave

Bashkësia e njësisve të vetëqeverisjes lokale (BNJVL), në faqen e saj të internetit ka publikuar një shabllon për Rregullore për transparencë në punën e komunave. Synimi i dokumentit është që ti ndihmojë komunat në procesin e hartimit të këtij dokumenti, ashtu që më vonë të mund të miratohet nga këshilli komunal dhe të bëhet akt zyrtar. Rregullorja synon që të operacionalizon disa nga konceptet e transparencës në nivelin lokal, duke i transformuar këto parime të qeverisjes së mirë në mekanizma praktik për rritjen e transparencës së organeve lokale. Dispozitat e Rregullores kanë bazë ligjore në bazë të Nenit 36, paragrafi 1, pika 15 e Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Megjithatë, pasi që miratimi i Rregullores nuk është ligjërishit i detyrueshëm për komunat, vetëm 19% nga 43 komuna kanë miratuar këtë dokument.

Pasi që konsiderojmë se me miratimin e këtij dokumenti, komunat do të bëjnë një hap përpara në drejtim të rritjes së transparencës, fuqimisht rekomandojmë që të gjitha komunat ta miratojnë këtë Rregullore për transparencë në punën e komunave të përgatitur nga BNJVL.

Praktika e mirë 2 – publikimi i agjendës për mbledhjet e Këshillit- Bogdanci

Komuna e Bogdancit, një komunë rurale me afërsisht 8000 banorë, agjenda për mbledhjet e Këshillit publikohet me kohë në faqen e internetit të komunës, minimum 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes. Kjo praktikë lejon që qytetarët të përgatiten në rast se dëshirojnë të marrin pjesë në punën e Këshillit për çështjet për të cilat janë të interesuar. Agjendat janë në dispozicion në linkun e mëposhtëm.

Praktika e mirë 3 – buxheti miqësor i qytetarëve - **Manastir**

Publikimi e buxhetit miqësor të qytetarëve, me informacion shtesë i lehtë për ta kuptuar për qytetarët që përmban grafika, tabela etj, është konsideruar si një praktikë e mirë për rritjen e transparencës financiare të komunave. Ndonëse, kjo nuk është e përcaktuar me ligj, Komuna e Manastirit ka përgatitur një dokument të tillë i cili është në dispozicion në linkun në vijim: http://issuu.com/opstinabt/docs/finansii_kniga_2013 dhe po ashtu është në dispozicion edhe në komunë.

Dimensioni 2 – pjesëmarrja

Praktika e mirë 1 – Konsultimet publike për miratimin e buxhetit komunal – Ilinden

Komuna e Ilindenit ka organizuar një konsultim publik par se të miratojë buxhetin për vitin 2015. Konsultimi publik përmes mbajtjes përmes forumeve të komunitetit në të cilat marrin pjesë përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, dhe ofron mundësi për këto grupe që të ndikojnë në buxhetimin e aktiviteteve të caktuara. Ngjarja është organizuar në ndërtesën e shkollës së mesme, dhe aty morën pjesë më tepër se 100 qytetarë. Në ngjarje kanë marrë pjesë hulumtues nga rajoni i planifikuar i Shkupit. Informacionet rreth ngjarjes janë në dispozicion në:

¹⁹ <http://www.zels.org.mk/Default.aspx?id=c55495aa-db99-41ef-84fb-be2a40fe178b>, e vizituar me 06.04.2015 (12.12h)

²⁰ Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 5, 29.01.2015, në dispozicion në: http://mls.gov.mk/images/laws/Zakon_za_lokalnata_samouprava.pdf

<http://ilinden.gov.mk/prebaruwanje.html?cx=001977137827867736080%3Arbwr292qcki&cof=FORID%3A9&ie=UTF-8&q=%D0%B1%D1%83%D1%9F%D0%B5%D1%82>

Praktika e mirë 2 – Organet jozyrtare këshilluese nga sektori civil dhe ai i biznesit - Kërçovë
Në komunën e Kërçovës janë themeluar organe këshilluese jozyrtare nga përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit siç janë sektori i biznesit, organizatat civile, këshillat ndëretnike etj. Këshilli komunal, kur mban mbledhje me agjendë që është në interes të këtyre organeve i fton ato të marrin pjesë në punën e këshillit. Për më tepër, këto organe janë të përfshira në hartimin e strategjive në lidhje me punën e tyre, megjithëse kjo nuk është përcaktuar me ligj, i cili rrit përforsimin e procesit të vendimmarrjes në nivelin lokal.

Praktika e mirë 3 – Bashkëpunimi ndërmjet komunës dhe organizatave të shoqërisë civile - StaroNagoriçane

Komuna e Staro Nagoriçanit ka vendosur bashkëpunim me organizatën e shoqërisë civile për të zhvilluar një platformë për zhvillimin rural dhe për të promovuar nisjen e bizneseve në komunitetet multietnike dhe rurale. Projekti financiarisht është mbështetur nga UNDP-ja, por komuna, për këtë projekt, ka kontribuar nga buxheti i saj. Më tepër informacione në: <http://www.stn.gov.mk/news.aspx?newid=121>

Dimensioni 3 – përgjegjshmëria në nivelin lokal

Praktika e mirë 1 – Konsultimet publike - Qendër

Komuna e Qendrës ka vendosur një praktikë të mirë për konsultimin e qytetarëve të saj për çështjet e rëndësishme në interes të shumicës së qytetarëve. Rasti ishte me rikonstruktimin e fasadave, kur përmes procedurës së paraparë publiku është konsultuar mbi llojin e fasadës që ata preferojnë për ndërtesat.

<http://opstinacentar.gov.mk/Search-Results?Search=%D1%84%D0%B0%D1%81%D0%B0%D0%B4%D0%B8>

Praktika e mirë 2 – Qasje e lirë në informacionet me karakter publik – Strumicë

Komuna e Strumicës ka caktuar një person kontakti për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, në përputhje me ligjin për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, dhe informacionet e kontaktit janë publikuar në faqen e internetit të komunës. Për më tepër, komuna, në përputhje me ligjin, ka publikuar listën e informacioneve në dispozicion të qytetarëve.

Kjo është një detyrim me ligjin për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, por në këtë aspekt vetëm 20% e komunave respektojnë ligjin. Prandaj i ftojmë komunat që ta ndjekin këtë praktikë të mirë.

http://strumica.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=744&Itemid=264&lang=mk

Praktika e mirë 3 – Kartelat e shërbimit – Kriva Palankë

Komuna e Kriva Palankës në faqen e saj të internetit ka publikuar kartelat e shërbimit për qytetarët me udhëzime të qarta se si mund të sigurohen shërbimet. Informacioni në kartelën e shërbimit përfshin: llojin e shërbimit të kërkuar, dokumentet e nevojshme, çmimi i shërbimit dhe llogaria e pagesës, ku duhet të dorëzohet kërkesa, afati i fundit për dorëzimin e ankesave, baza ligjore për ofrimin e shërbimeve, dhe vërejtjet.

Kartelat e shërbimeve janë në dispozicion në:

<http://www.krivapalanka.gov.mk/images/stories/documents/uslugi/ku2.pdf>

Dimensioni 4 – Llogaridhënia dhe efektshmëria në nivelin lokal

Praktika e mirë 1 – Informimi i qytetarëve për ecurinë e iniciativave

Informimi i qytetarëve për ecurinë e iniciativave të qytetarëve është një praktikë të mirë që kontribuon për llogaridhënie më të madhe të autoriteteve lokale. Duke i informuar qytetarët për ecurinë e iniciativave, komunat inkurajojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje që çon në zhvillimin e procesit demokratik në nivelin lokal. Komuna e Negotinos është njëra nga 20% e komunave që informon për ecurinë e zbatimit të iniciativave të caktuara.

Praktika e mirë 2 – Politikë të sigurimit cilësor në nivelin lokal

Komuna e Karposhit ka miratuar politikën e sigurimit të cilësisë me qëllim që të përmirësojë cilësinë e jetës në komunë përmes:

- Sigurimi të kënaqësisë së qytetarëve për shërbimet e ofruara
- Efikasitetin në ofrimin e shërbimeve
- Trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve
- Respektimit të dispozitave ligjore pozitive

Pulitka e sigurimit të cilësisë është publikuar në faqen e internetit të komunës

http://www.karpos.gov.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3094

Praktika e mirë 3 – Publikimi i rebalancit buxhetor

Komuna e Krushevës publikon rebalancin buxhetor në faqen e saj të internetit. Kjo praktikë është miratuar nga vetëm 40% e komunave në të cilat është zhvilluar hulumtimi. Duke konsideruar këtë si një praktikë të mirë në aspektin e rritjes së nivelit të transparencës dhe llogaridhënies, i ftojmë të gjitha komunat që ta miratojnë këtë praktikë..

<http://krusevo.gov.mk/za%20na%20web,%20vodomeri/opstina/BUDZET%20REBALANS%202013%20za%20SOVET/08%20Funkcionalni%20rashodi%20-%20REBALANS%202013.pdf>

Analiza e të dhënave sipas rajoneve

Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar të Shkupit

hulumtues: Aleksandar Cekov

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave

Në kuadër të studimit LOTOS, hulumtimi në Rajonin e planifikuar të Shkupit është zbatuar në 12 nga gjithsej 17 komuna, dhe atë në Qytetin e Shkupit dhe komunat: Qendër, Karposh, Kisella Vodë, Çair, Saraj, Shuto Orizare, Aerodrom, Zelenikovë, Studeniçan, Çuçer Sandevë dhe Ilinden.

Gjatë përzgjedhjes së komunave të Rajonit të Shkupit është marrë në konsideratë që të përfaqësohen në mënyrë përkatëse komunat rurale dhe urbane, komunat në të cilat popullata dominante janë qytetarët e komunitetit etnik jo-shumicë në nivel kombëtar, si dhe komunat me përbërje të përzier etnike.

Aktivitetet hulumtuese në kuadër të projektit zyrtarisht kanë filluar më 05.05.2014 me dërgimin e një shkrese për komunat përmes postës elektronike (e-mail) në të cilin janë shkruar objektivat dhe rezultatet e pritura nga hulumtimi. Së bashku me shkresën është dërguar edhe një pyetësor me 26 pyetje. Këto pyetje, përveç mbledhjes së të dhënave kishin për qëllim të japin një pasqyrë fillestare për gjendjen në komunat në drejtim të objektivave të hulumtimit, në bazë të të cilave hulumtuesi do të mund t'i përshtatë aktivitetet hulumtuese për komunën e caktuar.

Duhet të theksohet se në afatin e parë të dhënë deri më 26.05.2014, asnjë nga komunat nuk i është përgjigjur kërkesës për të dërguar pyetësorin e plotësuar, që hedh një hije mbi përgjegjshmërinë e komunave. Kështu, afati i fundit për marrjen e pyetësorit është prolonguar disa herë (20 qershor, 26 korrik dhe 17 shtator 2014) që në fund komunave t'u jepet një afat përfundimtar deri më 07.10.2014. Së bashku me dërgimin e pyetësorit, komunat janë kontaktuar me telefon me qëllim që të kontrollohet nëse pyetësori është pranuar, kurse më vonë për të kujtuar ato lidhur me afatet për plotësimin dhe dërgimin e pyetësorit mbrapa deri te hulumtuesi. Deri në afatin përfundimtar, komunat Zelenikovë, Shuto Orizare, Kisella Vodë, Çuçer Sandevë dhe Qendër nuk e kanë dërguar pyetësorin mbrapa deri te hulumtuesi.

Plotësisht, nga komunat është kërkuar që t'i dërgojnë Statutin dhe Rregulloren si dokumente themelore që rregullojnë funksionimin e punës së komunave dhe është kërkuar që të realizohen intervista me personat zyrtarë të komunës gjatë vizitës së komunës.


Hulumtimet në terren janë realizuar gjatë muajve maj, qershor dhe gusht 2014 në të gjitha komunat përveç në komunën Kisella Vodë, në të cilën nuk kemi arritur gjatë këtyre muajve të sigurojmë një pritje te personi zyrtar, i cili ishte emëruar nga komuna për bashkëpunim në këtë projekt.

Për 33% të komunave kemi arritur t'i sigurojmë të gjitha burimet e të dhënave (pyetësori, intervistat/vizitat në terren, faqja e internetit, statuti dhe rregullorja e komunës, buxheti dhe buletinet zyrtare), për një komunë ka munguar një burim të të dhënave (8%), për 42% të komunave kanë munguar dy, kurse për 25% të komunave nuk ishin në dispozicion 3 burime të informacioneve. Në lidhje me burimet e informacioneve, pyetësori dhe buletini zyrtar janë siguruar nga 58% të komunave; intervistat/vizitat në terren janë realizuar në 92% të komunave; një faqe funksionale interneti kanë pasur 83% të komunave, ndërsa Statuti, rregullorja dhe buxheti kanë qenë në dispozicion të 67% të komunave.

²¹ Available at <http://lotos.crpm.org.mk/>

²² Ibid

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e rajonit të Shkupit



Nga përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave mund të shihet se edhe pse për një pjesë të burimeve të informacioneve, komunat kanë edhe obligimin ligjor që të mundësojnë disponueshmërinë e këtyre dokumenteve për opinion, megjithatë në kuadër të hulumtimit ne nuk ishim në mundësi t'i sigurojmë këto dokumente nga komunat (buxheti, buletini zyrtar, rregullorja). Është interesante që hulumtimet në terren dhe intervistat me zyrtarët komunalë janë realizuar në 92% të komunave, përkundër përqindjeve më të ulëta të disponueshmërisë së pyetësorit dhe dokumenteve të tjera.

Të dhënat e përmendura më lart e konfirmojnë tezën se përgjegjshmëria e komunave është shumë më e madhe gjatë vizitës së komunave sesa përgjegjshmëria rreth kërkesave të dërguara përmes postës elektronike apo telefonit, që mund të shihet nga përqindja e pyetësorëve të dërguar. Gjatë hulumtimit, ky konstatim është treguar si i saktë edhe gjatë realizimit të hulumtimit në terren. Për dallim nga komunikimi përmes postës elektronike apo telefonit me administratën komunale, i cili në pjesën më të madhe shkonte relativisht ngadalë dhe me vështirësi, duhet të theksohet se komunikimi i drejtpërdrejtë me zyrtarët komunalë ishte shumë më i mirë dhe më efikas në lidhje me hulumtimin. Pothuajse në të gjitha komunat ku është realizuar vizitë të komunave në terren, hulumtuesi është pranuar me mirëdashje nga ana e zyrtarëve komunalë, kështu që është prezantuar hulumtimi me theks mbi objektivat dhe planin e aktiviteteve në komunën konkrete. Administrata komunale në përgjithësi ishte e përgjegjshme, e sjellshme dhe bashkëpunuese gjatë qëndrimit në komunë, por megjithatë, dërgimi i dokumenteve dhe informacioneve plotësuese pas largimit nga komuna shkonte konsiderueshëm më vështirë.


2. Rezultatet e hulumtimit

2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Shkupit

Rezultatet e përgjithshme të realizuara për komunat e Rajonit të Shkupit bazohen në të dhënat e marra për 12 nga gjithsej 17 komuna që ishin përfshirë me hulumtimin. Numri maksimal i pikëve të komunave pas ponderimit është 10. Varësisht nga pikët e fituara pas ponderimit, komunat janë ndarë në 6 kategori sipas shkallës së përmbushjes së praktikave të qeverisjes së mirë. Njëkohësisht, për një notë kaluese konsiderohet nota 5.01 dhe ajo më e lartë, që paraqet 50% e pikëve të mundshme.

Nga njësitë e vetëqeverisjes lokale në Rajonin e Shkupit që ishin përfshirë me hulumtimin, rezultatin më të lartë e ka arritur Qyteti i Shkupit (8.09), ndërsa rezultati i realizuar mesatar i komunave ishte 3.32. Rezultatin më të dobët e ka Komuna e Zelenikovës me 0.42. Mesatarja për të gjitha 43 komunat është 3.53, që do të thotë se mesatarja e komunave të Rajonit të Shkupit është pak nën mesataren e përgjithshme. Mesatarja relativisht e ulët e komunave të Rajonit të Shkupit është kryesisht për shkak të faktit se 67% e komunave kishin rezultat nën 5.00, gjegjësisht nuk kanë arritur notën kaluese në hulumtim.

Grafiku 2. Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në krahasim me mesataren e përgjithshme



Nga grafiku 2 mund të shihet se komunat Ilinden, Karposh, Qendër, Aerodrom dhe Qyteti i Shkupit kanë arritur rezultate edhe mbi mesataren e rajonit dhe mbi mesataren e të gjitha 43 komunave. Megjithatë, në aspektin e notës kaluese, vetëm Qyteti i Shkupit (8.09), Komuna e Ilindenit (7.88), ajo e Karposhit (6.46) dhe ajo e Qendrës (5.44) kanë një rezultat mbi 5.01, gjegjësisht vetëm 33% të komunave, ndërsa 67% janë në grupin e komunave që nuk kanë arritur një notë kaluese.


Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:

²³ Neni 7,13,36, 42 i LIGJIT PËR VETËQEVERISJEN LOKALE TË RM-së "Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.5 nga data 29.01.2002

Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal

Komuna		Klasifikimi	Shkalla e qeverisjes së mirë
		Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
Qyteti i Shkupit	8,09	Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
Ilinden	7,88		
Karposh	6,46	Qeveris mirë	5.51-7.50
Qendër	5,44	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
Aerodrom	4,05		
Çair	2,05	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
Kisela Vodë	1,90		
Studenica	1,32	Qeveris shumë keq	0.0-1.50
Shuto Orizare	0,94		
Çußer Sandevë	0,82		
Saraj	0,43		
Zelenikovë	0,42		

Grafiku 3. Rezultatet e komunave të kombinuara me numrin e banorëve të komunës




Grafiku i lartë i kombinon rezultatet e komunave me numrin e banorëve të komunave²² për të përcaktuar korrelacionin midis rezultateve të arritura dhe numrit të banorëve të komunës. Për shkak të faktit se Qyteti i Shkupit ka statusin e një njësie të veçantë të vetëqeverisjes lokale dhe përbëhet nga numri i banorëve të komunave të Qytetit të Shkupit, ai është përjashtuar nga ky krahasim. Nga grafiku mund të shihet se linja e rezultateve të realizuara nuk ndjek trendin e numrit të banorëve të komunave. Kjo vërehet veçanërisht te Komuna e Ilindenit që ka rezultate më të mira nga komunat që janë objekt i krahasimit, kurse numri i banorëve është mjaft i vogël në krahasim me komunat e tjera. Nga ana tjetër, numri i banorëve të komunave Çair, Kisella Vodë dhe Saraj tejkalon në mënyrë të konsiderueshme rezultatin e realizuar. Komuna e Ilindenit është një komunë rurale, ndërsa Komuna e Karposhit, e cila ka rezultatin e dytë më të mirë në grafik, është një komunë urbane që do të thotë se ka përjashtime edhe te ky parametër. Konkluzioni për komunat e Rajonit të Shkupit që mund të nxirret në bazë të këtij korrelacioni është se rezultatet e arritura nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me numrin e banorëve të komunës, si dhe me klasifikimin e komunave rurale dhe urbane, por para të gjithash me përkushtimin e komunës dhe të administratës komunale ndaj parimeve të qeverisjes së mirë.

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Në aspektin e rezultateve sipas dimensioneve në të cilat janë të grupuar indikatorët, rezultatin më të mirë në dimensionin e parë - Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, ka arritur Komuna e Ilindenit me 0.99 nga 1.5 pikët e mundshme për këtë dimension. Rezultati mesatar i komunave në aspektin e këtij dimensionit për rajonin e Shkupit është 0.46, kurse rezultatin më të dobët në këtë dimension e ka arritur Komuna e Shuto Orizares me 0.07 pikë në këtë dimension. Gjatë ponderimit të rezultateve, këtij dimensionit i janë shtuar 15% të notës së përgjithshme edhe pse ky dimension ka numrin më të madh të indikatorëve (35). Arsyeja për këtë qëndron në faktin se numri më i madh i indikatorëve të këtij dimensionit janë një obligim ligjor i komunave, që do të thotë se komunat janë të obliguara t'i respektojnë dhe për këtë arsye nuk ka nevojë të shpërblehen për përmbushjen e indikatorit të këtij dimensionit. Megjithatë, pavarësisht obligimit ligjor që aktet themelore për funksionimin e komunave të jenë në dispozicion të opinionit, shqetëson fakti që tek 33% e komunave të anketuara të Rajonit të Shkupit Statuti dhe Rregullorja e punës e Këshillit të Komunës nuk ishin në dispozicion.


²⁴ <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/PDFGodisnik2013/03-Naselenie-Population.pdf>

Grafiku 4: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale



Sipas rezultateve të komunave në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve) rezultatet më të mira i ka arritur Qyteti i Shkupit me një rezultat të përgjithshëm prej 1.59 nga gjithsej 2.5 pikë ose 66% të përmbushjes së indikatorëve, ndërsa mesatarja e komunave të Rajonit të Shkupit është 0.52 pikë apo 21% e përmbushjes së indikatorëve. Rezultatin më të dobët e kanë komunat Saraj dhe Shuto Orizare me 0% të përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionit dhe zero pikë. Dimensionin e dytë që mat pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal nuk tregon një ngecje të konsiderueshme të komunave të Rajonit të Shkupit në aspektin e mesatares së të gjitha 43 komunave prej 23%. Përsëri, përqindja e lartë e komunave (83%) që kanë përqindjen e suksesit në përmbushjen e indikatorëve të dimensionin e dytë nën 50% e shtyjnë përqindjen e gjithë rajonin poshtë drejt komunave që janë dukshme jo bashkëpunuese. Kjo e dhënë është shqetësuese për zhvillimin e proceseve demokratike në nivel lokal, sepse pikërisht pjesëmarrja në vendimmarrje është një faktor kyç për qeverisje të mirë dhe pa dyshim duhet të ndërmerren masa për përmirësimin e situatës së këtillë.

Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)




Në dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënese komunale, 42% e komunave kanë më shumë se 1.25 pikë nga 2.5 pikët e mundshme, gjegjësisht kanë më shumë se gjysmën e pikëve të mundshme për këtë dimension. Pjesa tjetër prej 58% të komunave kanë arritur rezultate që janë më të vogla se gjysma e pikëve të mundshme.

Përgjegjshmëria e administratës komunale është një aspekt kyç në mundësimin e qytetarëve për të realizuar të drejtat e tyre dhe shpreh gatishmërinë e vetëqeverisjes lokale për t'i konsultuar qytetarët për shërbimet që i ofron ajo në drejtim të përmirësimit të tyre. Për të përmirësuar shërbimet që i ofrojnë për qytetarët, komunat kanë në dispozicion disa instrumente (formularë, anketa, pyetësorë, takime me qytetarët, tubime, format e demokracisë së drejtpërdrejtë etj), kështu që përmes këtij dimensionit matet se sa prej këtyre instrumenteve janë në dispozicion të qytetarëve, gjegjësisht komuna i ka përdorur gjatë periudhës së hulumtimit.


Ajo që mund të merret si konkluzion nga grafiku i mësipërm është se kryesisht komunat më të mëdha përdorin më shpesh mjetet e përgjegjshmërisë dhe kryesisht ato janë komunat urbane të Rajonit të Shkupit. Përfshirë bën Komuna e Ilindenit, e cila edhe pse është një komunë rurale dhe për nga numri i banorëve është një komunë më e vogël se, për shembull komuna Qendër, ajo ka arritur rezultate të mira. Arsyeja për përdorimin më të madh të mjeteve të përgjegjshmërisë në komunat më të mëdha, sipas intervistave të realizuara gjatë hulumtimit, është ajo se në komunat më të vogla administrata komunale është më shumë në dispozicion të qytetarëve sesa në komunat më të mëdha, kështu që kënaqësinë nga shërbimet qytetarët e komunave rurale mund ta shprehin drejtpërdrejt gjatë vizitës së komunës, ndërsa në ato të parat zëri i qytetarëve mund të dëgjohet në mënyrë më të mirë dhe më efektive me përdorimin e këtyre mjeteve.

Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale



Sipas rezultateve të dimensionit të katërt - Efektiviteti, efikasiteti dhe llogaridhënja e qeverisjes lokale, dy komuna - Qyteti i Shkupit dhe Komuna e Ilindenit kanë numrin maksimal të pikëve 3.5. Megjithatë, fakti se vetëm gjysma e komunave në këtë dimension kanë 0 pikë, kjo zvogëlon mesataren e komunave të rajonit në 1.2 pikë. Në këtë dimension është kontrolluar nëse komunat publikojnë programet vjetore të punës nëpër sektorët në një afat të caktuar kohor dhe nëse publikohen dokumente të lidhura me efektivitetin gjatë punës së komunës. Indikatorët e këtij dimensionit marrin pjesë me 35% të pikëve të përgjithshme të komunave për shkak se, siç është përmendur, indikatorët e këtij dimensionit edhe pse nuk janë një obligim ligjor i komunave, por janë një pikë referimi i shkëlqyer për atë se cilat komuna kanë vullnet t'i zbatojnë praktikatat e qeverisjes së mirë në nivel lokal, që është një nga objektivat e këtij hulumtimi.

Grafiku 7: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënja e qeverisjes lokale



2.3 Rezultatet sipas indikatorëve

Sipas përmbushjes së indikatorëve, komunat rezultatin më të mirë e kanë arritur te indikator 5 – Në komunë është emëruar një person për marrëdhënie me opinion, detyra e të cilit është që të informojë opinionin për punën e komunës për përmbushje prej 100% të këtij indikator, gjegjësisht të gjitha komunat e këtij rajoni kanë emëruar një person për marrëdhënie me opinion. Megjithatë, nga indikator tjetër - efikasiteti i personit për marrëdhënie me opinion, mund të shihet se edhe pse të gjitha komunat kanë emëruar një person të tillë, që është në fakt një obligim ligjor, jo në të gjitha komunat ky person kryen detyrën që i është caktuar, gjegjësisht në 75% e komunave ky person është funksional.

Një përmbushje prej 67% kemi te 6 indikatorë:

- 4 - Mbajtja e kolegjiemeve te kryetari i komunës me udhëheqësit e sektorëve, ndërmarrjet publike dhe shërbimet publike për një rrjedhje më të mirë të informacioneve midis administratës dhe rritje të transparencës së komunës
- 15 – Statuti i komunës është publikuar publikisht
- 16 – Rregulloja e Këshillit të Komunës është publikuar publikisht
- 23 - Transparenca e buxheteve të komunave
- 37 – A ka në komunë një procedurë për organizimin e konsultimeve me opinionin?
- 44 - Disponueshmëria e formularëve për qytetarët për të realizuar të drejtat e tyre (kërkesa, dëshira dhe ankesa)

Nga kjo listë mund të shihet se aktet dhe dokumentet themelore për funksionimin e komunës nuk janë të publikuara nga të gjitha komunat edhe krahas obligimit ligjor për të. Kjo është një e dhënë shqetësuese, sepse Rregullorja, Statuti dhe Buxheti i komunës duhet të jenë në dispozicion të të gjithë qytetarëve së paku me kërkesën e tyre, ndërsa rekomandohet që të njëjtat të publikohen edhe në faqen e internetit të komunës. Kolegjiemet te kryetari i komunës është një mjet i rëndësishëm organizativ dhe funksional në drejtim të rritjes së efikasitetit të administratës komunale, si dhe për të përmirësuar komunikimin e brendshëm mes të punësuarve. Megjithatë, shumicat e këtyre kolegjiemeve nuk mbahen sipas agjendës së paracaktuar paraprakisht, kurse padisponueshmëria e konkluzioneve është një pengesë për t'u kontrolluar nga ana e hulumtuesve përmbajtja e këtyre kolegjiemeve.

Pastaj, vijojnë 5 indikatorë me një përmbushje prej 58%:

- 17 –Buletini zyrtar e komunës është në dispozicion të qytetarëve
- 18 - Koha për konsultim të kryetarit të komunës me qytetarët
- 25 - Informimi për ofertën e shërbimeve komunale (shërbimet e sektorëve komunalë)
- 28 - Bashkëpunimi mes komunës dhe organizatave të qytetarëve
- 42 – Realizimi i së drejtës për ankesa dhe parashtrësia

Duke pasur parasysh faktin se përmbushja e këtyre indikatorëve është edhe obligimi ligjor i komunës, është shqetësues fakti se buletini zyrtar dhe informimi për ofertën e shërbimeve komunale ka një përqindje të përmbushjes prej vetëm 58%. Pastaj, komuna është e obliguar që t'i lejojë qytetarët e saj për t'i shfrytëzuar pa ndërprerje të drejtat e tyre për të parashtruar ankesa dhe parashtrësia, që do të thotë se duhet t'u mundësojë edhe formularë përkatës për atë, dhe t'u përgjigjet të njëjtëve me kohë dhe në mënyrë efikase, si dhe të veprojë në mënyrë përkatëse me ta. Mesatarja e përmbushjes së indikatorëve te komunat e Rajonit të Shkupit është 35%.

Katër indikatorë të listës nuk janë përmbushur nga asnjë komunë:

- 23.1 - Buxheti komunal për vitin e fundit, në formë të kuptueshme për qytetarët e rëndomtë (informacionet/shpjegimet) është publikuar në faqen e internetit të komunës + në dërrasën e shpalljeve dhe/ose në ndonjë mënyrë tjetër (të paktën 2 mënyra) në formën e

një dokumenti zyrtar.

23.2 - Kriteret dhe shuma e alokimit buxhetor të komunës për transferimet e fondeve nga institucionet kombëtare në ato lokale janë të publikuara në faqen e internetit të komunës

23.3 – Në informacionin për buxhetet komunale ka informacion mbi përdoruesit e buxhetit.

33.1 - Pjesëmarrja e Këshillit Rinor në punën e Këshillit të Komunës

Nga tabela e mësipërme mund të shihet se komunat nuk kanë zhvilluar një praktikë të publikimit të buxhetit komunal në një formë të kuptueshme për qytetarët e rëndomtë, gjegjësisht që të ardhurat dhe shpenzimet të prezantohen në mënyrë më të qartë, përmes grafikëve, tabelave dhe formave të tjera që do ta afrojnë buxhetin deri te qytetari mesatar, i cili nuk ka aftësitë e ekonomisë. Gjithashtu, për t'u rritur transparenca dhe llogaridhënia e komunave, një rëndësi të madhe do të kishte nëse në informacionet e buxhetit futen informacionet për shfrytëzuesit e buxhetit, që do të jepte një pasqyrë më të qartë për atë se cilët shfrytëzues të buxhetit sa shpenzojnë.

Sigurimi i pjesëmarrjes së Këshillit Rinor në punën e Këshillit të komunës, dhe komunat do të duhej të qaseshin drejt formimit të të njëjtave, nëse ende nuk i kanë formuar, dhe t'i trajtojnë ata si partnerë në vendimmarrjen në nivel lokal me qëllim të sigurohet që zëri i të rinjve të përfaqësohet në mënyrë përkatëse në nivel lokal.

Rekomandimet

Në bazë të rezultateve të fituara nga ky hulumtim, rekomandimet e përgjithshme për komunat e këtij rajoni do të ishin këto:

- **Statuti dhe Rregulloja si akte themelore për funksionimin dhe organizimin e komunave të jenë në dispozicion të të gjithë qytetarëve. Zgjidhja më e thjeshtë do të ishte që të njëjtat të jenë në dispozicion në internet, gjegjësisht në faqen e internetit të komunave**
- Komunat të miratojnë aktet përkatëse (**planin dhe rregulloren**) për transparencë në punën e organeve komunale
- **Buxheti si një dokument publik për atë se si planifikohet të shpenzohen paratë e qytetarëve të jetë në dispozicion të të gjitha komunave**
- Buletini zyrtar të jetë në dispozicion të të gjithë qytetarëve të paktën me kërkesën e tyre, e nëse ka mundësi edhe në faqen e internetit të komunës
- Komunat të publikojnë një listë të informacioneve të karakterit publik
- Komunat rregullisht të publikojnë **informacionet mbi prokurimin publik**
- Marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik të jenë në dispozicion të qytetarëve
- Komunat t'i publikojnë kriteret për ndarjen e mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve në faqet e tyre të internetit, ose të paktën të njëjtat të jenë në dispozicion me kërkesë të qytetarëve
- Të publikohet një listë të organizatave të qytetarëve që kanë marrë mbështetje financiare nga komuna
- Të publikohet një listë të kompanive të cilat për shkak të konfliktit të interesit nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e prokurimit publik
- Buxheti i komunës të jetë në dispozicion edhe në një formë të kuptueshme për qytetarin e rëndomtë - buxheti i qytetarëve
- Komunat të publikojnë një listë të shërbimeve që i ofrojnë për qytetarët

Komunat të sigurojnë një qasje deri te formularët për realizimin më të lehtë të kërkesave nga ana e qytetarëve

Rekomandimet për komunat

Rekomandimet për Komunën e Karposhit

- Të informohet opinioni për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit minimum 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes (në internet, në dërrasën e shpalljeve dhe në mediat), përveç për mbledhjet e jashtëzakonshme;
- Materialet e punës të jenë në dispozicion të anëtarëve të Këshillit së bashku me ftesat për mbledhje, por jo më pak se 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes; aktualisht materialet e punës janë në dispozicion vetëm të personave me profilet përdoruese në faqen e internetit të komunës, e jo për opinionin e gjerë;
- Materialet e punës të jenë në dispozicion edhe të qytetarëve të komunës, me kërkesën e tyre ose në faqen e internetit të komunës;
- Procesverbalet e mbledhjeve të këshillit të publikohen në faqen e internetit të komunës;
- Kriteret për ndarjen e mjeteve financiare të organizatave të qytetarëve të publikohen publikisht në faqen e internetit;
- Rregullat e komunës (Statuti, rregullorja etj.) të vendosen në faqen e internetit të komunës;
- Të mundësohet një qasje për qytetarët deri të marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik (të vendosen në faqen e internetit të komunës);
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë që për shkak të konfliktit të interesit nuk mund të marrin pjesë në procedurën e tenderit;
- Buxheti të publikohet edhe në një formë të kuptueshme për qytetarët (me informacione për përdoruesit e buxhetit);
- Për secilin aktivitet të planifikuar komuna ta publikojë edhe buxhetin e paraparë për këtë aktivitet
- Të publikohet një listë të organizatave të qytetarëve të cilëve u janë ndarë mjete financiare

Rekomandimet për Komunën e Kisella Vodës

- Këshilli të miratojë një rregullore dhe një planin për transparencën e punës së komunës
- Materialet e punës për mbledhjet e Këshillit të komunës të jenë në dispozicion edhe të opinionit (në faqen e internetit ose në dërrasën e shpalljeve)
- Procesverbalet e mbledhjes të jenë në dispozicion të qytetarëve në faqen e internetit, dërrasën e shpalljeve ose me kërkesë të qytetarëve
- Të vendoset një praktikë të përdorimit të institutit “pyetjet e këshilltarëve” në mbledhjet në fillimin e mbledhjeve. Të njëjtat mund të definojnë dhe të përcaktohen me Rregulloren dhe Statutin e komunës
- Të përcaktohet një ditë për takime të kryetarit të komunës me qytetarët dhe ajo ditë të respektohet
- Të publikohen marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik (në faqen e internetit, në dërrasën e shpalljeve ose në ndonjë mënyrë tjetër)
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e tenderit për shkak të konfliktit të interesit
- Të dorëzohen vendimet për punësime në administratën komunale për t'i shqyrtuar qytetarët

- Të publikohen kriteret për ndarjen e mjeteve për organizatat e qytetarëve
- Komuna të publikojë programin vjetor me indikatorët e suksesit
- Të publikohen informacione në lidhje me organet që monitorojnë punën e komunës (Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale).

Rekomandimet për Komunën e Qendrës

- Këshilli të miratojë një rregullore dhe një plan për transparencën e punës së këshillit të komunës
- Procesverbalet e mbledhjes të jenë në dispozicion të qytetarëve në faqen e internetit, dërrasën e shpalljeve ose me kërkesë të qytetarëve
- Të vendoset një praktikë të përdorimit të institutit “pyetjet e këshilltarëve” në mbledhjet në fillimin e mbledhjeve. Të njëjtat mund të definojnë dhe të përcaktohen me Rregulloren dhe Statutin e komunës
- Të respektohet termi i përcaktuar i kryetarit të komunës për takime me qytetarët
- Të publikohen marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik (në faqen e internetit, në dërrasën e shpalljeve ose në ndonjë mënyrë tjetër)
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e tenderit për shkak të konfliktit të interesit
- Të publikohen kriteret për ndarjen e mjeteve për organizatat e qytetarëve
- Të përdoren pyetësorë për kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet që i ofron komuna
- Komuna të publikojë programin vjetor me indikatorët e suksesit
- Të publikohen informacione në lidhje me organet që monitorojnë punën e komunës (Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale).

Rekomandimet për Komunën e Shuto Orizares

- Komuna duhet të jetë e hapur për qytetarët edhe në lidhje me dorëzimin e informacioneve, por edhe në kuptim të plotë, gjegjësisht të shmangen praktikat e këtilla të mbylljes së komunës. Duhet të gjendet një mënyrë për të zgjidhur situatën me kërkesat që nuk janë në kompetencë të komunës. Për të tejkaluar këtë situatë ne propozojmë:
 - o Të caktohet një person i cili do t'i drejtojë këta qytetarë në vendet e duhura për kërkesat dhe pyetjet e tyre
 - o Të mbahet një sërë ligjëratash për kompetencat e komunës në të cilat të punësuarit në administratën komunale me kryetarin e komunës do të kërkojnë një zgjidhje për nevojat e qytetarëve
 - o Në afat të gjatë – të mbahet të paktën një herë në muaj një takim me qytetarët në të cilin do të diskutohet për të gjitha çështjet që janë me interes të qytetarëve, e që nuk janë në kompetencë të komunës. Mysafirë në këto takime do të ishin përfaqësues të institucioneve që janë përgjegjëse për zgjidhjen e këtyre problemeve të qytetarëve.
- Të promovohen mjetet për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe në matjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara, si ekrani me prekje i vendosur në kuadër të iniciativës “Komuna ime” nga ana e Programit për Zhvillim të OKB-së (UNDP) në Maqedoni
- Duke pasur parasysh rezultatet e dobëta, ekipi hulumtues i QHKP-së, veçanërisht për Komunën e Shuto Orizares, i vihet në dispozicion komunës që t'i rishikojnë bashkërisht dobësitë dhe të japin propozime për tejkalimin e dobësive. Për këtë do të ngrihet një iniciativë nga ana jonë, dhe nëse komuna pranon, këto aktivitete do të ishin pjesë e angazhimeve për shkëmbimin provues të përvojave pozitive nga komunat e tjera dhe zbatimin e tyre praktike në komunën konkrete.

²⁵ Aktivitetet për shkëmbimin dhe zbatimin e praktikave më të mira të komunave do të mund të zbatoheshin në të gjitha komunat e përfshira me hulumtim, nëse shprehin vullnet për këtë.

Rekomandimet për Komunën e Zelenikovës

- Komuna ta vërë në funksion faqen e internetit të komunës në të cilën qytetarët do të mund të informohen për aktivitetet e komunës. Si alternativë mund të përdoret më shumë profili i rrjeteve sociale me çka informacionet do të arrinin deri te një numër më i madh i qytetarëve të cilët janë përdorues të rrjeteve sociale;
- Të organizohen më shpesh takime me qytetarët dhe të inkurajohen qytetarët që të parashtrojnë iniciativë të qytetarëve. Gjithashtu duhet t'u shpjegohet procedura e parashtrimit, si dhe obligimet e komunës se si duhet të veprojnë me këto iniciativë;
- Këshilli të miratojë një rregullore dhe një plan për transparencën e punës së këshillit të komunës
- Procesverbalet e mbledhjes të jenë në dispozicion të qytetarëve në faqen e internetit, dërrasën e shpalljeve ose me kërkesë të qytetarëve
- Të vendoset një praktikë të përdorimit të institutit “pyetjet e këshilltarëve” në mbledhjet në fillimin e mbledhjeve. Të njëjtat mund të definojnë dhe të përcaktohen me Rregulloren dhe Statutin e komunës
- Të respektohet termi i përcaktuar i kryetarit të komunës për takime me qytetarët
- Të publikohen marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik (në faqen e internetit, në dërrasën e shpalljeve ose në ndonjë mënyrë tjetër)
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e tenderit për shkak të konfliktit të interesit
- Buxheti i komunës të prezantohet edhe në një formë të kuptueshme për qytetarët
- Të publikohet llogaria përfundimtare
- Të publikohen kriteret për ndarjen e mjeteve për organizatat e qytetarëve
- Të përdoren pyetësorë për kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet që i ofron komuna
- Komuna të publikojë programin vjetor me indikatorët e suksesit
- Të publikohen informacione në lidhje me organet që monitorojnë punën e komunës (Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale).

Rekomandimet për Komunën e Ilindenit

- Njoftimi me kohë i qytetarëve për ditën e mbajtjes së mbledhjeve të këshillit në afat prej 7 ditësh paraprakisht;
- Të sigurohet një qasje deri te procesverbalet e mbledhjeve të këshillit në faqen e internetit të komunës
- Marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik të vendosen në faqen e internetit të komunës
- T'u mundësohet qytetarëve që ta realizojnë më lehtë të drejtën e tyre për ankesa dhe parashtrësia. Formularët për plotësimin e ankesave dhe parashtrësive të vendosen në hyrje, kurse kutia e ankesave dhe parashtrësive të jetë në një vend ku qytetarët do të mund t'i dorëzojnë në mënyrë anonime;
- Mundësimi i një qasjeje më të lehtë të qytetarëve deri te informacionet e karakterit publik;
- Të vendoset kodi etik në një vend të dukshëm për qytetarët;

Rekomandimet për Komunën e Studenizanit

- Miratimi i një plani dhe një rregulloreje për transparencën e punës së komunës
- Mbajtja e kolegjiemeve të kryetari i komunës të paktën një herë në muaj, në të cilin do të mundësohet rrjedhja e brendshme e informacioneve, e cila nga ana tjetër është e rëndësishme për shkëmbimin e informacioneve me opinion dhe ngritjen e nivelit të efikasitetit dhe efektivitetit të administratës komunale
- Të caktohet një person për marrëdhënie me opinion i cili do të jetë funksional dhe do t'u

përgjigjet pyetjeve të qytetarëve.

- Qytetarët të njoftohen për mbajtjen e mbledhjes së këshillit të komunës minimum shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjes
- Materialet për mbledhje të dërgohen me kohë dhe të jenë në dispozicion edhe të opinionit të interesuar;
- Buxheti komunal të jetë në dispozicion të opinionit (në faqen e internetit, në dërrasën e shpalljeve etj).
- Buxheti komunal të jetë në formë të kuptueshme për qytetarët
- Të publikohet llogaria përfundimtare dhe dokumentet e tjera financiare
- Të përdoren pyetësorë për cilësinë e shërbimeve të administratës komunale

Rekomandimet për Komunën e Sarajit

Njësoj si edhe për Komunën e Shuto Orizares, edhe për Komunën e Sarajit, duke pasur parasysh rezultatet e dobëta, ekipi hulumtues i QHKP-së i vihet në dispozicion komunës që t'i rishikojnë bashkërisht dobësitë dhe të japin propozime për tejkalimin e dobësive. Për këtë do të ngrihet një iniciativë nga ana jonë, dhe nëse komuna pranon, këto aktivitete do të ishin pjesë e angazhimeve për shkëmbimin provues të përvojave pozitive nga komunat e tjera dhe zbatimin e tyre praktike në komunën konkrete.

Për dobësitë e tjera të zbuluara, edhe pse ka shumë, i ndajmë këto për të cilat konsiderojmë se janë me prioritet të lartë

- Komuna ta vërë në funksion faqen e internetit të komunës në të cilën qytetarët do të mund të informohen për aktivitetet e komunës. Si alternativë mund të përdoret më shumë profili i rrjeteve sociale me çka informacionet do të arrinin deri te një numër më i madh i qytetarëve të cilët janë përdorues të rrjeteve sociale;
- Të organizohen më shpesh takime me qytetarët dhe të inkurajohen qytetarët që të parashtrojnë iniciativë të qytetarëve. Gjithashtu duhet t'u shpjegohet procedura e parashtrimit, si dhe obligimet e komunës se si duhet të veprojnë me këto iniciativë;
- Këshilli të miratojë një rregullore dhe një plan për transparencën e punës së këshillit të komunës
- Procesverbalet e mbledhjes të jenë në dispozicion të qytetarëve në faqen e internetit, dërrasën e shpalljeve ose me kërkesë të qytetarëve
- Të vendoset një praktikë të përdorimit të institutit “pyetjet e këshilltarëve” në mbledhjet në fillimin e mbledhjeve. Të njëjtat mund të definojnë dhe të përcaktohen me Rregulloren dhe Statutin e komunës
- Të publikohen buxheti dhe dokumentet e tjera të lidhura me punën financiare të komunës;

Rekomandimet për Komunën e Aerodromit

- Këshilli të miratojë një rregullore dhe plan për transparencë në punën së këshillit të komunës
- Procesverbalet e mbledhjes të jenë në dispozicion të qytetarëve në faqen e internetit, dërrasën e shpalljeve ose me kërkesë të qytetarëve
- Të publikohen marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik (në faqen e internetit, në dërrasën e shpalljeve ose në ndonjë mënyrë tjetër)
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e tenderit për shkak të konfliktit të interesit
- Të publikohet buxheti i komunës në një formë të kuptueshme për qytetarët
- Të përdoren pyetësorë për kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet që i ofron komuna
- Komuna të publikojë programin vjetor me indikatorët e suksesit
- Të publikohen informacione në lidhje me organet që monitorojnë punën e komunës

(Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale).

Rekomandimet për Komunën e 3uzer Sandevës

- Të miratohet një plan dhe një rregullore për transparencën e punës së komunës
- Mbatja e kolegji meve te kryetari i komunës të paktën një herë në muaj, në të cilin do të mundësohet rrjedhja e brendshme e informacioneve, e cila nga ana tjetër është e rëndësishme për shkëmbimin e informacioneve me opinionin dhe ngritjen e nivelit të efikasitetit dhe efektivitetit të administratës komunale
- Të caktohet një person për marrëdhënie me opinion i cili do të jetë funksional dhe do të përgjigjet në pyetjet e qytetarëve.
- Qytetarët të njoftohen për mbajtjen e mbledhjes së këshillit të komunës minimum shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjes
- Materialet për mbledhje të dërgohen me kohë dhe të jenë në dispozicion edhe të opinionit të interesuar;
- Buxheti komunal të jetë në dispozicion të opinionit (në faqen e internetit, në dërrasën e shpalljeve etj).
- Buxheti komunal të jetë në formë të kuptueshme për qytetarët
- Të publikohet llogaria përfundimtare dhe dokumentet e tjera financiare
- Të përdoren pyetësorë për cilësinë e shërbimeve të administratës komunale

Rekomandimet për Qytetin e Shkupit

- Të miratohet dhe të zbatohet një rregullore dhe një plan për transparencën e punës së Qytetit të Shkupit
- Njoftimi i qytetarëve për mbajtjen e mbledhjes të paktën 7 ditë para mbajtjes së saj në faqen e internetit ose përmes ndonjë mediumi tjetër
- Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të jenë në dispozicion në faqen e internetit të komunës
- Të qaset drejt publikimit të buxhetit në formë të kuptueshme për qytetarët
- Kriteret për ndarjen e mjeteve financiare të publikohen publikisht në faqen e internetit të komunës
- Të lehtësohet qasja deri te informacionet e karakterit publik për qytetarët

Rekomandimet për Komunën e 3airit:

- Të miratohet një plan dhe një rregullore për transparencën e punës së komunës
- Mbatja e kolegji meve te kryetari i komunës të paktën një herë në muaj, në të cilin do të mundësohet rrjedhja e brendshme e informacioneve, e cila nga ana tjetër është e rëndësishme për shkëmbimin e informacioneve me opinionin dhe ngritjen e nivelit të efikasitetit dhe efektivitetit të administratës komunale
- Të caktohet një person për marrëdhënie me opinion i cili do të jetë funksional dhe do të përgjigjet në pyetjet e qytetarëve.
- Qytetarët të njoftohen për mbajtjen e mbledhjes së këshillit të komunës minimum shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjes
- Materialet për mbledhje të dërgohen me kohë dhe të jenë në dispozicion edhe të opinionit të interesuar;
- Buxheti komunal të jetë në dispozicion të opinionit (në faqen e internetit, në dërrasën e shpalljeve etj).
- Buxheti komunal të publikohet edhe në formë të kuptueshme për qytetarët
- Të publikohet llogaria përfundimtare dhe dokumentet e tjera financiare
- Të përdoren pyetësorë për cilësinë e shërbimeve të administratës komunale.

Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar juglindor

hulumtues: Beti Pejeva

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave

Me hulumtimin në kuadër të studimit LOTOS në Rajonin e planifikuar juglindor janë përfshirë komunat Strumicë, Radovish, Novo Sellë dhe Bogdanc.


Me fillimin e aktiviteteve hulumtuese në maj të vitit 2014 në këto komuna, një nga sfidat më të mëdha ishte vendosja e kontaktit të parë me komunat dhe gjetja e qasjes së duhur për marrjen e informacioneve përkatëse dhe reale, sidomos duke pasur parasysh se përfaqësuesit e komunave jo çdoherë i prezantojnë të dhënat e vërteta në lidhje me punën e tyre. Ishte e nevojshme për të gjetur personat e duhur në komunë, të cilët njëkohësisht do të mund t'i japin informacionet përkatëse, por edhe të jenë të përgatitur dhe të kenë kapacitet për të ndryshuar praktikën e vendosura me qëllim që të përmirësohet puna e komunës së tyre. Rreziku i vonësës së informacioneve dhe hapja e pamjaftueshme për bashkëpunim ishte një sfidë reale, por është tejkaluar me sukses me këmbëngulje në kërkesën për dërgimin e informacioneve, duke përfshirë edhe pyetësorin. Megjithatë, për shkak të verifikimit të informacioneve të marra kemi konsultuar disa burime, duke përfshirë këtu edhe bisedat joformale me banorët vendas, gazetarët lokalë, përfaqësuesit e mediave, komunitetin e biznesit dhe organizatat e qytetarëve, që kishte një rëndësi të veçantë për kompletimin e imazhit real për funksionimin e komunës.

Informimi dhe shpjegimi i plotë i objektivave të projektit ishin të nevojshme për një pjesë të administratës komunale që të kuptojë se projekti punon në favor të avancimit të punës së komunave dhe se me krijimin e një atmosfere të konkurrencës në mes të komunave, në fakt rritet benefiti edhe për përdoruesit e shërbimeve, por edhe për autoritetet komunale.

Kontakti i drejtpërdrejtë me administratën komunale për marrjen e informacioneve të caktuara është treguar si një nga metodat më të mira për realizimin e hulumtimit të plotë, jo vetëm për shkak të faktit se në atë mënyrë të punësuarit me të cilët bashkëpunonim bëheshin më të hapur për pranimin e disa sugjerimeve dhe udhëzimeve tona, por edhe për shkak të ndjekjes së drejtpërdrejtë të funksionalitetit të shërbimeve komunale, efikasitetit dhe profesionalizmit të tyre, si dhe shqyrtimi i gjendjes drejtpërdrejt "në terren". Megjithatë, qasja e tillë kërkonte praninë e shpeshtë të hulumtuesve në komunat që janë gjeografikisht të largët nga njëra-tjetra, disa më shumë se 100 km nga selia jonë.

Përdorimi i mjeteve të ndryshme për mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim, ka kontribuar për një besueshmëri më të madhe të të dhënave që rrit besueshmërinë e tyre dhe për këtë qëllim janë përdorur disa metoda të ndryshme për mbledhjen e informacioneve: pyetësorë, hulumtime në terren, informacione nga ndjekja e faqeve të internetit si dhe përdorimi i mjetit "blerësit sekretë".

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e Rajonit juglindor




Siç mund të shihet nga grafiku më lart, gjatë hulumtimit kemi arritur t'i sigurojmë të gjitha burimet e të dhënave të komunave, përveç rregullores së Komunës së Novo Sellës. Kjo do të thotë se gjatë kontrollimit të të dhënave, mund të konsultonim më shumë burime të informacioneve.

2. Rezultatet e hulumtimit

2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin juglindor

Në Rajonin juglindor Komuna e Strumicës ka rezultatin më të mirë prej 8.48, që është edhe rezultati më i mirë i përgjithshëm nga të gjitha 43 komunat. Mesatarja e këtij rajoni është mjaft e lartë dhe është 5.49, që do të thotë se këto komuna së bashku tejkalojnë kufirin prej 5.00 pikë për një notë kaluese. Rezultate më të dobëta në këtë rajon ka Komuna e Novo Sellës me 1.15 pikë, që zvogëlon në mënyrë të konsiderueshme mesataren e komunave të tjera. Sa për krahasim, pa rezultatet e kësaj komune, mesatarja do të ishte 6.93.


Grafiku 2. Rezultatet e komunave të Rajonit juglindor në krahasim me mesataren e përgjithshme dhe rajonale



Duhet të theksohet se rezultatet e Komunës së Strumicës në masë të madhe dalin nga bashkëpunimi i komunës me organizatat e qytetarëve në drejtim të përmirësimit të transparencës së komunës. Megjithatë, mbetet përshtypja se në të gjitha komunat, pavarësisht rezultateve të treguara, ka shumë hapësirë për përmirësim dhe avancim të punës, vezanërisht në pjesën e përfshirjes aktive të qytetarëve në krijimin e politikave.

Pjesëmarrja në vendimmarrje në komunat është një nga të drejtat themelore të qytetarëve. Pa dallim se edhe vetë ligji për vetëqeverisje lokale parasheh një spektër të gjerë formash për pjesëmarrje të qytetarëve, kjo e drejtë e qytetarëve, kurse nga ana tjetër obligimi i komunës, konsiderohet si një nga mënyrat për arritjen e demokracisë lokale edhe pa qenë e specifikuar saktë në rregulloren ligjore. Prandaj, komuna e cila punon në bazë të parimeve të qeverisjes së mirë, vetë gjen dhe përdor mënyra dhe forma të ndryshme përmes të cilave mundëson pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Rëndësia e kësaj të drejte del nga ajo që vendimet e vetëqeverisjes lokale në masë të madhe përcaktojnë jetën dhe punën e qytetarëve.

Grafiku 3: Rezultatet në krahasim me numrin e banorëve



Nga tabela mund të shihet se numri i popullatës në rastin e komunave të Rajonit të planifikuar juglindor nuk është e një rëndësie vendimtare për sa i përket rezultateve. Për shembull, Komuna e Bogdancit, edhe pse është më e vogël për nga numri i popullatës, ka arritur rezultate më të mira se Komuna e Novo Sellës, e cila është komuna më e madhe. Megjithatë, qasja më e mirë deri te infrastruktura dhe kapaciteti e njerëzve duket se është vendimtare në rastin e Komunës së Strumicës dhe Radovishit, të cilat kanë arritur rezultate të mira, jo vetëm në aspektin e rajonit, por edhe në krahasim me 43 komunat e tjera.

Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:

Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal


Komuna	Klasifikimi	Shkalla e qeverisjes së mirë
Strumica	Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
	Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
Bogdanci	Qeveris mirë	5.51-7.50
Radovis	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
Novo Selo	Qeveris shumë keq	0.0-1.50

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Rezultatin më të mirë në dimensionin e parë - Hapja dhe transparencja gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, nga komunat e këtij rajoni ka arritur Komuna e Strumicës me 1.24 pikë nga 1.5 pikët e mundshme në këtë dimension. Rezultati mesatar i këtij dimensionit për Rajonin juglindor është 0.89 dhe madje tri komuna kanë arritur rezultate mbi këtë mesatare: Bogdanci me 0.99, Radovishi me 0.89 dhe siç thamë Strumica. Rezultatet më të dobëta në këtë dimension ka Komuna e Novo Sellës me një rezultat modest prej 0.27.

Siç mund të shihet nga rezultatet, mesatarja e këtij rajoni është më e lartë se mesatarja e përgjithshme e të gjitha 43 komunave, e cila është 0.54 për këtë dimension.

Grafiku 4: Rezultatet e komunave të Rajonit juglindor në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparencja gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale



Mirëpo, pavarësisht rezultateve të shkëlqyera të cilat i kanë arritur këto komuna, megjithatë gjatë hulumtimit janë vërejtur edhe disa sfida me të cilat ballafaqohen. Domethënë, asnjë nga komunat e përfshira me hulumtim nuk kanë miratuar një plan për transparencën në punën e komunës, në të cilin janë operacionalizuar procedurat për transparencë në punën e komunës, edhe pse një formë e tillë është rekomanduar edhe nga BNJVL-ja.

Kolegijimet te kryetari i komunës me udhëheqësit e sektorëve janë një praktikë e vendosur vetëm në komunat më të mëdha, ndërsa në ato më të voglat realizohen sipas nevojës.

I njëjti përfundim vlen edhe për njoftimet për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit, si dhe për publikimin e rendit të ditës së mbledhjeve. Dorëzimi me kohë dhe disponueshmëria e materialeve të punës për mbledhjet e Këshillit është problem pothuajse në të gjitha komunat. Në komunat më

të vogla, transparenca në punën e këshillit është vështirësuar plotësisht me mungesën e mediave lokale.

Statutet dhe rregulloret e punës së këshillave të Strumicës, Radovishit dhe Bogdancit janë të publikuara publikisht përmes lidhjeve të drejtpërdrejta në faqet e internetit ose në Buletin zyrtar, ndërsa nga Komuna e Novo Sellës mund të merren me shkresë ose kërkesë për qasje deri te informacionet e interesit publik.

Buletinet zyrtare të Komunës së Strumicës, Radovishit dhe Bogdancit publikohen rregullisht në faqet e internetit të komunave dhe janë të radhitura në mënyrë kronologjike sipas viteve, ndërsa buletinet zyrtare të Komunës së Novo Sellës nuk janë në dispozicion të opinionit.


Buxhetet komunale, raportet financiare, llogaritë përfundimtare, si dhe njoftimet për rebalancin e buxheteve të Komunës së Strumicës dhe Bogdancit janë në dispozicion në faqet e internetit nëpërmjet lidhjeve të drejtpërdrejta, gjegjësisht buletineve zyrtare, ato të Komunës së Radovishit vetëm në buletinet zyrtare, ndërsa ato të Komunës së Novo Sellës nuk janë në dispozicion, përveç me një kërkesë për qasje deri te informacionet e karakterit publik.

Koha e Kryetarit të komunës për konsultim me qytetarët është e rregulluar, kurse respektimi i ditëve të publikuara për takim praktikohet në të gjitha komunat që ishin objekt i hulumtimit.

Asnjë prej komunave të hulumtuara nuk e ka publikuar Planin e prokurimit publik, procedurat e publikuara, të lidhura dhe të anuluar të prokurimit publik. Strumica dhe Radovishi kanë vendosur një lidhje deri në faqen e Sistemit Elektronik të Prokurimit Publik (SEPP) të Byrosë së Prokurimit Publik, ku duhet të shqyrtohen shpalljet, kurse marrëveshjet e lidhura publikohen me një vonesë prej 6 muajsh, kështu që nuk është e mundur të kihet një pasqyrë për marrëveshjet e lidhura aktuale.

Në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve) rezultatet më të mira i ka arritur përsëri komuna e Strumicës me 1.59 pikë, e pastaj vijnë Komuna e Radovishit me 1.25 dhe ajo e Bogdancit 0.91. Mesatarja në mes të komunave për këtë dimension është 1.32, që është mbi mesataren në kuadër të hulumtimit, e cila është 0.57.

Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit juglindor në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)



Edhe pse bashkëpunimi me organizatat e qytetarëve jo formalisht ekziston në të gjitha komunat, megjithatë prezenca e dokumentuar në mbledhjet e këshillit nga ana e përfaqësuesit të organizatave të qytetarëve është vërejtur vetëm në Komunën e Strumicës. Në aspektin e transparencës gjatë ndarjes së mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve, më të mira janë Komuna e Strumicës dhe Komuna e Bogdancit, ndërsa në Komunën e Novo Sellës nuk ka një praktikë të tillë.

Është interesante të përmendet se, edhe pse rezultatet tregojnë këtë situatë, përveç Komunës së Strumicës e cila ka një praktikë të rregullt të përmbledhjes së sugjerimeve dhe propozimeve nga ana e bashkësive lokale, Komuna e Bogdancit është një nga komunat e pakta ku shpallet një konkurs për bashkësitë lokale për ndarjen e mjeteve nga Buxheti komunal, madje ka edhe raste të mbledhjes së propozimeve nga këshillat shtëpiakë.

Këshilli Rinor është formuar vetëm në komunat e Strumicës dhe të Radovishit, kurse përfaqësuesit e të njëjtit marrin pjesë në mbledhjet e këshillit.


Informacionet për komisionet e formuara nga ana e komunës dhe punën e tyre publikohen nga ana e komunave të Strumicës dhe Radovishit, ndërsa organet këshillëdhënëse në të cilat hyjnë përfaqësuesit e organizatave të qytetarëve apo komuniteti i biznesit, ka vetëm në Komunën e Strumicës dhe ata marrin pjesë në punën e këshillit.

Sipas përgjigjeve të pyetësorit, në të gjitha katër komunat ka bashkësi të formuara urbane dhe rurale të cilat funksionojnë. Megjithatë, me hulumtimet në terren është konstatuar se vetëm në Komunën e Strumicës ka një departament dhe një referent për punë me bashkësitë urbane dhe rurale.

Rezultatet e komunave të Rajonit juglindor për dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale, janë këto: Komuna e Strumicës ka 2.14 pikë nga 2.5 pikët e

mundshme, pastaj vijojnë Bogdanci me 1.79 dhe Radovishi me 1.25, ndërsa e fundit është Novo Sella me 0.54. Kjo do të thotë se Strumica, Bogdanci dhe Radovishi kalojnë pragun e 50% për këtë dimension, dhe kanë arritur rezultate mbi mesataren e 43 komunave, e cila është 1.22 për këtë dimension.

Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit juglindor në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënse komunale



Këtu gjithashtu duhet të theksohet se nga hulumtimet në terren që janë praktikuar rregullisht në të gjitha komunat e përfshira me hulumtim, përshtypja e hulumtuesit është se në lidhje me përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, të paktën në takimet që janë mbajtur gjatë hulumtimit, pothuajse të gjitha komunat kanë qenë në një nivel të ngjashëm, por duhet të merren në konsideratë edhe mjetet e tjera që janë përdorur.

Megjithatë, për të fituar një pasqyrë të vërtetë për punën e administratës komunale, në ndonjë hulumtim të ardhshëm duhet të parashikohen edhe mbledhja e mendimeve dhe realizimi i intervistave me qytetarët që përdorin shërbimet e komunës, me përfaqësuesit e organizatave të qytetarëve dhe të komunitetit të biznesit.

Planet urbanistike kryesisht miratohen në konsultim me opinionin, siç është e rregulluar me Ligjin për urbanizëm.

Në të gjitha komunat përveç në Komunën e Novo Sellës ka procedura për konsultime me opinionin. Në Komunën e Strumicës ka edhe një strategji të komunikimit dhe një plan operativ për marrëdhënie me opinion, kurse praktika e mbajtjes së konsultimeve publike vërehet më shumë në Komunën e Strumicës dhe dizka më pak në Komunën e Radovishit.

Komuna e Strumicës dhe e Novo Sellës përdorin pyetësorë për të parë kënaqësinë e qytetarëve nga shërbimet. Komuna e Strumicës përdor pyetësorë për shërbimet e pothuajse të gjitha sferave, ndërsa Komuna e Novo Sellës përdor pyetësorë të tillë në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve.


Nga katër komunat e hulumtuara, vlerësimin e nevojave të bashkësisë lokale e bën vetëm Komuna e Strumicës.

Informacionet dhe formularët për realizimin e të drejtës së qasjes deri te informacionet e karakterit publik janë në dispozicion në faqet e internetit të komunës së Strumicës dhe të Bogdancit, ndërsa formularët dhe kërkesat për realizimin e të drejtave të caktuara dhe përdorimin e shërbimeve komunale janë në dispozicion në formën elektronike në faqen e internetit të Komunës së Strumicës, Radovishit dhe Bogdancit, ndërsa në Komunën e Novo Sellës ato mund të sigurohen në Qendrën për Shërbime të Qytetarëve.

Asnjë nga komunat nuk ka procedurë të veçantë me shkrim për realizimin e së drejtës së ankesave dhe parashtresave nga ana e qytetarëve, gjegjësisht, në dërrasën e shpalljeve dhe në faqen e internetit të komunave nuk ka informacione për proceset zyrtare me hapa të qartë për parashtrimin e një ankesë dhe parashtrese nga ana e qytetarëve, por administrata komunale u përgjigjet ankesave dhe parashtresave në përputhje me rregulloren ligjore aktuale, apo me procedurat sipas standardeve të vendosura ISO të cilësisë, siç është rasti në Komunën e Strumicës, ku në hyrje të komunës është vendosur edhe një libër për të shkruar përshtypjet nga ana e qytetarëve të cilët e vizitojnë komunën.

Sipas rezultateve të dimensionit të katërt i cili mat Efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, më shumë pikë ka Komuna e Strumicës - 3.50, që është rezultati maksimal i pikëve të mundshme për këtë dimension. Mesatarja për këtë dimension është 2.19 për Rajonin juglindor, ndërsa rezultatin më të dobët e ka Komuna e Novo Sellës me 0 pikë. Bogdanci dhe Radovishi kanë numrin e barabartë të pikëve - 2.63, dhe pa dyshim komunat e këtij rajoni kanë një nga mesataret më të larta në këtë dimension

Grafiku 7: Rezultatet e komunave të Rajonit juglindor në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e qeverisjes lokale



Vetëqeverisjet lokale të Strumicës, Radovishit dhe Bogdancit zakonisht informojnë për arritjet e politikave të caktuara që kanë dalë si rezultat i kërkesave, apo iniciativave të qytetarëve. Informacionet e këtilla mund të gjenden në faqet e tyre të internetit, faqet e Facebook-ut dhe internet portalet, si dhe përmes mediave lokale (aty ku ekzistojnë ato).

Në të gjitha komunat kodet e miratuara etike janë të publikuara në vende të dukshme, zakonisht në hollin e ndërtesës komunale.

Në Komunën e Strumicës dhe Komunën e Bogdancit publikohen edhe programet vjetore nëpër sektorët dhe buxhetin e parashikuar për të njëjtat, kurse në faqet e internetit publikohet edhe rebalanci i buxhetit.

Informacione konkrete për organet që monitorojnë punën e komunave nuk ekzistojnë, përveç një lidhje deri në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe BNJVL, ku mund të gjenden informacione të këtilla, siç është shembulli i faqes së internetit të Komunës së Strumicës.

REKOMANDIME

- Të përgatitet dhe miratohet një plan për transparencën e punës së komunave.
- Komunitat t'i publikojnë në faqet e tyre të internetit planet e prokurimit publik, shpalljet e prokurimit publik dhe marrëveshjet e lidhura të prokurimit publik.
- Buxheti, llogaria përfundimtare dhe raportet financiare të publikohen në një formë të kuptueshme për qytetarët.
- Të përpilohet dhe zbatohet një plan për nxitjen e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në punën e bashkësive urbane dhe lokale
- Të formohet një grup (atje ku mund të zbatohet), apo të caktohet një referent për avancimin e bashkëpunimit me bashkësitë urbane dhe lokale
- Komunitat vazhdimisht t'i hulumtojnë dhe t'i ndjekin problemet dhe nevojat e bashkësisë lokale dhe të ndërmarrin masat e duhura për zgjidhjen e tyre.
- Në aspektin e punësimeve në komunë, komunitat duhet t'i publikojnë ato në faqen e internetit të komunës si shpalljet ashtu edhe vendimet për punësim.
- Komunitat ta vendosin praktikën e njoftimit të rregullt për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit, publikimit të rendit të ditës, si dhe dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara.

- Të përdoren mekanizma të ndryshme për ftesën e qytetarëve dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në krijimin e politikave lokale
- Komunitat të publikojnë programet vjetore të punës nëpër sektorët për 3do vit me një afat të përcaktuar qartë kohor për zbatimin dhe indikatorët e suksesit, si dhe buxhetin e paraparë për secilin aktivitet të programit vjetor dhe rregullisht të publikojnë raporte mbi përparimin e zbatimit të aktiviteteve.
- Rekomandohet të publikohen raportet e auditimeve dhe të konkluzioneve të inspektorëve të cilët kryejnë monitorin të shërbimeve komunale.

Rekomandimet për komunitat

Strumica

- Në faqen e internetit të publikohen të gjitha procedurat e publikuara, të lidhura dhe të anuluarat të prokurimit publik
- Në faqen e internetit të publikohen shpalljet për punësimet e reja, si dhe informacionet për personat e punësuar në komunë.
- Rekomandohet të publikohen raportet e auditimeve dhe të konkluzioneve të inspektorëve të cilët kryejnë monitorin të shërbimeve komunale.
- Lista e shërbimeve nëpër sektorët, si dhe lista e 3mimeve për të njëjtat, përveç në faqen e internetit të publikohet në një vend të dukshëm në ndërtesën e komunës.

Radovishi

- Në faqen e internetit të publikohen të gjitha procedurat e publikuara, të lidhura dhe të anuluarat të prokurimit publik
- Në faqen e internetit të publikohen shpalljet për punësimet e reja, si dhe informacionet për personat e punësuar në komunë.
- Të përgatitet dhe miratohet një procedurë për pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin dhe miratimin e buxhetit komunal
- Komunitat ta rregullojë mënyrën e marrjes së informacioneve kthyes nga ana e qytetarëve lidhur me atë se sa janë të kënaqur nga shërbimet e komunës dhe të kryejë vlerësimin e nevojave të bashkësisë lokale
- Të rregullohet e drejta për ankime, parashtrësia dhe ankesa me një procedurë të veçantë.

Bogdanci

- Të praktikohet mbajtja e kolegjiemeve të rregullta me kryetarin e komunës dhe

udhëheqësit e sektorëve

- Në faqen e internetit të publikohen të gjitha procedurat e publikuara, të lidhura dhe të anuluar të prokurimit publik
- Të publikohen ditët e mbajtjes së mbledhjeve të këshillit komunal dhe të gjendet një mënyrë për të informuar opinionin
- Të përgatitet dhe miratohet një procedurë për pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin dhe miratimin e buxhetit komunal
- Të përgatitet dhe miratohet një procedurë për konsultime me opinionin.
- Të rregullohet e drejta për ankime, parashtresa dhe ankesa me një procedurë të veçantë.

Novo Sella

- Faqja e internetit rregullisht të azhurnohet dhe plotësohet me: statutin e komunës, aktet komunale, ligjet, si dhe rregullisht të publikohen buletinet zyrtare të komunës.
- Në faqen e internetit të publikohet lista e informacioneve të karakterit publik dhe mënyra e kërimit të tyre.
- Të praktikohet mbajtja e kolegjiave të rregullta me kryetarin e komunës dhe udhëheqësit e sektorëve
- Të publikohen ditët e mbajtjes së mbledhjeve të këshillit komunal dhe të gjendet një mënyrë për të informuar opinionin
- Të publikohen në faqen e internetit buxheti komunal dhe raportet financiare
- Të përgatitet dhe miratohet një procedurë për pjesëmarrje të qytetarëve në krijimin dhe miratimin e buxhetit komunal
- Të miratohet një plan për bashkëpunim të komunës me sektorin civil
- Të përgatitet dhe miratohet një procedurë për konsultime me opinionin
- Komuna ta rregullojë mënyrën e marrjes së informacioneve kthyes nga ana e qytetarëve lidhur me atë se sa janë të kënaqur nga shërbimet e komunës dhe të kryejë vlerësimin e nevojave të bashkësisë lokale
- Të rregullohet e drejta për ankime, parashtresa dhe ankesa me një procedurë të veçantë.

Për të gjitha komunat për të cilat nuk është përmendur ndonjë rekomandim në mënyrë të veçantë vlen zbatimi i rekomandimeve të përgjithshme për komunat.

Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar të Pellagonisë

hulumtues: Diogen Haxhi Kosta Millevski

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave

Qendra për Zhvillim dhe Integrim Evropian (QZHIE) si një partner i Qendrës për Hulumtime dhe Krijim të Politikave (QHKP) në kuadër të projektit LOTOS ka zbatuar hulumtimin për transparencën dhe masat kundër korrupsionit të cilat i zbatojnë komunat në Rajonin e Pellagonisë. Në fokusin e ekipit hulumtues të QZHIE-së ishin katër komuna: **Manastiri, Demir Hisari, Krusheva dhe Dollneni.**


Mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet hulumtimeve në terren dhe analizës së dokumenteve dhe të dhënave që janë në dispozicion në formën elektronike.

Hulumtimet në terren janë realizuar në dy faza. Faza e parë është realizuar në gjysmën e dytë të muajit maj të vitit 2014, kështu që ekipi ka vizituar të gjitha katër komunat dhe ka bërë një analizë fillestare, e cila në hulumtimin e mëtejshëm është përdorur si një pikë referimi. Në kuadër të fazës së parë të hulumtimit, gjatë vizitës së komunave deri tek ato është dërguar pyetësori i standardizuar me një listë të pyetjeve dhe të dokumenteve të nevojshme, si një vërtetim për përgjigjet e pyetjeve. Kjo vizitë është përdorur për të skanuar një pjesë të indikatorëve që janë të lidhur me kushtet fizike dhe materiale për përmbushjen e normave të përcaktuara me ligj për funksionimin e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Faza e dytë përfundimtare e hulumtimit në terren është realizuar në gjysmën e dytë të muajit tetor të vitit 2014 kur është realizuar vizita e dytë në komunat, e cila është përdorur për të mbledhur të dhënat për indikatorët dhe për të kompletuar dhe për të saktësuar indikatorët për të cilët ka pasur një mungesë të të dhënave të verifikuara.

Përveç hulumtimit në terren, nga momenti i fillimit të fazës hulumtuese të projektit LOTOS 01.05.2014, ekipi i QZHIE-së ka filluar me procesin e mbledhjes, analizimit dhe ndjekjes së të gjitha informacioneve që ishin në dispozicion në formën elektronike. Në kuadër të këtij komponenti të hulumtimit është ndjekur mënyra në të cilën komunat i prezantojnë informacionet dhe dokumentet relevante për qytetarët. Gjithashtu është kontrolluar përgjegjshmëria e administratës komunale dhe e njëjta është testuar përmes dërgimit të letrave dhe vizitave të komunave nga ana e klientëve sekretë. Një pjesë e hulumtimit ishte drejtuar edhe drejt mënyrës së menaxhimit dhe plotësimit të faqeve të internetit të komunave dhe azhurnimit të tyre.

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e Rajonit të Pellagonisë




Ekipi i QZHIE-së në kuadër të këtij hulumtimi ka vendosur kontakte të drejtpërdrejta me kryetarët e komunave dhe administratën komunale në katër komunat që ishin pjesë e studimit dhe ka hasur në një qasje konstruktive dhe të hapur nga të gjitha subjektet që ishin përfshirë në hulumtim. Në kërkesën tonë, komunat na i kanë dhënë të gjitha dokumentet e nevojshme që ishin relevante për studimin dhe na kanë mundësuar një shqyrtim të buletineve zyrtare dhe mënyrës së punës së administratës komunale, që mund të shihet edhe nga grafiku më sipër.

2. Rezultatet e hulumtimit

2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Pellagonisë


Nga komunat e rajonit të Pellagonisë në të cilat është kryer hulumtimi, rezultatet më të mira të përgjithshme i ka arritur Komuna e Manastirit (7.22), e pastaj vijnë Komuna e Demir Hisarit dhe ajo e Krushevës me 3.53 pikë nga gjithsej 10 pikë. Komuna e Dollnenit mbetet prapa këtyre komunave me një rezultat të arritur prej 2.09, që kontribuon që mesatarja e përgjithshme e komunave të këtij rajoni të jetë 4.09. Krahasuar me mesataren e përgjithshme të rezultateve të këtij hulumtimi prej 3.53, mund të shihet se komunat e këtij rajoni janë pak më të mira në krahasim me rajonet e tjera. Është interesante që rezultatet e komunave të Demir Hisarit dhe të Krushevës janë identike me mesataren e përgjithshme të rezultateve të realizuara.

Grafiku 2. Rezultatet e komunave të Rajonit të Pellagonisë në krahasim me mesataren e përgjithshme dhe rajonale



Megjithatë, në lidhje me notën kaluese prej 5.00, vetëm Komuna e Manastirit kalon këtë kufi, ndërsa Demir Hisari dhe Krusheva ngecin pak, ndërsa Komuna e Dollnenit do të duhet të punojë më shumë në zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Grafiku 3: Rezultatet në krahasim me numrin e banorëve



Në tabelë janë treguar rezultatet e katër komunave të rajonit të Pellagonisë, të kombinuara me numrin e banorëve në komunë. Nga këtu mund të vërehet një trend të rezultateve më të mira të komunave urbane në krahasim me ato rurale. Falë infrastrukturës dhe disponueshmërisë më të mirë me resurset njerëzore, komunat urbane kanë kapacitet për të përmbushur një pjesë të indikatorëve që janë të lidhur me shërbimet që janë në dispozicion të qytetarëve dhe në këtë mënyrë kanë një përparësi në krahasim me komunat rurale. Kështu, mund të merret një konkluzion se numri i banorëve nuk ka një ndikim të madh ndaj rezultateve, por para të gjithash infrastruktura më e mirë e komunave urbane.

Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:


Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal

Komuna	Klasifikimi	Shkalla e qeverisjes së mirë
Manastir 7,22	Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
	Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
Krusevë 3,53 Demir Hisar 3,53	Qeveris mirë	5.51-7.50
	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
Dollneni 2,09	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
	Qeveris shumë keq	0.0-1.50

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Rezultatin më të mirë në dimensionin e parë - Hapja dhe transparencja gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, nga komunat e këtij rajoni ka arritur Komuna e Manastirit (1.02) nga 1.5 pikët e mundshme, kurse e dyta është Demir Hisari me 0.82. Rezultati mesatar i këtij dimensionin për Rajonin e Pellagonisë është 0.75, ndërsa nën këtë mesatare janë rezultatet e komunave të Krushevs (0.58) dhe Dollnenit (0.56). Në këtë dimension, komunat e Manastirit dhe të Demir Hisarit kanë arritur një rezultat mbi 50% të pikave të këtij dimensionin, ndërsa Krusheva dhe Dollneni janë nën këtë përqindje dhe nuk kanë arritur një notë kaluese. Në lidhje me mesataren e këtij dimensionin nga 43 komunat (0.54) për komunat e këtij rajoni mund të thuhet se janë transparente në lidhje me punën e organeve komunale.

Grafiku 4: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pellagonisë në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparencja gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale



Ajo që mund të vërehet me analizimin e indikatorëve të këtij dimensionin është se Komuna e Manastirit dhe Komuna e Demir Hisarit tregojnë rezultate më të mira edhe në krahasim me komunat e Krushevs dhe të Dollnenit falë gamës më të madhe të mundësive për informimin e qytetarëve për punën e pushtetit komunal përmes mediave elektronike.

Nga aspekti i formalizimit të procedurave për ndjekjen e mbledhjeve të këshillit të komunës, të gjitha komunat e Rajonit të Pellagonisë tregojnë rezultate të dobëta. Asnjë nga komunat nuk ka miratuar një **Rregullore** për transparencë në punën e komunës në të cilën janë definuar, rregulluar dhe sistematizuar procedurat për ngritjen e transparencës në punën e komunës.

Komunat e Manastirit dhe të Demir Hisarit kanë caktuar persona për marrëdhënie me opinion dhe në këto komuna ai është përshkrimi primar i vendit të punës të këtyre të punësuarve, ndërsa në rastin e komunave të Krushevs dhe të Dollnenit funksionin e personave për marrëdhënie me opinion e kryejnë persona të cilët sipas përshkrimit të vendit të punës kanë edhe detyra të tjera pune në strukturën e administratës komunale.


Përveç komunës së Manastirit, e cila për vitin 2013 ka publikuar raportet financiare në formë të kuptueshme për qytetarët, komunat e tjera për këtë indikator nuk kanë pikë.

Të gjitha komunat dështojnë në pjesën e publikimit të marrëveshjeve të nënshkruara të prokurimit publik dhe më shpesh arsyetohen me sistemin e centralizuar kombëtar për publikimin e procedurave të tenderimit dhe marrëveshjeve, por kjo mënyrë e publikimit nuk u mundëson qytetarëve një qasje të lehtë dhe të shpejtë deri te informacionet e kësaj kategorie dhe për ata me më pak njohuri të sistemit të funksionimit të këtij shërbimi në thelb të dhënat i bëjnë krejtësisht të paarritshme.

Në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e

vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve) rezultatet më të mira i ka arritur përsëri Komuna e Manastirit me 1.25 pikë, e pastaj vijnë komunat e Dollnenit me 0.45 dhe ato të Demir Hisarit dhe të Krusehaves me 0.23 pikë. Mesatarja në mes të komunave për këtë dimension është 0.54, që është pak nën mesataren në kuadër të hulumtimit, e cila është 0.57.

Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pellagonisë në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)



Ajo që mund të vërehet nga analiza e indikatorëve individualë në këtë dimension është se komunat nuk e kanë standardizuar mënyrën e pjesëmarrjes së organizatave të qytetarëve në punën e këshillit dhe pothuajse asnjë prej tyre nuk ka dokumente formale me të cilat mund të dëshmojë pjesëmarrjen e tillë të organizatave të qytetarëve në punën e këshillit ose në punën e komisioneve dhe të organeve të themeluara nga këshilli.


Gjithashtu në të gjitha komunat, me përjashtim të komunës së Manastirit, nuk është definuar qartë procedura dhe kriteret me të cilat organizatat mund të aplikojnë për mjete të buxhetit komunal.

Asnjë nga komunat nuk ka publikuar një listë për atë se cilat organizata të qytetarëve nuk kanë të drejtë të marrin mjete financiare për shkak të konfliktit të interesit.

Në mbrojtje të komunave mund të theksohet argumenti se duke pasur parasysh mjetet e kufizuara financiare të cilat i kanë në dispozicion komunat më të vogla, ato nuk janë në gjendje për të siguruar një fond të mjeteve për të cilin do të aplikonin organizatat e qytetarëve, siç është rasti me Komunën e Manastirit.

Rezultatet e komunave të Rajonit të Pellagonisë për dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënese komunale, janë këto: Komuna e Manastirit ka 2.32 pikë nga 2.5 pikët e mundshme, pastaj vijnë Demir Hisari me 1.61 dhe Dollneni me 1.07, ndërsa e fundit është Krusheva me 0.54. Kjo do të thotë se Manasriti dhe Demir Hisari kalojnë pragun e 50% për këtë dimension, dhe kanë arritur rezultate mbi mesataren e 43 komunave, e cila është 1.22 për këtë dimension.

Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pellagonisë në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënese komunale



Të dhënat për indikatorët e këtij dimensionit janë fituar me kombinimin e disa metodave hulumtuese: analiza e dokumenteve, kontrolli në terren me klientë sekretë dhe me dërgimin e letrave deri te organet administrative në nivel lokal.

Falë resurseve njerëzore, praktikës së zhvilluar dhe infrastrukturës, Manastiri si një komunë e madhe është e para sipas pikëve edhe në këtë dimension. Ajo që i mungon Komunës së Manastirit është realizimi i së drejtës për qasje të lirë deri te informacionet e karakterit publik që nuk është e shënuar në mënyrë të qartë as në objektin e komunës e as në faqen e internetit të komunës. Në lidhje me këtë indikator, e vetmja komunë e Rajonit të Pellagonisë e cila i plotëson të gjitha kriteret është ajo e Demir Hisarit.


Krusheva ka rezultatet më të dobëta në këtë dimension dhe kjo është për shkak të mos-themelimit të bashkësive lokale, një gjë e cila pastaj sjell pikë negative në disa indikatorë.

Komunat Dollneni, Krusheva dhe Demir Hisari nuk kanë definuar procedurat dhe nuk ka zbatuar konsultim me opinionin që në fund të fundit sjell pikë negative në pjesën e miratimit të Planit të Detajuar Urbanistik (PDU) dhe të Planit të Përgjithshëm Urbanistik (PGJU), buxhetit të

komunës dhe kontrollimit të nevojave të qytetarëve në komunë. Edhe pse ekzistojnë instrumente joformale për kontrollimin e prioriteteve të qytetarëve dhe realizohen në një nivel personal, megjithatë nuk ka një praktikë të sistematizuar qartë, e cila do të mund të ishte subjekt i hulumtimeve dhe analizave.

Sipas rezultateve të dimensionit të katërt, i cili mat Efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, më shumë pikë ka Komuna e Manastirit - 2.63. Mesatarja e këtij dimensionit është 1.38 për Rajonin e Pellagonisë, ndërsa rezultatin më të dobët e ka Komuna e Dollnenit me 0 pikë. Demir Hisari ka fituar 0.88 pikë, që është përsëri nën notën kaluese prej 50% të përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionit.

Grafiku 7: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pellagonisë në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e qeverisjes lokale



Ajo që mund të vërehet te një pjesë e komunave të këtij dimensionit është jo-publikimi i llogarisë përfundimtare të shpenzimeve të buxhetit (Krusheva dhe Dollneni). Këto llogari përfundimtare mund të gjenden në buletin zyrtar të komunave, por ato si dokumente të vezanta elektronike që janë lehtësisht të arritshme nëpërmjet internetit, nuk janë në dispozicion. E njëjta gjë vlen edhe për rebalancin e buxhetit (Demir Hisari, Krusheva dhe Dollneni). Të gjitha komunat me përjashtim të komunës së Manastirit nuk publikojnë programin vjetor të punës nëpër sektorët.

Konkluzionin të cilin mund ta nxjerrim nga analiza e rezultateve të arritura të komunave në Rajonin e Pellagonisë është se ka një nevojë dhe hapësirë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në punën e komunave, por edhe për përforsimin e instrumenteve dhe praktikave të cilat do të 3ojnë deri te një zvogëlim të hapësirës së korrupsionit. Edhe pse përvoja jonë nga terreni tregon se shumica e komunave ballafaqohen me mungesë të resurseve njerëzore dhe financiare, madje edhe të kushteve fizike për përmbushjen e disa indikatorëve, kjo nuk do të thotë

se situata nuk mund të përmirësohet.

Komunat nuk bëjnë sa duhet në sferën e përfshirjes së organizatave të qytetarëve dhe të qytetarëve në aktivitetet dhe projektet që i ndërmarrin, që në fund të fundit reflektohet mbi performancën e dobët në transparencën e punës së tyre. Si dëshmi e kësaj mund të përmendim faktin se asnjë nga komunat nuk ishte në gjendje të na tregojë një dëshmi se ka ftuar në mënyrë të rregullt organizatat e qytetarëve për të marrë pjesë në diskutimet publike ose në punën e këshillit të komunës gjatë zgjidhjes së çështjeve të lidhura me interesat e qytetarëve dhe me fushëveprimin e organizatave të regjistruara të qytetarëve, që në vetvete nuk do të thotë se nuk ka pjesëmarrje të opinionit në punën e organeve komunale, por tregon se ekziston një zone gri dhe nuk ka një praktikë të definuar qartë, që rrit hapësirën për një trajtim preferencial dhe korrupsion.

Më shumë se një e treta e të dhënave, të cilat ishin subjekt i analizës së ekipit hulumtues të QZHIE-së nuk janë mbledhur nëpërmjet ndjekjes së faqeve të internetit të komunave dhe në shumë raste ato paraqesin një lloj mediumi promovues për komunën, ndërsa në thelb informacionet e rëndësishme të karakterit publik shpeshherë gjenden në vende që nuk janë lehtë në dispozicion (të dukshme). Në këtë mënyrë faqet janë një lloj informatori për atë që e bën komuna e jo një shërbim elektronik publik nëpërmjet të cilit qytetarët do të mund të merrnin të dhënat dhe shërbimet relevante.

Komunat nuk përdorin pyetësorët me të cilët do të kontrollonin mendimin, nevojat dhe qëndrimet e qytetarëve për aktivitetet të cilat i ndërmarrin dhe në shumicën e rasteve kjo arsyetohet me komunikimin me përfaqësuesit e bashkësive lokale dhe rurale, që në fund të fundit nuk jep një imazh konkret për pyetje të caktuara që janë të rëndësishme në nivel lokal dhe i përfshin vetëm qytetarët që marrin pjesë në punën e bashkësive lokale dhe rurale.

Përfaqësuesit e komunave me të cilët ka bashkëpunuar ekipi i QZHIE-së në shumë situata na kanë njohur me realitetin e funksionimit të vetëqeverisjes lokale, kurse në anën tjetër edhe në këto biseda me ta ne ishim në mundësi t'i shohim në mënyrë të vërtetë ato vende ku është i mundur progresi dhe përmirësimi i transparencës dhe i praktikave kundër korrupsionit në punën e komunave, që në fund të fundit do t'u mundësojë qytetarëve një shërbim dhe një mënyrë më të mirë të informimit dhe një ndjekje të punës së vetëqeverisjes lokale.

REKOMANDIMET

Rekomandimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me katër komunat e Rajonit të Pellagonisë janë:

- 1- Komunat duhet të miratojnë rregulloret dhe planet për transparencë në punën me të cilat do të rregullojnë formalisht mënyrën e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të organizatave të qytetarëve në punën e këshillit të komunës dhe në organet e krijuara nga këshilli.
- 2- Definimi i pyetjeve të këshilltarëve në kuadër të statutit dhe rregulloreve për punën e këshillit në fillim të mbledhjeve
- 3- Informimi i qytetarëve për punën e Komisioneve të themeluara nga ana e komunës
- 4- Komunat domosdoshmërisht të fillojnë me publikimin e marrëveshjeve të prokurimit publik në faqet e internetit të komunave.
- 5- Komuna të publikojnë informacione për punësimet e realizuara në kuadër të komunës.
- 6- Komunat të zhvillojnë sisteme të kontrollimit të interesave dhe nevojave të qytetarëve që

në fund të fundit do të çojë deri në një përdorim më efikas të resurseve të cilat i kanë në dispozicion.

Për secilën komunë, përveç rekomandimeve të përgjithshme, theksojmë edhe rekomandimet individuale:

Komuna e Manastirit

1 – Përpunimi i faqes së internetit e cila në një mënyrë të dukshme dhe intuitive do ta strukturojë sasinë e madhe të informacioneve, të cilat në momentin janë të vendosura, por nuk janë të dukshme.

2 – Publikimi i informacioneve të karakterit publik në kuadër të komunës dhe publikimi i procedurës se si qytetarët mund të vijnë deri te këto informacione

3 – Azhurnimi i dërrasës së shpalljeve në komunë me informacione dhe thirrje relevante dhe aktuale.

Komuna e Demir Hisarit

- 1- Publikimi i përmbajtjes së rendit të ditës së mbledhjeve të këshillit para mbajtjes së këshillit
- 2- Publikimi i raporteve financiare në një formë të kuptueshme për qytetarët
- 3- Publikimi i llogarisë përfundimtare përveç publikimit të saj në buletin zyrtar të komunës
- 4- Përgatitja e rregullores dhe kriterëve të cilat do të sigurojnë transparencë gjatë ndarjes së mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve nga ana e komunës
- 5- Pjesëmarrja e organeve këshillëdhënëse në punën e Këshillin të komunës (plotësisht), të përbëra nga përfaqësuesit e sektorit civil apo përfaqësuesit e sektorit të biznesit
- 6- Publikimi i programit vjetor të punës nëpër sektorët

Komuna e Krushevs

- 1- Caktimi - angazhimi i një personi të detyruar për marrëdhënie me opinion
- 2- Themelimi i bashkësive urbane dhe rurale si një sistem të komunikimit me qytetarët
- 3- Publikimi i përmbajtjes së rendit të ditës së mbledhjeve të këshillit para mbajtjes së këshillit
- 4- Publikimi i raporteve financiare në një formë të kuptueshme për qytetarët
- 5- Përgatitja e rregullores dhe kriterëve të cilat do të sigurojnë transparencë gjatë ndarjes së mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve nga ana e komunës
- 6- Pjesëmarrja e organeve këshillëdhënëse në punën e Këshillin të komunës (plotësisht), të përbëra nga përfaqësuesit e sektorit civil apo përfaqësuesit e sektorit të biznesit
- 7- Publikimi i programit vjetor të punës nëpër sektorët

Komuna e Dollnenit

- 1- Caktimi - angazhimi i një personi të detyruar për marrëdhënie me opinionin
- 2- Publikimi i përmbajtjes së rendit të ditës së mbledhjeve të këshillit para mbajtjes së këshillit
- 3- Publikimi i raporteve financiare në një formë të kuptueshme për qytetarët

- 4- Përgatitja e rregullores dhe kriterëve të cilat do të sigurojnë transparencë gjatë ndarjes së mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve nga ana e komunës
 - 5- Pjesëmarrja e organeve këshillëdhënëse në punën e Këshillin të komunës (plotësisht), të përbëra nga përfaqësuesit e sektorit civil apo përfaqësuesit e sektorit të biznesit
 - 6- Publikimi i programit vjetor të punës nëpër sektorët
- Publikimi i llogarisë përfundimtare përveç publikimit të saj në gazetën zyrtare të komunës.

Analiza e të dhënave për komunitet e Rajonit të planifikuar të Pollogut

hulumtues: Rudina Pasholli

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave


Në Rajonin verilindor me hulumtimin janë përfshirë komunitet Tetovë, Gostivar, Bërvenicë, Vrapçisht dhe Bogovinë. Nga këto pesë komunitet, dy e kanë selinë në një vendbanim urban, ndërsa tri nga komunitet selinë e kanë në një vendbanim rural.

Hulumtimi është zbatuar në periudhën maj - tetor të vitit 2014. Më 09.06.2014 deri te komunitet është dërguar një shkresë në të cilën ishin shpjeguar qëllimet e hulumtimit, ndërsa në shkresë kishte edhe informacione bazike për projektin. Së bashku me shkresën, nëpërmjet postës elektronike deri te komunitet është dërguar edhe një pyetësor me 26 pyetje të shkurtra, të cilave komunitet duhej t'u përgjigjeshin për të mbledhur të dhëna në lidhje me qëllimet e hulumtimit. Komunitet kishin një afat prej 15 ditësh për ta kthyer pyetësorin e plotësuar.

Në afatin e dhënë deri më 24.05.2014, komunitet e Bërvenicës, Vrapçishtit dhe Bogovinës e kanë kthyer pyetësorin, ndërsa Komunitet e Gostivarit e ka dorëzuar pyetësorin të plotësuar me vonesë – më 03.06.2014. Komunitet e Tetovës e ka dërguar pyetësorin në muajin e ardhshëm. Kjo do të thotë se përgjegjshmëria e komunave të rajonit është solid, duke pasur parasysh se edhe në afatin e parë, edhe pse Komunitet e Gostivarit me vonesë, 4 nga 5 komunitet kanë kthyer pyetësorin të plotësuar nëpërmjet postës elektronike.

Megjithatë, një nga sfidat me të cilat jemi ballafaquar në hulumtim ishte padisponueshmëria e disa informacioneve në faqet e internetit të komunave. Materialet e nevojshme janë dorëzuar në kërkesën e hulumtuesit gjatë periudhës hulumtuese.

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e Rajonit të Pollogut




Në Rajonin e Pollogut janë realizuar hulumtime në terren në të gjitha pesë komunat e përfshira me hulumtim; pyetësi është marrë nga të gjitha komunat; statuti dhe buletini zyrtar, si dhe faja funksionale e internetit ishin në dispozicion të të gjitha komunat. Rregullorja mungonte në një komunë - Gostivar, kurse buxheti nuk ishte në dispozicion të hulumtuesit në dy prej komunave - Vrapçishtin dhe Gostivarin.

2. Rezultatet e hulumtimit


2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Pollogut

Në Rajonin verilindor, rezultatet më të mira të përgjithshme i ka arritur Komuna e Tetovës e cila ka fituar 4.89 pikë, kurse pastaj vijojnë Bogovina me 2.91, Vrapçishti me 2.17, Gostivari me 1.57 dhe Bërvenica me 1.12. Mesatarja e këtij rajoni është shumë e ulët dhe është 2.53, që është për 1 pikë nën mesataren e të gjitha 43 komunave gjithsej, e cila është 3.53. Shqetësuese është gjithashtu se asnjë nga këto komuna nuk ka përmbushur 50% të indikatorëve, që tregon nevojën për përmirësime në të gjitha dimensionet e indikatorëve për qeverisje të mirë në nivel lokal.

Grafiku 2. Rezultatet e komunave të Rajonit të Pollogut në krahasim me mesataren e përgjithshme dhe rajonale



Grafiku 3: Rezultatet në krahasim me numrin e banorëve



Në aspektin e korrelacionit midis numrit të banorëve dhe zbatimit të praktikave të qeverisjes së mirë, nga grafiku më lart mund të shihet se në përgjithësi vija e numrit të banorëve ndjek vijën e rezultateve të arritura në studimin LOTOS 2014 deri në Komunën e Gostivarit, ku kemi devijime të këtij trendi. Te Komuna e Gostivarit, rezultati i arritur është dukshëm më i vogël në krahasim me numrin e banorëve, që do të thotë se pavarësisht se ka një qasje më të mirë deri te resurset njerëzore, dhe nëse kësaj ia shtojmë faktin se selinë e ka në një mjedis urban dhe ka një zhvillim më të mirë të infrastrukturës, rezultatet në këtë hulumtim janë të pakënaqshme. Për krahasim,

Komuna e Tetovës që ka numrin e përafërt të banorëve, ka rezultate dukshëm më të mira dhe gjendet në anën tjetër të vijës, e cila paraqet rezultatin e përgjithshëm të arritur të komunave. Në këtë rast, përveç devijimit të Gostivari, konfirmohet teza se rezultatet e hulumtimit në përgjithësi ndjekin vijën e numrit të banorëve në komunë.

Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:

Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal


Komuna		Klasifikimi	Shkalla e qeverisjes së mirë
		Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
		Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
		Qeveris mirë	5.51-7.50
Tetovë	4,89	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
Bogovinë	2,91	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
Vrapçisht	2,18		
Gostivar	1,57		
Bërvenicë	1,12	Qeveris shumë keq	0.0-1.50

Sipas klasifikimit të qeverisjes së mirë në nivel lokal, asnjë nga komunat në Rajonin e Pollogut nuk gjendet në grupin e komunave që qeverisin në mënyrë të shkëlqyeshme, shumë të mirë apo të mirë. Tetova është në grupin e komunave që qeverisin mjaft mirë, Bogovina, Vrapçishti dhe Gostivari janë në grupin e komunave që nuk qeverisin mjaft mirë, ndërsa Bërvenica është në grupin e komunave që qeverisin shumë keq.

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Rezultatin më të mirë në dimensionin e parë - Hapja dhe transparencë gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, nga komunat e këtij rajoni ka arritur Komuna e Bogovinës me 0.75, e pastaj vijojnë Tetova me 0.55, Gostivari me 0.51 dhe Bërvenica me 0.41. Rezultati mesatar i këtij dimensionin për komunat e Rajonit të Pollogut është 0.48, që është relativisht e ulët duke marrë parasysh se mesatarja e këtij dimensionin në mesin e 43 komunave është 0.54. Pastaj, kjo do të thotë se asnjë nga komunat nuk ka tejkaluar pragun e notës kaluese prej 50% të përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionin ose 0.75.


Grafiku 4: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pollogut në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparencë gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale



Analiza e përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionin tregon disa mangësi në zbatimin e praktikave të qeverisjes së mirë. Asnjë nga komunat nuk ka miratuar një Rregullore dhe një Plan për transparencë në punë. Pyetjet e këshilltarëve janë rregulluar vetëm në aktet e Komunës së Bogovinës dhe vetëm kjo komunë ka publikuar dokumentet financiare të komunës në një gjuhë të kuptueshme nga qytetarët e komunës. Rendi i ditës dhe materialet e punës janë në dispozicion vetëm të qytetarëve të Komunës së Bërvenicës, kurse për anëtarët e këshillit dërgohen me kohë vetëm në Komunën e Tetovës.

Në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve) rezultatet më të mira i ka arritur Komuna e Bogovinës me 0.91 pikë, e pastaj vijon Komuna e Tetovës me 0.45 pikë. Mesatarja e këtij dimensionin në mes të komunave është 0.41, që është nën mesataren në kuadër të hulumtimit, e cila është 0.57.

Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pellagonisë në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)




Sipas analizës së përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionit, pika më e dobët e komunave të këtij rajoni është publikimi i kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve. Këtu para të gjithash mendohet për një dokument të shkruar që është në dispozicion të qytetarëve, sipas të cilit organizatat e qytetarëve paraprakisht do të mund të bëjnë një vetë-vlerësim për atë se nëse i përmbushin kriteret apo jo. Pastaj, asnjë nga komunat nuk publikon një listë të organizatave të qytetarëve që kanë marrë mbështetje financiare nga komuna për vitin e kaluar.

Ftesa deri te organizatat e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje, sipas informacioneve tona të hulumtimit, kanë dërguar vetëm komuna e Tetovës dhe ajo e Bogovinës.

Rezultatet e komunave të Rajonit të Pollogut për dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale, janë këto: Komuna e Tetovës ka 2.14 pikë nga 2.5 pikët e mundshme, pastaj vijon Bogovina me 1.25. Mesatarja e këtij dimensionit është 1.04, ndërsa komuna e fundit sipas renditjes ka arritur një rezultat prej 0.36.


Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pollogut në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale



Sipas analizës, komunat e këtij rajoni shumë pak përdorin pyetësorë për kënaqësi nga shërbimet e komunave. E vetmja komunë që e bën këtë është Komuna e Tetovës dhe e njëjta komunë ua mundëson qytetarëve të saj të drejtën e qasjes së lirë deri te informacionet e karakterit publik. Nga analiza mund të fitohet konkluzioni se komunat e këtij rajoni nuk i informojnë mjaft qytetarët për përparimin e politikave që është rezultat i iniciativave të tyre, që është një tregues për atë se sa komunat janë llogaridhënëse dhe të përgjegjshme para qytetarëve të tyre kur bëhet fjalë për përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel lokal. Me fjalë të tjera, sa në thelb merren në parasysh iniciativat nga ana e qytetarëve.

Sipas rezultateve të dimensionit të katërt, i cili mat Efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, më shumë pikë ka Komuna e Tetovës – 1.75. Mesatarja e këtij dimensionit është 0.61, ndërsa madje tri komuna nuk kanë përmbushur asnjë indikator të këtij dimensionit. Komuna e Gostivarit ka rezultatin prej 1.31 që është më pak se gjysma e indikatorëve të këtij dimensionit.

Grafiku 7: Rezultatet e komunave të Rajonit të Pollogut në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e qeverisjes lokale



Të dhënat nga pikët e dimensionit të katërt në të gjitha komunat tregojnë domosdoshmërinë e përmirësimit. Vetëm dy komuna publikojnë rebalancin e buxheteve të komunave, kurse vetëm një komunë ka publikuar llogarinë përfundimtare për vitin paraprak. Një pjesë e madhe e të dhënave për punën financiare të komunave nuk janë publikuar ose nuk janë mjaft të kontrolluara dhe po ashtu nuk kemi informacione për shpërndarjen e këtyre mjeteve nëpër sektorët dhe se si shpenzohen të njëjtat në kuadër të programeve vjetore të punës.

REKOMANDIMET

Rekomandimet e përgjithshme për të gjitha komunat e këtij rajoni janë këto:

- Aktet themeluese të komunës të jenë në dispozicion të qytetarëve
 - o me kërkesën e tyre
 - o në faqen e internetit të komunës
- Komunat ta informojnë me kohë opinionin për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit dhe të respektojnë afatin e përcaktuar me ligj prej minimum 7 ditë para mbajtjes së mbledhjeve të këshillit
- Komunat të miratojnë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të publikohen publikisht
- Të ndërmerren masa për përfshirjen e opinionit në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal
- Kriteret për ndarjen e mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve të publikohen publikisht
- Faqet e internetit të komunave të azhurnohen rregullisht edhe me informacione të

dobishme për qytetarët

- Të përdoren pyetësorë për kënaqësi nga shërbimet që i ofrojnë
- Formularët për kërkesat e qytetarëve, me hapa të qartë për dorëzimin të jenë në dispozicion të qytetarëve
- Rregullisht të publikohen llogaritë përfundimtare për vitin paraprak

Komuna e Tetovës

- Të rregullohen pyetjet e këshilltarëve dhe të mbahen në fillim të çdo mbledhjeje të këshillit
- Marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik të publikohen rregullisht
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e prokurimit publik për shkak të konfliktit të interesit
- Të përforcohet bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara nëpërmjet dërgimit të ftesave për të ndjekur mbledhjet në sferën e interesit të tyre
- Komuna të miratojë dhe ta publikojë kodin etik të sjelljes së zyrtarëve komunalë në një vend të dukshëm
- Të informojë rregullisht për përparimin e politikave, veçanërisht ato që janë parashtruar nga ana e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve

Komuna e Bogovinës

- Të përgatitet një procedurë për ndjekjen e mbledhjeve të këshillit, e cila do të jetë në dispozicion të qytetarëve
- Marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik të publikohen rregullisht
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e prokurimit publik për shkak të konfliktit të interesit
- Të përforcohet bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara nëpërmjet dërgimit të ftesave për të ndjekur mbledhjet në sferën e interesit të tyre
- Të përforcohet llogaridhënia dhe përgjegjshmëria e komunës
 - o nëpërmjet përdorimit të pyetësorëve për shërbimet
 - o nëpërmjet publikimit të llogarisë përfundimtare
 - o nëpërmjet njoftimit për përparimin e politikave të caktuara

Komuna e Bërvenicës

- Të vendoset një praktikë për mbajtjen e kolegjiemeve të kryetari i komunës në bazë të një agjende të definuar paraprakisht
- Marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik të publikohen rregullisht
- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e prokurimit publik për shkak të konfliktit të interesit
- Të përforcohet bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara nëpërmjet dërgimit të ftesave për të ndjekur mbledhjet në sferën e interesit të tyre
- Të mbahen rregullisht konsultime me opinionin për zbatimin e politikave në nivel lokal
- Të publikohet një listë të informacioneve të karakterit publik
- Të mundësohet një qasje deri te informacionet e karakterit publik nëpërmjet përgatitjes së formularëve dhe të respektohet afati i paraparë ligjor për t'u përgjigjur kërkesave
- Komuna ta publikojë llogarinë përfundimtare

Komuna e Vrapcistit

- Të vendoset një praktikë për mbajtjen e kolegjiemeve të kryetari i komunës në bazë të një agjende të definuar paraprakisht
- Marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik të publikohen rregullisht

- Të publikohet një listë të operatorëve ekonomikë të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e prokurimit publik për shkak të konfliktit të interesit
- Të përforcohet bashkëpunimi me të gjitha palët e interesuara nëpërmjet dërgimit të ftesave për të ndjekur mbledhjet në sferën e interesit të tyre
- Të respektohet e drejta e qytetarëve për parashtresë dhe ankesë para komunës dhe të mundësohet zbatimi i tyre i pandërprerë
- Të mbahen rregullisht konsultime me opinionin për zbatimin e politikave në nivel lokal
- Të publikohet një listë të informacioneve të karakterit publik
- Të përgatiten dhe të publikohen raporte për përparimin e zbatimit të politikave në nivel lokal

Komuna e Gostivarit

- Komunat ta informojnë me kohë opinionin për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit dhe të respektojnë afatin e përcaktuar me ligj prej minimum 7 ditë para mbajtjes së mbledhjeve të këshillit
- Komunat të miratojnë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të publikohen publikisht
- Të ndërmerren hapa masa për përfshirjen e opinionit në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal
- Të publikohen raportet financiare në një formë të kuptueshme për qytetarët e rëndomtë
- Kriteret për ndarjen e mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve të publikohen publikisht
- Faqet e internetit të komunave të azhurnohen rregullisht edhe me informacione të dobishme për qytetarët

Të përdoren pyetësorë për kënaqësi nga shërbimet që i ofrojnë

Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar verilindor


hulumtues: Gabrijella Boshkov

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave

Me hulumtimin në kuadër të studimit LOTOS në Rajonin të planifikuar verilindor janë përfshirë komunat Kumanovë, Nagoriçan i Vjetër, Likovë dhe Kriva Pallankë. Hulumtimi është realizuar në periudhën maj-tetor të vitit 2014, pas çka vijonte një periudhë e përpunimit të të dhënave dhe analizimit të tyre sipas metodave dhe dinamikës së përcaktuara paraprakisht. Rezultatet e para pastaj janë kontrolluar nga një kontrollues i cili kishte për detyrë për të vlerësuar procesin e vlerësimit dhe të dhënies së pikëve për përmbushjen e indikatorëve. Rezultatet janë dërguar pastaj në komunat, dhe është dhënë një afat për të dërguar dëshmi për përmbushjen e indikatorëve nëse konsiderojnë se kanë përmbushur disa indikatorë, ndërsa hulumtuesi nuk i ka marrë parasysh.

Përdorimi i mjeteve të ndryshme për mbledhjen e të dhënave në këtë hulumtim, ka kontribuar për një besueshmëri më të madhe të të dhënave që rrit besueshmërinë e tyre dhe për këtë qëllim janë përdorur disa metoda të ndryshme për mbledhjen e informacioneve: pyetësorë, hulumtime në terren, informacione nga ndjekja e faqeve të internetit si dhe përdorimi i mjetit "blerësit sekretë".

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e Rajonit verilindor




Siç mund të shihet nga grafiku më lart, gjatë hulumtimit kemi arritur t'i sigurojmë pjesën më të madhe të burimeve të të dhënave të komunave, përveç rregullores së komunave të Kriva Pallankës dhe të Nagoriçanit të Vjetër. Pastaj, nga Komuna e Likovës nuk kemi arritur të sigurojmë buletin zyrtar, ndërsa kjo komunë nuk ka faqen funksionale të internetit. Duhet të theksohet se në Komunën e Likovës, ku gjuha zyrtare është gjuha shqipe, shumicat e informacioneve janë në gjuhën shqipe që ishte një vështirësi shtesë gjatë mbledhjes së të dhënave për këtë komunë.

2. Rezultatet e hulumtimit


2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin verilindor

Në Rajonin verilindor, rezultatet e përgjithshme më të mira i ka arritur Komuna e Kriva Pallankës me 4.60 pikë të arritura, kurse pastaj vijojnë Komuna e Kumanovës me 3.48, Komuna e Likovës me 1.73 dhe Komuna e Nagoriçanit të Vjetër me 0.69. Mesatarja e këtij rajoni është mjaft e ulët dhe është 2.63, që është për 0.93 nën mesataren e të gjitha 43 komunave gjithsej, e cila është 3.53. Shqetëson po ashtu se asnjë prej këtyre komunave nuk e kalon pragun e 50% të përmbushjes së indikatorëve.

Grafiku 2. Rezultatet e komunave të Rajonit verilindor në krahasim me mesataren e përgjithshme dhe rajonale



Grafiku 3: Rezultatet në krahasim me numrin e banorëve



Në aspektin e korrelacionit midis numrit të banorëve dhe zbatimit të praktikave të qeverisjes së mirë, nga grafiku më lart mund të shihet se në përgjithësi vija e numrit të banorëve ndjek vijën e rezultateve të arritura në studimin LOTOS 2014. Megjithatë, gjithashtu vërehet se te Komuna e Kriva Pallankës ekziston një hendek të madh midis këtyre dy parametrave, që çon në konkluzion se pavarësisht numrit relativisht më të vogël të banorëve dhe numrit të të punësuarve në administratën komunale, kjo komunë ka arritur rezultate mjaft të larta. Ky nuk vlen për rastin e Komunës së Likovës, e cila ka rezultate shumë të ulëta edhe në rajon edhe në kuadër të hulumtimit. Megjithatë, duhet të theksohet se Komuna e Kriva Pallankës e ka selinë në një vendbanim urban, ndërsa selia e Komunës së Likovës është në një vendbanim rural, një gjë e cila ka treguar në hulumtim se ndikon mbi rezultatet gjatë përmbytjes së indikatorëve të qeverisjes së mirë.

Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:

Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal


Municipality		Classification	Scale of good governance
		Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
		Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
		Qeveris mirë	5.51-7.50
Kriva Palankë	4.60	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
Kumanovë	3.48		
Lipkovë	1.74	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
Nagoriçan i Vjetër	0.69	Qeveris shumë keq	0.0-1.50

Sipas klasifikimit të qeverisjes së mirë në nivel lokal, asnjë nga komunat në Rajonin verilindor nuk gjendet në grupin e komunave që qeverisin në mënyrë të shkëlqyeshme, shumë të mirë apo të mirë. Kumanova dhe Kriva Pallanka janë në grupin e komunave që qeverisin mjaft mirë, Likova është në grupin e komunave që nuk qeverisin mjaft mirë, ndërsa Nagoriçani i Vjetër është në grupin e komunave që qeverisin shumë keq.

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Rezultatin më të mirë në dimensionin e parë - Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, nga komunat e këtij rajoni ka arritur Komuna e Kriva Pallankës me 0.55 pikë, kurse menjëherë pas saj është Komuna e Kumanovës me 0.53 pikë. Rezultati mesatar i këtij dimensionin për komunat e Rajonit verilindor është 0.33 që është një mesatare mjaft e ulët nëse merret në konsideratë se mesatarja e këtij dimensionin në mes të 43 komunave është 0.54. Pastaj, kjo do të thotë se asnjëra prej komunave nuk e na kaluar prapen e notës kaluese prej 50% të përmbytjes së indikatorëve të këtij dimensionin ose 0.75.

Grafiku 4: Rezultatet e komunave të Rajonit verilindor në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparencia gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale



Nga tabela e dhënë mund të vërehet lehtë se ana më e fortë e Komunës së Kumanovës është qeverisja transparente dhe puna e Këshillit dhe e Kryetarit të Komunës. Në fakt, Këshilli mban takime të rregullta dhe rregullisht publikohen buletinet zyrtare, edhe pse ato nuk azhurnohen rregullisht. Mbahen takime të kolegjiemeve te kryetari i komunës nga të cilat ka dokumente të shkruara. Personi për marrëdhënie me opinion në komunë është në dispozicion dhe rregullorja e punës së komunës është në dispozicion të opinionit. Ka një publikim të raporteve financiare dhe e ngjashme.

Megjithatë në bazë të numrit të përgjithshëm të pikëve, mund të thuhet se është ka një hapësirë të madhe për përmirësimin dhe rritjen e transparencës në Komunën e Kumanovës.

Para së gjithash, komuna nuk ka miratuar një Plan për transparencën në punë në të cilin janë operacionalizuar procedurat për transparencë në qeverisje. Një mungesë e madhe është edhe puna e Këshillit të komunës. Nuk është siguruar një transparencë në punën e këshillit sepse nuk ka incizime publike nga mbledhjet, e as nuk ka transmetime të drejtpërdrejta të mbledhjeve. Nuk është siguruar një paralajmërim me kohë për mbledhjet dhe rendin e ditës dhe nuk ka një trend të dhënies së rregullt të njoftimeve dhe të raporteve për opinion nga mbledhjet e mbajtura.

Komuna ka miratuar Rregulloren për transparencën e punës së Këshillit në të cilën janë definuar, rregulluar dhe sistematizuar procedurat për ngritjen e transparencës së komunës, por e njëjta nuk ishte në dispozicion me kërkesën tonë. Ka procesverbale nga të gjitha kolegjiemet e mbajtura te kryetari i komunës me udhëheqësit e sektorëve, ndërmarrjet publike dhe shërbimet publike për shkak të rrjedhjes më të mirë të informacioneve midis administratës dhe për rritjen e transparencës së komunës. Ana e fortë e komunës është e informimi i qytetarëve për shërbimet që i ofron komuna me të gjitha dokumentet dhe informacionet përcjellëse. Gjithashtu buxhetet


komunale janë në dispozicion të opinionit, edhe pse jo në një formë të kuptueshme për qytetarët. Komuna e Kriva Pallankës edhe pse është shumë transparente në funksionimin e saj, nuk ka caktuar një person për marrëdhënie me opinionin, detyrë e të cilit është ta informojë opinionin për punën e komunës.

Ndjekja e mbledhjeve të këshillit nuk janë të rregulluara me një procedurë si një dokument i shkruar, megjithatë deri te kryetari i këshillit të komunës është dërguar një kërkesë elektronike për shpjegimin e mënyrës së paraqitjes së prezencës në mbledhjen e komunës nga ana e personit civil sepse me hulumtimin desk-top të faqes së internetit të komunës nuk është gjetur ky lloj informacioni.

Lidhur me punën e Këshillit, nuk ka incizime nga puna e këshillit me qëllim që opinionit të ketë evidencë për punën e këshillit dhe opinionit po ashtu nuk ka qasje në materialet e punës për mbledhjet e këshillit. Dhe nuk ka një praktikë të informimit të opinionit për mbledhjet e mbajtura. Komuna e Nagoriçanit të Vjetër ka kaq pak pikë saqë duket që pothuajse nuk ka fare transparencë, gjegjësisht nevojitet të punohet në të gjitha aspektet e dimensionit 1.

Në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve) rezultatet më të mira i ka arritur përsëri Komuna e Kumanovës me 0.57 pikë, e pas saj vijon Komuna e Kriva Pallankës me 0.34 pikë. Mesatarja e këtij dimensionit në mes të komunave është 0.31, që është shumë larg nën mesataren në kuadër të hulumtimit, e cila është 0.57.

Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit verilindor në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)




Pasqyra e pikëve të këtij dimensionit tregon rezultate të dobëta në të gjitha komunat. Dallimi në mes të komunave të zonave rurale dhe atyre urbane është në aspektin e bashkëpunimit me organizatat e qytetarëve si dhe të konsultimit me qytetarët lidhur me Planet e Përgjithshme Urbanistike (PPU) dhe Planet e Detajuara Urbanistike (PDU), që në të njëjtën kohë është edhe obligimi ligjor i komunës për të konsultuar qytetarët lidhur me ndryshimet.

Aspekti negativ i të gjitha komunave është jo-transparenca lidhur me themelimin e bashkësive lokale dhe funksionimin e tyre.

Rezultatet e komunave të Rajonit verilindor për dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënese komunale, janë këto: Komuna e Kriva Pallankës ka 1.96 pikë nga 2.5 pikët e mundshme, pastaj vijon Kumanova me 1.07. Mesatarja e këtij dimensionit është 0.89, ndërsa komunat me renditjen më të dobët Likova dhe Nagoriçani i Vjetër kanë arritur rezultatet prej 0.18, gjegjësisht 0.36 pikë.

Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit verilindor në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënese komunale



Komuna e Kumanovës ka nevojë për përmirësim të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së administratës komunale. Para të gjithash, e drejta e qytetarëve për ankesa dhe parashtrës nuk realizohet lehtë, e as nuk mund të realizohet e drejta e qasjes së lirë deri te informacionet e karakterit publik për shkak të mungesës së informacioneve në faqet dhe buletinet e komunave. Komuna nuk ka publikuar Kodin e Etikës.

Kur bëhet fjalë për llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e komunave, komuna e Kriva Pallankës është para komunave të hetuara të rajonit. Edhe pse komuna nuk ka miratuar një procedurë për organizimin e konsultimeve me opinion, megjithatë rregullisht mban konsultime publike me opinionin dhe bën vlerësime të nevojave të bashkësisë lokale.

Dhe gjithsesi, disponueshmëria e formularëve dhe procedura e detajuar për parashtrimin


e ankesave, parashtrësve dhe lavdërimeve lehtëson në masë të madhe funksionimin e qytetarëve.

E drejta për qasjen e lirë deri te informacionet e karakterit publik është tërësisht e rregulluar dhe realizohet. Megjithatë, kodi i etikës i komunës nuk është në dispozicion, gjegjësisht nuk është publikuar në një vend të dukshëm në komunë dhe as nuk është publikuar në faqen e internetit të komunës.

Rezultatet e këtij dimensionit për Komunën e Nagorizanit të Vjetër janë shumë të dobëta dhe nevojitet të punohet në të gjitha segmentet për t'u rritur përgjegjshmëria dhe llogaridhënia e administratës komunale. Para së gjithash, është e nevojshme për të lehtësuar të drejtën e ankesave dhe parashtrësve, disponueshmërinë e informacioneve në dërrasën e shpalljeve si dhe qasjen deri te informacionet e karakterit publik.

Sipas rezultateve të dimensionit të katërt, i cili mat Efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, më shumë pikë ka Komuna e Kriva Pallankës – 1.75. Mesatarja e këtij dimensionit është 1.09, ndërsa rezultatit më të dobët e ka Komuna e Nagoriçanit të Vjetër me asnjë indikator të përmbushur. Kumanova ka 1.31 pikë, kurse Likova ka 1.31 pikë.

Grafiku 7: Rezultatet e komunave të Rajonit verilindor në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e qeverisjes lokale



Të dhënat e pikëve të dimensionit të katërt të të gjitha komunat tregon domosdoshmërinë e përmirësimit. Vetëm komunat urbane publikojnë buxhetet komunale, për dallim nga komunat rurale të cilat nuk kanë asnjë informacion mbi këto të dhëna. Për më tepër, këto të dhëna nuk janë mjaftë të qarta, gjegjësisht janë vetëm sipërfaqësore dhe të pakuptueshme për qytetarët e rëndomtë, dhe në të njëjtën kohë nuk kemi shpërndarjen e këtyre mjeteve në përsëritje dhe si shpenzohen ato në kuadër të programeve vjetore të punës.

Konkluzioni

Transparenca dhe llogaridhënia e komunave të Kumanovës, Kriva Pallankës, Nagoriçanit të Vjetër dhe Likovës është në kuadër të zonës së kuqe, më saktësisht ky rajon ka nevojë për ndryshime të mëdha në lidhje me punën, edhe atë në drejtim të të gjitha dimensioneve.

Duket se komunat ende funksionojë pa qenë mjaftë të vetëdijshme për "mbylljen" e tyre apo ato nuk janë në dispozicion të qytetarëve të rëndomtë. Dërrasat e shpalljeve nuk janë mjaft të furnizuara me të dhëna të reja, me informacione të shumta dhe më me rëndësi me informacionet e nevojshme për kryerjen më të lehtë të detyrave të tyre dhe realizimin e shërbimeve që ofron komuna.

Këshillat e komunave nuk janë mjaft transparente në punën e tyre, gjegjësisht nuk kanë incizime nga mbledhjet, e as nuk ka raporte për atë që e kanë bërë. Qytetarët nuk kanë pasqyrë për mënyrën e vendimmarrjes dhe rëndësinë e tyre.

Konsultimet me qytetarët dhe vlerësimi i nevojave të bashkësisë lokale nuk bëhen përveç për konsultimet publike për Planet e Përgjithshme Urbanistike (PPU) dhe Planet e Detajuara Urbanistike (PDU), që është paraparë me ligj.

Bashkëpunimi me organizatat e qytetarëve është vetëm në nivelin e memorandumëve që do të thotë se janë bashkëpunime të shkurtra dhe të njehershme, më shpesh të iniciuara nga vetë organizatat e qytetarëve.

Puna me buxhetin duket se është transparente të gjitha katër komunat. Buxhetet dhe llogaritë e miratuara përfundimtare, të cilat janë publikuar, janë të pakuptueshme për qytetarët e rëndomtë, gjegjësisht janë në formën e një dokumenti të cilin vetëm ekonomistët e arsimuar mirë do të mund ta kuptonin.

REKOMANDIMET

Komunat e Rajonit të planifikuar verilindor duhet të jenë të hapura për qytetarët, duhet ta ndryshojnë parullën e qeverisjes së tyre dhe ta miratojnë parullën se komuna është në funksion të qytetarëve dhe ky të jetë një udhëzues për punën.

Dërrasat e shpalljeve dhe disponueshmëria e informacioneve

Të gjitha komunat duhet të krijojnë hapësirë për qytetarët në kuadër të hapësirave të tyre.

-Ku do të informohen, edukohen, do të mësojnë dhe do të ndajnë çdo gjë që po ndodh në komunë.

- Mundësitë të cilat i kanë në komunë, shërbimet, mënyra e kryerjes së shërbimeve, rregulloret e funksionimit të sektorëve në komunë.

- E drejta e qytetarëve, arritja deri te informacionet e karakterit publik, lehtësimi i kërkesave, mënyrat e shpenzimit të parasë publike.

- Si dhe ku të kërkojnë ndihmë, si të falënderohen, sitë nxisin ndryshime dhe përmirësimin e bashkësisë lokale dhe të jetesës në komunë

- Publikimi i kodit të etikës në kuadër të të cilit duhet të funksionojë komuna dhe mbështetja e të njëjtave

- Kriteret për punë dhe masat të cilat ndërmerren për të përmirësuar atë.

- Funksionimi pa miqësi dhe mirëdashje të të gjithë të punësuarve në komunë.

Puna e Këshillave dhe e Kryetarit të Komunës:

- Transparenca në punë dhe vendimmarrja të ngrihet në nivel të lartë
- Njoftimi me kohë për rendin e ditës së mbledhjeve dhe disponueshmëria e materialeve për të njëjtat
- Pasqyrë në shpërndarjen dhe shpenzimin e parasë publike, konsultim me qytetarët dhe

vlerësimi i nevojave të bashkësisë lokale

- Dyer të hapura të Kryetarëve të komunave për qytetarët, të mundësohet një ndjenjë të këndshme dhe një imazh të vërtetë të baballarëve të qyteteve të cilët kujdesen për qytetarët dhe janë të gatshëm për t'i dëgjuar ata
- Rregulla të qarta për mënyrën e punës dhe respektimi i të njëjtave
- Parandalimi i konfliktit të interesit dhe shpallja publike e mënyrës në të cilën bëhet ai
- Monitorimi i punës - rregullat dhe procedurat me të cilat opinioni është njohur

Informimi i opinionit për punën dhe arritjet

- Azhurnimi i rregullt i faqeve të internetit me të gjitha informacionet rreth ngjarjeve

- Publikimi i kriterëve për ndarjen e mjeteve

- Thirrje për konsultime të përhershme publike të qytetarëve dhe respektimi i rekomandimeve të qytetarëve, si dhe pasqyrë në nevojat dhe vlerësimi i realizimit.

Nevojitet një ngritje të tërësishme të vetëdijes së qytetarëve për rolin e tyre dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre në punën e komunës dhe administratës komunale.

Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar të Vardarit

hulumtues: Igor Smilev

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave

Në Rajonin të planifikuar të Vardarit me hulumtimin në kuadër të studimit LOTOS janë përfshirë komunat Veles, Çashkë, Gradsko, Negotinë dhe Llozovë. Sipas selisë së komunave, dy e kanë selinë në një vendbanim urban, ndërsa tri nga komunat selinë e kanë në një vendbanim rural.

Me fillimin zyrtar të hulumtimit LOTOS më 5 maj 2014, kanë filluar edhe aktivitetet në përputhje me kriteret e përcaktuara në takimin e fundit koordinues me organizatat partnere, të mbajtur më 28 prill në Qendrën Kulturore të Maqedonisë (QKM) në Shkup.


E.G. Green Power ka filluar aktivitetet e saja në javën e parë të muajit maj (29 prill-5 maj) kur ishin realizuar kontaktet telefonike me personat përgjegjës në komunat që janë objekt i hulumtimit. Në një bisedë të shkurtër dhe të përzemërt ishte realizuar një takim personal në të cilin u ra dakord që më së voni deri më 15 maj të dorëzohen pyetësorët e përgatitur paraprakisht dhe shkresa për kryetarët e komunave, në të cilën janë objektivat kryesore të hulumtimit. Në takimin me personat përgjegjës u dorëzua një pjesë e materialeve informative për promocionin shtesë të aktiviteve.

Në afatin e dhënë deri më 30.05.2014, Komunat Velesit dhe ajo e Llozovës e kanë kthyer pyetësorin e plotësuar. Megjithatë, duhet të theksohet se pyetësori i Komunës së Velesit është marrë pjesërisht i plotësuar. Pyetësorët e komunave të tjera janë dërguar pas disa

intervenimeve dhe paralajmërimeve tona gjatë muajve qershor dhe gusht.

Në frymën e hapjes dhe transparencës (dy parimet të cilat i kërkojmë nga komunat), dhe për shkak të relevancës, cilësisë dhe objektivitetit më të madh, hulumtimin do të kryejnë tre hulumtues - hulumtuesi kryesor do të vendosë kontakt të drejtpërdrejtë me secilin nga personat përgjegjës gjatë pranim-dorëzimit të pyetësorëve, ndërsa hulumtuesi i dytë do të mbikëqyrë gjendjen në terren (dërrasën e shpalljeve, mënyrën e komunikimit të të punësuarve me qytetarët, hapjen e komunës, ditët e pranimet). Hulumtuesi i tretë do të kryejë monitorim të vazhdueshëm të faqeve të internetit (desk research) dhe do ta harmonizojë afatin kohor për shkak të realizimit të suksesshëm të indikatorëve. Paralelisht, të tre hulumtuesit do të marrin pjesë në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe në shkrimin e raporteve të rregullta mujore dhe ditore deri te Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave.

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e Rajonit të Vardarit



Disponueshmëria e burimeve të informacioneve mund të shihet nga tabela e mësipërme. Statutet dhe buxhetet e komunave ishin në dispozicion të 80% të komunave, apo të 4 nga 5 komunat, ndërsa rregulloren e kishim në dispozicion si një burim informacioni 60% të komunave, gjegjësisht 3 nga 5 komunat. Secila nga të dhënat është kontrolluar nga të paktën tre burime të informacioneve për të vërtetuar besueshmëria e të dhënave. Megjithatë, duhet të theksohet se mbledhja e të dhënave në masë të madhe varet nga disponueshmëria e materialeve për hulumtuesit, kështu që mund të ndodhë që ndonjë e dhënë gjegjësisht ndonjë indikator të jetë i përmbushur, por të mos jetë i vërejtur nga ana e hulumtuesve. Për këtë qëllim, komunave u janë dhënë rezultatet në shqyrtim, dhe është dhënë afat prej 5 ditësh për të dërguar dëshmi për përmbushjen e ndonjë prej indikatorëve. Pas këtij afati, për indikatorët për të cilët nuk kishim dëshmi i kemi vlerësuar me 0 pikë.


Për rezultatet e dërguara në shqyrtim, vetëm Komuna e Velesit dhe ajo e Gradskos dhanë përgjigje kthyesë. Në rastin e Velesit, pas materialeve të dërguara, rezultatet kanë ndryshuar në mënyrë drastike sepse në fillim të hulumtimit kanë dërguar pyetësorin pjesërisht të përmbushur. Kjo praktikë është në frymën e hulumtimit LOTOS, i cili nis nga qasja se listën me indikatorë komuna mund ta përdorë për të përmirësuar qeverisjen e mirë dhe në mes të dy cikleve të hulumtimit.

2. Rezultatet e hulumtimit


2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin e Vardarit

Në Rajonin e Vardarit, rezultatet e përgjithshme më të mira i ka arritur Komuna e Velesit me 7.95 pikë të fituara, e pastaj vijojnë Negotinën me 4.72, Çashkën me 3.08, Llozovën me 1.41 dhe Komuna Gradsko me 0.93. Mesatarja e këtij rajoni është pak më e ulët se mesatarja e të gjitha komunave dhe është 3.63. Në mesin e komunave të këtij rajoni, vetëm Komuna e Velesit ka kaluar pragun e 50% të përmbushjes së indikatorëve të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Grafiku 2. Rezultatet e komunave të Rajonit të Vardarit në krahasim me mesataren e përgjithshme dhe rajonale



Grafiku 3: Rezultatet në krahasim me numrin e banorëve



Në aspektin e korrelacionit midis numrit të banorëve dhe zbatimit të praktikave të qeverisjes së mirë, nga grafiku më lart mund të shihet se vija e numrit të banorëve ndjek vijën e rezultateve të arritura në studimin LOTOS 2014. Nga ky korrelacion konfirmohet teza se rezultatet më të mira në lidhje me praktikën e qeverisjes së mirë realizojnë komunat me numrin më të madh të banorëve, selitë e të cilave gjenden në zonat urbane.

Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:

Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal


Komuna		Klasifikimi	Shkalla e qeverisjes së mirë
		Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
Veles	7,95	Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
		Qeveris mirë	5.51-7.50
Negotinë	4,72	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
Çashkë	3,08	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
Llozovë	1,41	Qeveris shumë keq	0.0-1.50
Gradsko	0,93		

Sipas klasifikimit të qeverisjes së mirë në nivel lokal, asnjë nga komunat në Rajonin e Vardarit nuk gjendet në grupin e komunave që qeverisin në mënyrë të shkëlqyeshme. Në grupin e komunave që qeverisin shumë mirë është Komuna e Velesit, kurse Komuna e Negotinës është në grupin e komunave që qeverisin mirë. Komuna e Çashkës është në grupin e komunave që nuk qeverisin mjaft mirë, ndërsa komuna e Llozovës dhe ajo e Gradskos janë në grupin e komunave që qeverisin shumë keq.

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Rezultatin më të mirë në dimensionin e parë - **Hapja dhe transparenca** gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, nga komunat e këtij rajoni ka arritur Komuna e Velesit me 1.13 pikë, kurse pastaj vijojnë komuna e Çashkës me 0.61 pikë, ajo e Negotinës me 0.38, ajo e Llozovës me 0.24 dhe Komuna Gradsko me 0,10 pikë. Rezultati mesatar i këtij dimensionin për komunat e Rajonit të Vardarit është 0.49, që është një mesatare relativisht e ulët nëse merret në konsideratë se mesatarja e këtij dimensionin në mes të 43 komunave është 0.54. Pastaj, kjo do të thotë se vetëm Komuna e Velesit e ka kaluar pragun e notës kaluese prej 50% të përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionin ose 0.75.


Grafiku 4: Rezultatet e komunave të Rajonit të Vardarit në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale



Analiza e indikatorëve të këtij dimensionit tregon se komunat e këtij rajoni, të cilat janë të përfshira me hulumtimin ballafaqohen me sfida të caktuara në lidhje me përmbushjen e disa prej praktikave të qeverisjes së mirë. Kështu, përveç në Veles, në asnjë nga komunat e tjera nuk mbahen kolegji me kryetari i komunës. Procedura për ndjekjen e mbledhjeve të këshillit nga ana e qytetarëve është e definuar në një nga pesë komunat, dhe po ashtu vetëm në Veles qytetarët informohen me kohë për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit. Procesverbalet nuk janë në dispozicion në asnjë komunë, kurse mbajtja e pyetjeve të këshilltarëve para se të përcaktohet rendi i ditës është rregulluar vetëm në një komunë – në Komunën e Velesit.

Në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve) rezultatet më të mira i ka arritur Komuna e Velesit me 1.36 pikë, e pas saj vijon Komuna e Negotinës me 0.45 pikë. Mesatarja e këtij dimensionit në mes të komunave është 0.41, që është nën mesataren në kuadër të hulumtimit, e cila është 0.57.

Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit të Vardarit në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)




Sipas analizës së përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionit, një nga pikët më të dobëta të komunave të këtij rajoni është publikimi i kriterëve për ndarjen e mjeteve financiare për organizatat e qytetarëve.

Pastaj, vetëm një nga komunat ka publikuar listën e organizatave të qytetarëve që kanë marrë mbështetje financiare nga komuna për vitin paraprak.

Ftesa deri te organizatat e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, sipas informacioneve tona nga hulumtimi, kanë dërguar vetëm komuna e Velesit dhe ajo e Llozovës.

Rezultatet e komunave të Rajonit të Vardarit për dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale, janë këto: Komuna e Negotinës ka 2.14 pikë nga 2.5 pikët e mundshme, pastaj vijon Velesi me 1.96. Mesatarja e këtij dimensionit është 1.14, ndërsa komuna me renditjen më të dobët është Llozova dhe ka arritur rezultatin prej 0.18.

Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit të Vardarit në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale




Në bazë të analizës së përmbushjes së indikatorëve, me përqindje më të dobët të përmbushjes është indikator i cili mat nëse komuna ka një procedurë për konsultime me opinion, ku vetëm Komuna e Velesit e ka përmbushur këtë indikator.

Indikatorët e tjerë të këtij dimensionit janë përmbushur në 2/5 e rasteve. Kështu, në lidhje me përgjegjshmërinë e administratës lokale, vetëm dy komuna kanë një mekanizëm për procedimin e ankesave të qytetarëve në lidhje me ndonjë shërbim që e siguron komuna.

Kodin e Etikës, i cili është publikuar në një vend të dukshëm në komunë, e kanë vetëm Komuna e Zashkë dhe ajo e Negotinës.

Sipas rezultateve të dimensionit të katërt i cili mat **Efektivitetin**, efikasitetin dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, më shumë pikë ka Komuna e Velesit - 3.50, ndërsa Komuna Gradsko nuk ka përmbushur asnjë indikator të këtij dimensionit, gjegjësisht nuk ka fituar asnjë pikë. Mesatarja e këtij dimensionit është 1.58, komuna e Çashkës dhe ajo e Negotinës kanë rezultatin prej 1.75, që është gjysma e indikatorëve të këtij dimensionit.

Grafiku 7: Rezultatet e komunave të Rajonit të Vardarit në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e qeverisjes lokale



Të dhënat e pikëve të marra me analizën e përmbushjes së indikatorëve në kuadër të dimensionit të katërt tek të gjitha komunat tregon se ka ende hapësirë për përmirësim. Vetëm dy komuna publikojnë rebalancin e buxhetit të komunave.

Në krahasim me komunat e tjera në të cilat është zbatuar hulumtimi, 4 komuna të këtij rajoni kanë publikuar llogarinë përfundimtare për vitin paraprak. Një pjesë e madhe e të dhënave për punën financiare të komunave nuk janë publikuar ose nuk janë mjaft të qarta dhe nuk kemi informacione për shpërndarjen e këtyre mjeteve nëpër sektorët dhe se si shpenzohen të njëjtat në kuadër të programeve vjetore të punës.

REKOMANDIME

Rekomandimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me të gjitha katër komunat e Rajonit të Vardarit janë:

- 1- Komunat duhet të miratojnë rregulloret dhe planet për transparencë në punë me të cilat do të rregullojnë formalisht mënyrën e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të organizatave të qytetarëve në punën e këshillit të komunës dhe në organet e krijuara nga këshilli.
- 2- Definimi i pyetjeve të këshilltarëve në kuadër të statutit dhe rregulloreve për punën e

këshillit dhe mbajtja e tyre para miratimit të rendit të ditës së mbledhjeve

- 3- Publikimi i informacioneve për punën e Komisioneve të themeluara nga ana e komunës
- 4- Komunat domosdoshmërisht të fillojnë me publikimin e marrëveshjeve të prokurimit publik në faqet e internetit të komunave.
- 5- Komuna t'i publikojnë shpalljet për punësimet e realizuara si dhe marrëveshjet e lidhura për punësim të cilat realizohen në komunë
- 6- Komunat të zhvillojnë mekanizma për konsultime të qytetarëve për procesin e vendimmarrjes

Komuna e Çashkës

- 7- Komuna ta informojë opinionin në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes së Këshillit
- 8- Të publikohen procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit
- 9- Të definohen pyetjet e këshilltarëve me aktet e komunës dhe të njëjtat të mbahen para miratimit të rendit të ditës të mbledhjes së re
- 10- Marrëveshjet e prokurimit publik të publikohen publikisht (në faqen e internetit të komunës)
- 11- Të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara
- 12- Të përdoren mekanizmat për konsultime me opinion çdoherë kur ajo është e mundshme.

Komuna e Negotinës

- 13- Komuna të miratojë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- 14- Personi për marrëdhënie me opinion të jetë funksional, gjegjësisht të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre
- 15- Të publikohet rendi i ditës për mbledhjet e këshillit të komunës në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes
- 16- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të opinionit
- 17- Buxheti i komunës domosdoshmërisht të jetë në dispozicion dhe të publikohet në faqen e internetit të komunës
- 18- Të publikohen raportet për përparimin e implementimit të politikave në nivel lokal

Komuna e Gradskos

- 19- Komuna të miratojë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- 20- Personi për marrëdhënie me opinion të jetë funksional, gjegjësisht të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre
- 21- Të vendoset një praktikë për mbajtjen e kolegjiemeve te kryetari i komunës me një rend dite të përcaktuar paraprakisht
- 22- Të publikohet rendi i ditës për mbledhjet e këshillit të komunës në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes
- 23- Statuti dhe Rregullorja e punës së Këshillit të jenë në dispozicion të qytetarëve dhe të publikohen në faqen e internetit të komunës
- 24- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të opinionit
- 25- Buxheti i komunës domosdoshmërisht të jetë në dispozicion dhe të publikohet në faqen e internetit të komunës
- 26- Të përmirësohet bashkëpunimi me sektorin civil në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të caktuara
- 27- Të publikohen raportet për përparimin e implementimit të politikave në nivel lokal

28- Llogaria përfundimtare të publikohet në faqen e internetit dhe të jetë në dispozicion me kërkesë të qytetarëve

Komuna e Velesit

29- Të miratohet një plan për transparencë në punën e komunës

30- Të vendoset një praktikë për mbajtjen e kolegjiemeve me udhëheqësit e sektorëve të kryetari i komunës sipas një agjende të përcaktuar paraprakisht

31- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të qytetarëve dhe të publikohen në faqen e internetit

32- Buxheti të përpilohet dhe të publikohet në një formë të kuptueshme për qytetarët e rëndomtë

Komuna e Llozovës

33- Komuna të miratojë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës

34- Personi për marrëdhënie me opinion të jetë funksional, gjegjësisht të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre

35- Të vendoset një praktikë për mbajtjen e kolegjiemeve të kryetari i komunës me një rend dite të përcaktuar paraprakisht

36- Të publikohet rendi i ditës për mbledhjet e këshillit të komunës në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes

37- Rregullorja e punës së këshillit të jenë në dispozicion të qytetarëve dhe të publikohen në faqen e internetit të komunës

38- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të opinionit

39- Të përmirësohet bashkëpunimi me sektorin civil në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të caktuara


Të publikohen raporte për përparimin e implementimit të politikave në nivel lokal

dhe blerësit sekretë (telefonata anonime dhe dërgimi i letrave (në emër të qytetarëve).

Hulumtimet dhe përvojat e EHO-së nga puna e deritashme me komunat dhe informatat e marra nga vizitat dhe bisedat e shumta të mbajtura me administratat komunale, tregojnë komunat shpesh dërgojnë edhe informacione të pakontrolluara deri te hulumtuesit dhe për këtë arsye ishte e nevojshme që nëpërmjet hulumtimeve në terren të fitohen të dhëna të besueshme për nevojat e projektit. Ende si një problem dhe vështirësi më e madhe paraqitet nevoja për të gjetur personat e duhur në komunë të cilët do të kenë vullnet për t'ia dërguar hulumtuesit të dhënat e kërkuara. Duke pasur parasysh qasjen e hulumtimit që realizohet në aspektin e qytetarit, gjegjësisht hulumtohet se sa prej informacioneve janë në dispozicion të qytetarëve të rëndomtë, arrihet në konkluzion se duhet të përmirësohet përgjegjshmëria e komunave.

Me dërgimin e letrës dhe pyetësorit, janë vizituar komunat dhe është marrë përshtypja e parë nga vëzhgimi në terren. Me pyetësorët, në të cilët zyrtarët komunalë patën mundësi të jepnin mendimet e tyre për efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, është ardhur deri te informacionet për ekzistencën e procedurave me të cilat garantohet cilësiaepunës së komunës. Edhe pse pyetësorët u dërguan në çdo komunë në të njëjtën periudhë kohore, vetëm dy prej komunave që ishin të përfshira me hulumtimin në Rajonin lindor e kanë përmbyshur dhe e kanë dorëzuar pyetësorin në afatin e paraparë kohor. Te dy komunat e tjera ishte i nevojshëm angazhimi shtesë i hulumtuesit për të marrë pyetësorin e plotësuar.

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e Rajonit lindor



Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar lindor

hulumtues: Juliana Davkova

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave


Hulumtimi në kuadër të studimit LOTOS në Rajonin planifikues lindor është zbatuar në komunat **Shtip, Karbinci, Zërnovc dhe Sveti Nikole**. Këtu duhet të theksohet se Komuna e Sveti Nikoles është analizuar së bashku me komunat e Rajonit lindor, edhe pse gjendet në Rajonin e Vardarit, për shkak të prezantimit të barabartë të komunave rurale dhe urbane për nevojat e hulumtimit, duke pasur parasysh faktin se numri i komunave ishte i kufizuar në 43 komuna.

Procesi i mbledhjes së të dhënave nga Rajoni lindor ka filluar në muajin maj të vitit 2014 dhe ka zgjatur deri në muajin tetor të vitit 2014 dhe që në fillim është realizuar me sfida të caktuara. Lidhur me disponimin e komunave për të marrë pjesë në anketë, përvoja ishte e ndryshme. Fillimisht, komunat kanë pranuar të vizitohen dhe të bëjnë kontakte me personat për marrëdhënie me opinion dhe kryetarët e komunave, por në disa komuna është dashur të intervenohet nga disa herë për të realizuar vizitat.

Për zbatimin e hulumtimit LOTOS dhe mbledhjen e informacioneve për komunat kemi përdorur pyetësorin, hulumtimet në terren - vëzhgimin, hulumtimin sekondar (Desk research)

Siç mund të shihet nga grafiku më lart, gjatë hulumtimit kemi arritur t'i sigurojmë shumicën e burimeve të të dhënave të komunave, përveç buxhetit të Komunës së Karbincit dhe buletineve zyrtare të komunave të Karbincit dhe Zërnovcit. Kjo do të thotë se gjatë kontrollimit të të dhënave, ne mund të konsultonim më shumë burime të informacioneve, por megjithatë disa informacione nuk i kishim në dispozicion.

Grafiku 2. Pjesëmarrja burimeve të informacioneve në hulumtim




Ne kishim në dispozicion të gjitha informacionet e komunave të Sveti Nikoles dhe të Shtipit, ndërsa një burim i informacioneve mungonte nga Komuna e Zërnovcit, kurse dy nga Komuna e Karbincit. Mesatarja e rajonit për pjesëmarrje të burimeve të informacioneve në hulumtim është 89%.

2. Rezultatet e hulumtimit

2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin lindor

Nga komunat e Rajonit të planifikuar lindor, rezultatet e përgjithshme më të mira i ka arritur Komuna e Shtipit (5.99), një rezultat i cili është për 2.46 pikë më i lartë se rezultati i mesatares së përgjithshme, kurse për 2.41 pikë më i lartë se ai i rajonit, i cili është 3.58. Sipas këtyre rezultateve, Komuna e Shtipit është e vetmja komunë në rajonin lindor e cila ka arritur notën kaluese, me tejkalimin e pragut të 5.00. Pas Komunës Shtip, vijojnë komunat Sveti Nikole me 4.88, Karbinci me 2.05 dhe e fundit është Komuna e Zërnovcit me rezultatin e arritur prej 1.33.

Grafiku 3. Rezultatet e komunave të Rajonit lindor në krahasim me mesataren e përgjithshme dhe rajonale




Sipas informacioneve për gjendjen aktuale të marra nga hulumtimi, pothuajse të gjitha aspektet e punës së komunave Shtip, Karbinci, Zërnovci dhe Sveti Nikole ka një hapësirë të madhe për përmirësimin e punës. Hulumtimet, analizat dhe rekomandimet e bëra në kuadër të këtij projekti mbeten që t'u shërbejnë komunave për të përmirësuar punën e tyre, veçanërisht në pjesën e transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies së autoriteteve lokale.

Funksionimi i tërësishëm i komunave duhet të jenë në drejtim të krijimit të kushteve për një jetë më të mirë dhe për rritjen e besimit ndaj autoriteteve lokale. Një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve nuk janë të kënaqur me atë se si autoritetet lokale janë duke punuar në nivel lokal, por edhe nga ajo se sa dhe si merr pjesë bashkësia lokale në procesin e vendimmarrjes dhe në krijimin e politikave.

Niveli i informimit të qytetarëve dhe i llogaridhënies së komunës është një tregues jashtëzakonisht i rëndësishëm i qeverisjes së mirë të vetëqeverisjeve lokale. Një tjetër tregues është edhe mënyra në të cilën qytetarët marrin informacionet për shërbimet e komunave, çmimet e shërbimeve, dokumentet e nevojshme dhe zyrtarët kompetentë.

Profesionalizmi i administratës komunale mbetet një nga sferat më të ndjeshme në qeverisjen lokale. Obligimet për të punuar në mënyrë transparente, llogaridhënese, të përgjegjshme dhe përgjegjëse janë rregulluar me ligjet dhe kodet e etikës. Profesionalizmi i administratës çmohet përmes disa kriterëve të ndryshme, të cilat nuk janë të parapara si një dispozitë ligjore vendimtare, por dalin nga termet e përgjithshme për të punuar në mënyrë profesionale, të përgjegjshme dhe llogaridhënese. Puna profesionale e administratës komunale është më shumë një angazhim i përditshëm, një punë e mirë dhe e ndershme sesa respektimi i disa dispozitave konkrete ligjore.

Grafiku 4: Rezultatet në krahasim me numrin e banorëve



Nga grafiku i mësipërm mund të shihen trendet e rezultateve me numrin e banorëve të komunës. Kështu, mund të vërehet se rritja e numrit të banorëve e ndjek rritjen e rezultatit të komunës. Edhe në këtë rast konfirmohet teza se komunat urbane me një numër më të madh të banorëve në krahasim me komunat e rajonit janë më të mira në implementimin e praktikave të qeverisjes së mirë. Kjo është kryesisht për shkak të qasjes më të mirë deri te resurset njerëzore dhe materiale, aspektit kualitativ dhe kuantitativ, si dhe të zhvillimit më të mirë të infrastrukturës së komunës. Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:

Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal


Komuna		Klasifikimi	Shkalla e qeverisjes së mirë
		Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
		Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
Shtip	5.99	Qeveris mirë	5.51-7.50
Radovis	4.88	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
Karbinci	2.05	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
Zrnovci	1.33	Qeveris shumë keq	0.0-1.50

Sipas klasifikimit që bazohet në shkallën e transparencës, asnjë nga komunat nuk është në grupin e komunave me transparencë të fortë. Komuna e Shtipit është në grupin e verdhë të komunave që qeverisin mirë, Radovishi gjendet në grupin komunave që nuk qeverisin mjaft mirë, Komuna e Karbincit është në grupin e komunave që nuk qeverisin mjaft mirë dhe Komuna e Zërnovcit është në grupin e komunave që qeverisin shumë keq.

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Rezultatit më të mirë në dimensionin e parë - Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, nga komunat e këtij rajoni ka arritur Komuna e Shtipit me 0.94 pikë nga 1.5 pikët e mundshme në këtë dimension. Rezultati mesatar i këtij dimensionit për Rajonin lindor është 0.56, që është për vetëm 0.03 më i lartë se mesatarja e 43 komunave. Dy komuna kanë arritur rezultate nën këtë mesatare: Karbinci me 0.34 dhe Zërnovci me 0.27. Komuna e Sveti Nikoles ka 0.70 dhe për 0.05 nuk ka notë kaluese me përmbushjen e 50% të indikatorëve të këtij dimensionit.


Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit lindor në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale



Në aspektin e indikatorëve të këtij dimensionit, vetëm Komuna e Shtipit ka miratuar Planin dhe Rregulloren për transparencë në punën e komunës. Kolegjiumet te kryetari i komunës mbahen vetëm në Shtip dhe Sveti Nikole, ndërsa rendi i ditës botohet vetëm në Komunën e Shtipit. Pyetjet e këshilltarëve janë të rregulluara në Sveti Nikole, Zërnovc dhe Karabinci, kurse vetëm në Shtip nuk është paraparë që ato të mbahen në fillim të mbledhjeve. Pastaj, buxheti i komunave është në dispozicion në të gjitha komunat, përveç në komunën e Karbincit. Nga hulumtimi mund të shihet se të gjitha komunat publikojnë llogaritë financiare, kurse vetëm Komuna e Shtipit publikon dokumentet financiare në një formë të kuptueshme për qytetarët e rëndomtë.

Në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)rezultatet më të mira përsëri i ka arritur Komuna e Shtipit me 1.14 pikë, kurse pas saj vijon Komuna e Sveti Nikoles me 1.02 pikë, ndërsa komunat Karbinci dhe Zërnovc mbeten me nga 0.45, gjegjësisht 0.34 pikë. Mesatarja e këtij dimensionit në mes të komunave është 0.74, që është mbi mesataren në kuadër të hulumtimit,e cila është 0.57.

Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit lindor në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)




Hulumtimi ka treguar se në katër komunat ekziston një shkallë të lartë të mospjesëmarrjes së qytetarëve dhe të shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në zbatimin e politikave lokale. Prezenca e qytetarëve në mbledhjet e Këshillit dhe pjesëmarrja e tyre në përgatitjen e buxhetit të komunës është e dobët. Nga ana tjetër, nuk ka përpjekje nga ana e komunës për të organizuar konsultime publike me qytetarët dhe për t'i inkurajuar ata për të

vepruar në mënyrë aktive në komunë.

Rezultatet e komunave të Rajonit lindor për dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënese komunale, janë këto: Komuna e Shtipit ka arritur 1.96 pikë nga 2.5 pikët e mundshme, pastaj vijojnë Komuna e Sveti Nikoles me 1.61 dhe Komuna e Karbincit me 1.25, ndërsa e fundit është Komuna e Zërnovcit me 0.71. Sipas këtyre rezultateve, Shtipi, Sveti Nikole dhe Karbinci tejkalojnë prapun e 1.25 pikëve për të marrë një notë kaluese në hulumtim.


Grafiku 7:Rezultatet e komunave të Rajonit lindor në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënese komunale



Në këtë dimension, vetëm në Komunën e Zërnovcit nuk mbahen konsultime publike me qytetarët dhe nuk bëhet vlerësime për nevojat e qytetarëve, si një formë e përfshirjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. E drejta për parashtrim të ankesave dhe parashtrësive deri te administrata komunale nuk është e rregulluar në asnjë nga komunat, kurse formularët për kërkesat e qytetarëve janë në dispozicion vetëm në Komunën e Shtipit.

Sipas rezultateve të dimensionit të katërt, i cili mat Efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale,më shumë pikë ka Komuna e Shtipit – 2.19. Mesatarja e këtij dimensionit është 0.88 pikë për të cilat më së shumti kontribuojnë komunat e Karbincit dhe të Zërnovcit me 0 pikë të fituara.

Grafiku8: Rezultatet e komunave të Rajonit lindor në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e qeverisjes lokale



Në këtë dimension, asnjë nga komunat nuk publikojnë publikisht programin vjetor nëpër sektorët dhe asnjë nga komunat nuk ka publikuar të dhëna për organet e monitorimit të autoriteteve lokale.

Vetëm komunat e Shtipit dhe të Sveti Nikoles kanë publikuar llogaritë përfundimtare, ndërsa vetëm Komuna e Shtipit ka përcaktuar buxhetin për secilin aktivitet të planifikuar.

REKOMANDIMET

Për secilën nga komunat e përfshira në projekt janë përgatitur rekomandime konkrete për përmirësimin e transparencës së qeverisë lokale. Zbatimi i këtyre rekomandimeve mund ta avancojë qeverisjen lokale në aspektin e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së autoriteteve lokale dhe të mundësojë një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve dhe të bashkësisë në procesin e krijimit të politikave lokale.

Sfidat më të mëdha në këtë sferë mbeten trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve, konflikti i interesave dhe profesionalizmi i administratës komunale në përgjithësi.

Rekomandimet e mëposhtme dalin si rezultat i hulumtimit për vlerësimin e gjendjeve në komunat përkatëse dhe hulumtimet në terren.

Në përgjithësi ekziston një praktikë dhe një mënyrë e vendosure punës së administratës komunale dhe një mënyrë në të cilën janë rregulluar dokumentet komunale, të cilat nuk janë mjaftë transparente dhe llogaridhënëse. Rekomandimet e mëposhtme kanë të bëjnë me të gjitha komunat.

- Në aspektin e njoftimit të opinionit, është e nevojshme që komunat ta ndryshojnë praktikën e mos-njoftimit të opinionit për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit të komunës në të njëjtën kohë (në të njëjtën ditë) me këshilltarët në mënyrë që do ta informojë opinionin për mbajtjen e mbledhjeve në të njëjtën kohë me këshilltarët, dhe më së paku 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes, nëpërmjet dërrasës së shpalljeve, faqes së internetit dhe/ose nëpërmjet mjeteve të tjera të informimit. Ky rekomandim vlen edhe për publikimin e rendit të ditës dhe të materialeve të punës për mbledhjen e këshillit të komunës në të njëjtën kohë kur ai është dërguar deri te këshilltarët, kurse më së paku 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes, nëpërmjet dërrasës së shpalljeve, faqes së internetit dhe/ose nëpërmjet mjeteve të tjera të informimit, me qëllim që të njëjtat me kohë të jenë në dispozicion të qytetarëve.
- Nevojitet që Këshilli i komunës të miratojë një Rregullore për transparencë në punën e komunës në të cilën janë definuar, rregulluar dhe sistematizuar procedurat e ngritjes së transparencës së komunës. Gjithashtu, është e nevojshme të miratohet një plan për transparencë në punën e komunës në të cilin janë operacionalizuar procedurat e transparencës në punën e komunës.
- Në aspektin e procesverbaleve të miratuara nga mbledhjet e Këshillit të komunës, rekomandohet që të publikohen të gjitha procesverbalet e miratuara drejtpërdrejt në faqen e internetit të komunës dhe në dërrasën e shpalljeve të komunës ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme që do t'i bëjë të jenë në dispozicion të opinionit.
- Te raportet financiare, është e nevojshme që komunat të publikojnë për opinion një dokument me informacione shpesh, gjegjësisht me llogarinë përfundimtare për vitin e fundit me informacione të kuptueshme për qytetarët lidhur me atë se si shpenzohen financat publike lokale.
- Të përpilohet dhe të zbatohet një procedurë për procesin e konsultimeve me opinion gjatë përgatitjes dhe miratimit të buxhetit të komunës dhe të dokumenteve të tjera strategjike.
- Marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik duhet të publikohen rregullisht në faqen e internetit të komunës.
- Rekomandohet që komunat të përgatisin dhe të publikojnë në faqet e tyre të internetit, në dërrasën e shpalljeve ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme një dokument me informacione mbi buxhetin e komunës për çdo vit në formë të kuptueshme për qytetarët e rëndomtë, me informacione dhe shpjegime mjaft të kuptueshme. Për një transparencë më të madhe në këtë drejtim, nevojitet që kriteret dhe shuma e ndarjes së buxhetit të komunës për transferimet e fondeve nga institucionet kombëtare në ato lokale të publikohen në faqen e internetit të komunës.
- Në aspektin e punësimeve komunale, komunat duhet t'i publikojnë në faqet e tyre të internetit si shpalljet ashtu edhe vendimet e punësimit.
- Në pjesën e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale duhet që komunat të dërgojnë rregullisht ftesat për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit deri te përfaqësuesit e organizatave të qytetarëve.
- Komunat duhet të publikojnë programin vjetor të punës nëpër sektorët në vitin e fundit me një afat të përcaktuar qartë kohor për implementimin dhe indikatorët e suksesit. E njëjta gjë vlen edhe për nevojën e publikimit të buxhetit të paraparë për secilin aktivitet të programit vjetor dhe për publikimin e raporteve për përparimin e implementimit të

aktiviteteve.

- Duhet të publikohen raportet për punën e inspektorëve të cilët kryejnë monitorimin e shërbimeve komunale.

Komuna e Shtipit

- Në aspektin e pyetjeve të këshilltarëve, nevojitet që me rregulloren e punës së Këshillit të komunës të definohet se kur në mbledhjet e Këshillit të komunës mbahen pyetjet e këshilltarëve, dhe do të ishte më mirë sikur ato do të definoheshin në rregulloren dhe do të mbaheshin në fillim të çdo mbledhjeje të Këshillit.
- Edhe pse ka kritere të shkruara për ndarjen e mjeteve financiare nga ana e komunës për shoqatat e qytetarëve në formën e Rregullores dhe të njëjtat janë në dispozicion të opinionit të gjerë në faqen zyrtare të internetit, megjithatë, në faqen e internetit nuk ka një dokument me listën e shoqatave të qytetarëve të cilave u janë ndarë mjete financiare për vitin e fundit, e as nuk është publikuar një listë për atë se cilat organizata të qytetarëve nuk kanë të drejtë të marrin mjete financiare për shkak të konfliktit të interesit.
- Rekomandohet që Komuna e Shtipit t'i ftojë përfaqësuesit e bashkësive lokale me qëllim të njëjtit të marrin pjesë në punën e Këshillit të Komunës së Shtipit.
- Lidhur me të drejtën e ankesave dhe parashtresave nga ana e qytetarëve dhe lidhur me realizimin e kësaj së drejte nga ana e qytetarëve, duhet në dërrasën e shpalljeve dhe në faqen e internetit të komunës të publikohet një informacion për proceset zyrtare me hapa të qartë për parashtrimin e ankesave dhe parashtresave nga ana e qytetarëve, si për shembull të publikohet një formular për ankesat apo për denoncimin e rasteve të korrupsionit, i cili do të jetë në dispozicion të qytetarëve.

Komuna e Sveti Nikoles

- Nuk ka kritere të shkruara për ndarjen e mjeteve financiare nga ana e komunës për shoqatat e qytetarëve në formën e Rregullores dhe në faqen e internetit nuk ka një dokument me listën e shoqatave të qytetarëve të cilave u janë ndarë mjete financiare për vitin e fundit, e as nuk është publikuar një listë për atë se cilat organizata të qytetarëve nuk kanë të drejtë të marrin mjete financiare për shkak të konfliktit të interesit.
- Mbajtja e konsultimeve publike me qytetarët me qëllim që të bëhet një vlerësim të nevojave të bashkësisë lokale dhe kjo do të rezultojë të paktën me një projekt të komunës.

Komuna e Zërnovcit

- Faqja e internetit të komunës të fitojë një karakter më informativ dhe të drejtohet drejt informimit për shërbimet e komunës, kontaktet me administratën komunale dhe kontakt me këshilltarët.
- Ne vende të dukshme në hyrjet e komunës të publikohen kompetencat kryesore të komunës dhe të njësive rajonale të ministrive dhe të agjencive.
- Në faqen e internetit të komunës të publikohet buxheti i komunës për vitin aktual dhe llogaria përfundimtare e vitit të kaluar.
- Nuk ka kritere të shkruara për ndarjen e mjeteve financiare nga ana e komunës për shoqatat e qytetarëve në formën e Rregullores dhe në faqen e internetit nuk ka një dokument me listën e shoqatave të qytetarëve të cilave u janë ndarë mjete financiare për vitin e fundit, e as nuk është publikuar një listë për atë se cilat organizata të qytetarëve nuk kanë të drejtë të marrin mjete financiare për shkak të konfliktit të interesit.
- Komuna të caktojë një person për marrëdhënie me opinion.

Komuna e Karbincit

- Faqja e internetit të komunës të fitojë një karakter më informativ dhe të drejtohet drejt informimit për shërbimet e komunës, kontaktet me administratën komunale dhe kontakt me këshilltarët.
- Ne vende të dukshme në hyrjet e komunës dhe në faqen e internetit të komunës të vendosen lista të shërbimeve që i jep komuna dhe lista të dokumenteve të nevojshme për marrjen e atyre shërbimeve, formularë për shërbimet, afatet në të cilat merren shërbimet, çmimet dhe informacionet për kontakt me zyrtarët kompetentë
- Ne vende të dukshme në hyrjet e komunës të publikohen kompetencat kryesore të komunës dhe të njësive rajonale të ministrive dhe të agjencive.

Në faqen e internetit të komunës të publikohet buxheti i komunës për vitin aktual dhe llogaria përfundimtare e vitit të kaluar.

Analiza e të dhënave për komunat e Rajonit të planifikuar jugperëndimor

hulumtues: Elena Mihajlovska

1. Sfidat gjatë mbledhjes së të dhënave


Gjatë muajit maj Agjencia Lokale për Zhvillim, partner i Qendrës për Hulumtim dhe Krijim të Politikave për këtë projekt e ka filluar hulumtimin për nevojat e hulumtimit "LOTOS" në komunat Ohër, Strugë, Vevçan dhe Qendra Zhupë. Aktivitetet hulumtuese janë realizuar deri në muajin tetor të vitit 2014.

Gjatë dhjetë ditëve të para, nga fillimi i hulumtimit ishin vendosur kontaktet e para me kompetentët për marrëdhënie me opinion në komunat dhe me personat përgjegjës në zyrat e kryetarëve të komunave, të cilët janë njoftuar se komunat e tyre do të përfshihen me hulumtimin tonë, kështu që kërkoja takime me kryetarët e komunave, të cilëve kisha në plan t'ua jap personalisht pyetësorët dhe shkresën.

Por, për shkak të obligimeve, një pjesë e kryetarëve të komunave na kanë caktuar ditë për muajin qershor, një gjë e cila mendoja se do të reflektohet ndaj afati tonë kohor, kështu që me kompetentët e shërbimeve komunale kemi rënë dakord që t'ua dërgoj pyetësorët dhe shkresën në formë elektronike. Pyetësorët u dërguan në komunat më 14.05.2014 dhe është dhënë afat prej 15 ditësh për t'i kthyer pyetësorët të plotësuar. Në formë elektronike i kam marrë pyetësorët me përgjigje nga të gjitha komunat e rajonit tonë që tregon faktin se komunat janë mjaft të përgjegjshme. Pyetësorët janë marrë më 15, 16, 20, 23 dhe 30 maj.

Në muajin maj ka nisur edhe hulumtimi sekondar dhe rishikimi i faqeve të internetit të komunave, dhe është kërkuar nga komunat që të dërgojnë edhe dokumentet për nevojat e hulumtimit, si statutet dhe rregulloret e punës së këshillave të komunave, buxhetet e ngjashme.

Grafiku 1. Përqindja e disponueshmërisë së burimeve të të dhënave për komunat e Rajonit jugperëndimor




Siç mund të shihet nga tabela, të gjitha burimet kryesore të informacioneve janë siguruar për komunat e këtij rajoni. Imazhin pozitiv të komunave e plotëson edhe bashkëpunimi i shkëlqyer të cilin e kemi pasur me komunat gjatë zbatimit të hulumtimit. Kështu, besueshmëria e të dhënave është siguruar nga të paktën tre burime të informacioneve, ndërsa pas ndarjes së pikëve, rezultatet janë dërguar në komunat për t'i kontrolluar dhe nëse mendojnë që përmbushin ndonjë indikator, por kjo nuk është marrë parasysh, që të mund të dërgojnë materiale të cilat do të mbështesin pohimin e tyre. Megjithatë, asnjë nga komunat nuk ka dërguar komente shtesë në afatin e dhënë prej 5 ditësh nga dërgimi i materialeve.

2. Rezultatet e hulumtimit


2.1 Rezultatet e përgjithshme të realizuara në Rajonin jugperëndimor

Në Rajonin jugperëndimor, rezultatet e përgjithshme më të mira i ka arritur Komuna e Ohrit me 7.22 pikë, e pastaj vijnë Komuna e Strugës me 4.49, ajo e Kërçovës me 3.04, ajo e Qendrës Zhupa me 1.85 dhe e fundit është Komuna e Vevçanit me 1.70. Mesatarja e këtij rajoni është diçka mbi mesataren e të gjitha komunave dhe është 3.66. Në mesin e komunave të këtij rajoni, vetëm Komuna e Ohrit ka kaluar prapen 50% të përmbushjes së indikatorëve të qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Grafiku 2. Rezultatet e komunave të Rajonit jugperëndimor në krahasim me mesataren e përgjithshme dhe rajonale



Grafiku 3: Rezultatet në krahasim me numrin e banorëve



Grafiku 3 i krahason rezultatet e arritura në kuadër të hulumtimit LOTOS 2014 me numrin e banorëve në komunat për të hetuar korrelacionin mes këtyre dy parametrave. Nga grafiku shihet se vija në të cilën janë vendosur rezultatet, përveç te Komuna e Strugës e cila në këtë rast është përjashtim, ndjek trendin e vijës së numrit të banorëve, me çka mbështetet teza e rritjes proporcionale të rezultateve të arritura me numrin e banorëve. Numri më i madh i banorëve është i lidhur edhe me numrin më të madh të të punësuarve në komunë, që është në fakt variabili kryesor në këtë korrelacion.

Klasifikimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë duket kështu:

Tabela 1. Grupimi i komunave sipas shkallës së qeverisjes së mirë në nivelin lokal


Komuna		Klasifikimi	Shkalla e qeverisjes së mirë
		Qeveris në mënyrë të shkëlqyeshme	9.51-10.00
		Qeveris shumë mirë	7.51-10.00
Ohër	7.22	Qeveris mirë	5.51-7.50
Strugë	4.49	Qeveris mjaft mirë	3.51-5.50
Kërçovë	3.04	Nuk qeveris mjaft mirë	1.51-3.50
Vevçani	1.70		
Qendër Zhupa	1.85		
		Qeveris shumë keq	0.0-1.50

Sipas klasifikimit të qeverisjes së mirë në nivel lokal, asnjë nga komunat në Rajonin jugperëndimor nuk gjendet në grupin e komunave që qeverisin në mënyrë të shkëlqyeshme ose që qeverisin shumë mirë. Në grupin e komunave që qeverisin shumë mirë është Komuna e Ohrit, kurse Komuna e Strugës është në grupin e komunave që qeverisin mirë. Tri komuna të këtij rajoni gjenden në grupin e komunave që nuk qeverisin mjaft mirë - Kërçova, Vevçani dhe Qendra Zhupa. Kurioziteti është që asnjë nga këto komuna nuk është në grupin e komunave që qeverisin shumë keq.

2.2 Rezultatet sipas dimensioneve

Rezultatin më të mirë në dimensionin e parë- Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale, nga komunat e këtij rajoni ka arritur Komuna e Ohrit me 1.09 pikë, e pastaj vijnë komunat e Strugës (0.51), ajo e Kërçovës (0.48) dhe ajo e Qendrës Zhupa (0.38). Mesatarja e këtij dimensionin për Rajonin jugperëndimor është 0.56, që është pak mbi mesataren e këtij dimensionin në mes të 43 komunave, e cila është 0.54. Pastaj, nga rezultati mund të shihet se vetëm një nga komunat e ka tejkaluar pragun e notës kaluese prej 50% të përmbushjes së indikatorëve të këtij dimensionin ose 0.75.

Grafiku 4: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 1 - Hapja dhe transparenca gjatë punës së Këshillit të Komunës, Kryetarit të komunës dhe administratës komunale




Analiza më e detajuar e indikatorëve të dimensionit të parë zbulon se asnjë nga komunat nuk i publikon marrëveshjet e nënshkruara të prokurimit publik. Pastaj, asnjë nga komunat nuk ka një Plan dhe rregullore për transparenca në punën e komunës.

Kur bëhet fjalë për dokumentet financiare në një formë të kuptueshme për qytetarët e rëndomtë, vetëm Komuna e Ohrit ka publikuar të ashtuquajturin buxheti i qytetarëve, ndërsa e njëjta është situata me publikimin e shpalljeve për punësimet në komunë.

Pyetjet e këshilltarëve janë të rregulluara në aktet e komunave të Ohrit dhe të Qendrës Zhupa, ndërsa tek të tjerat ky institut nuk është i rregulluar me dispozitë që të mbahen në fillim para caktimit të rendit të ditës së mbledhjes së këshillit të komunës.

Në dimensionin e dytë - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve) rezultatet më të mira i ka arritur Komuna e Ohrit me 1.36 pikë, kurse pas saj vijnë komunat e Kërçovës me 1.45 pikë, ajo e Strugës me 0.80. Komuna e Qendrës Zhupa është e parafundit me 0.23 pikë. Në fund është Komuna e Vevçanit me 0.11 pikë. Mesatarja e këtij dimensionin në mes të komunave është 0.73, që është mbi mesataren në kuadër të hulumtimit, e cila është 0.57.

Grafiku 5: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 2 - Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqatave të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe në implementimin e politikave lokale (Bashkëpunimi me qytetarët dhe shoqatat e qytetarëve dhe format e tjera të grupimit të qytetarëve)




Në dimensionin e dytë, komunat e Rajonit jugperëndimor kanë arritur rezultate relativisht solide nëse merret parasysh mesatarja e 43 komunave në këtë dimension. Por, sigurisht se ka vend për përmirësim, kështu që do të themi se ka nevojë të publikohen informacione për komisionet e themeluara në kuadër të komunës, si edhe për organet këshillëdhënëse.

Gjithashtu, sektori civil do të duhej të ishte më shumë i përfshirë në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara për politikën me interes për grupe të ndryshme qëllimore.

Transparenca gjatë ndarjes së mjeteve financiare për shoqatat e qytetarëve po ashtu do të mund të përmirësohej nëpërmjet publikimit të një liste të organizatave të qytetarëve që kanë marrë mjete nga komuna, nëse kuptohet, komuna ka paraparë mjete për të mbështetur sektorin civil.

Rezultatet e komunave të Rajonit jugperëndimor për dimensionin e tretë - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale, janë këto: Komuna e Ohrit ka arritur 2.14 pikë nga 2.5 pikët e mundshme, pastaj vijojnë Komuna e Strugës dhe ajo e Kërçovës me 1.43. Mesatarja e këtij dimensionit është 1.50, kurse me rezultate më të dobëta në këtë dimension janë Komuna e Qendrës Zhupa dhe ajo e Vevçanit me 1.43.


Grafiku 6: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 3 - Administrata e përgjegjshme dhe llogaridhënëse komunale



Lidhur me përgjegjshmërinë e komunave, këtu do të theksojmë se në hulumtimin e komunave më të vogla, të cilat kanë në dispozicion një kapacitet më të vogël të administratës, ato ishin shumë më të hapur për bashkëpunim se komunat më të mëdha. Ndoshta do të duhet të marrin në konsideratë afatin e plotësimit të pyetësorëve, sepse komunat më të vogla e kanë plotësuar për një kohë shumë të shpejtë dhe kjo tregon një shkallë të lartë të përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies.

Sipas rezultateve të dimensionit të katërt, i cili mat Efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien e qeverisjes lokale, më shumë pikë ka Komuna e Ohrit – 2.63. Mesatarja e këtij dimensionit është 0.88 pikë, të cilën e ka arritur vetëm Komuna e Strugës me 1.75, ndërsa madje tri komuna (Kërçova, Vevçani dhe Qendra Zhupa) nuk kanë përmbushur asnjë indikator të këtij dimensionit.

Grafiku 7: Rezultatet e komunave të Rajonit të Shkupit në Dimensionin 4 – Efikasiteti, efektiviteti dhe llogaridhënia e qeverisjes lokale



Madje tri komuna në këtë rajon kanë 0 pikë në këtë dimension. Kjo imponon nevojën për përmirësime urgjente në këtë sferë. Mbi të gjitha, si hap i parë duhet të jetë publikimi i llogarive përfundimtare, si dhe informimi për përparimin e implementimit të politikave me iniciativë të qytetarëve.

Jo më pak e rëndësishme për komunat, në qoftë se kanë vullnet për të avancuar procesin e qeverisjes së mirë përmes implementimit të praktikave të mira, është që të përgatisin programe vjetore të punës nëpër sektorët me një afat kohor për zbatimin e politikave.

REKOMANDIMET

Rekomandimet e përgjithshme për komunat:

- 1- Komunat të miratojnë rregulloret dhe planet për transparencën e punës me të cilat do të rregullojnë formalisht mënyrën e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të organizatave të qytetarëve në punën e këshillit të komunës dhe në organet e krijuara nga këshilli.
- 2- Definimi i pyetjeve të këshilltarëve në kuadër të statutit dhe rregulloreve për punën e këshillit dhe mbajtja e tyre para miratimit të rendit të ditës së mbledhjeve
- 3- Publikimi i informacioneve për punën e Komisioneve të themeluara nga ana e komunës
- 4- Komunat domosdoshmërisht të fillojnë me publikimin e marrëveshjeve të prokurimit publik në faqet e internetit të komunave
- 5- Komuna t'i publikojnë shpalljet për punësimet e realizuara si dhe marrëveshjet e lidhura për punësim që realizohen në komunë

- 6- Komunat të zhvillojnë mekanizma për të konsultuar qytetarët në procesin e vendimmarrjes
- 7- Llogaritë përfundimtare të publikohen në faqen e internetit dhe të jenë në dispozicion me kërkesë të qytetarëve

Komuna e Strugës

- 8- Komuna ta informojë opinionin në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes së Këshillit
- 9- Të definohet procedura e ndjekjes së mbledhjeve të këshillit të komunës dhe të njëjtat të jenë në dispozicion të opinionit
- 10- Të njoftohet opinionin për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit minimum 7 ditë para mbajtjes së tyre
- 11- Të publikohen procesverbalet nga mbledhjet e Këshillit
- 12- Të definohen pyetjet e këshilltarëve me aktet e komunës dhe të njëjtat të mbahen para miratimit të rendit të ditës të mbledhjes së re
- 13- Marrëveshjet e prokurimit publik të publikohen publikisht (në faqen e internetit të komunës)
- 14- Të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara
- 15- Të përdoren më shpesh mekanizmat për konsultime me opinion.

Komuna e Ohrit

- 16- Komuna të miratojë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- 17- Të publikohen marrëveshjet e prokurimit publik dhe të vendosen në faqen e internetit të komunës
- 18- Të publikohet rendi i ditës për mbledhjet e këshillit të komunës në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes
- 19- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të opinionit
- 20- Të publikohet buxheti i komunës në faqen e internetit në një formë të kuptueshme për qytetarët
- 21- Të mundësohet për qytetarët përdorimi i pandërprerë i të drejtave të parashtrimit të ankesave dhe të parashtrësive
- 22- Të publikohen raporte për përparimin e politikave të caktuara (vjetore, tremujore, etj.)

Komuna e Kërçovës

- 23- Komuna të miratojë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- 24- Personi për marrëdhënie me opinion të jetë funksional, gjegjësisht të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre
- 25- Të publikohet rendi i ditës për mbledhjet e këshillit të komunës në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes
- 26- Të definohet dhe të publikohet procedura e ndjekjes së mbledhjeve të këshillit të komunës
- 27- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të opinionit dhe në faqen e internetit të komunës
- 28- Të përmirësohet bashkëpunimi me sektorin civil në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të caktuara

- 29- Të publikohen raporte për përparimin e implementimit të politikave në nivel lokal
- 30- Llogaria përfundimtare të publikohet në faqen e internetit dhe të jetë në dispozicion me kërkesë të qytetarëve
- 31- Për secilin aktivitet të planifikuar të publikohet edhe buxheti i paraparë për realizimin e atij aktiviteti

Komuna e Vevçanit

- 32- Komuna të miratojë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- 33- Personi për marrëdhënie me opinion të jetë funksional, gjegjësisht të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre
- 34- Të publikohet rendi i ditës për mbledhjet e këshillit të komunës në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes
- 35- Të definohet dhe të publikohet procedura e ndjekjes së mbledhjeve të këshillit të komunës
- 36- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të opinionit dhe në faqen e internetit të komunës
- 37- Të përmirësohet bashkëpunimi me sektorin civil në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të caktuara
- 38- Të publikohen raporte për përparimin e implementimit të politikave në nivel lokal
- 39- Llogaria përfundimtare të publikohet në faqen e internetit dhe të jetë në dispozicion me kërkesë të qytetarëve
- 40- Për secilin aktivitet të planifikuar të publikohet edhe buxheti i paraparë për realizimin e atij aktiviteti

Komuna e Qendrës Zhupa

- 41- Komuna të miratojë një plan dhe rregullore për transparencë në punën e komunës
- 42- Personi për marrëdhënie me opinion të jetë funksional, gjegjësisht të jetë në dispozicion të qytetarëve dhe t'u përgjigjet kërkesave të tyre
- 43- Të publikohet rendi i ditës për mbledhjet e këshillit të komunës në afatin e paraparë me ligj prej 7 ditësh para fillimit të mbledhjes
- 44- Të definohet dhe të publikohet procedura e ndjekjes së mbledhjeve të këshillit të komunës
- 45- Procesverbalet nga mbledhjet e këshillit të jenë në dispozicion të opinionit dhe në faqen e internetit të komunës
- 46- Të përmirësohet bashkëpunimi me sektorin civil në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet dërgimit të ftesave deri te palët e interesuara për të marrë pjesë në diskutimin e çështjeve të caktuara
- 47- Të publikohen raporte për përparimin e implementimit të politikave në nivel lokal
- 48- Llogaria përfundimtare të publikohet në faqen e internetit dhe të jetë në dispozicion me kërkesë të qytetarëve

Për secilin aktivitet të planifikuar të publikohet edhe buxheti i paraparë për realizimin e atij aktiviteti

Bibliografia

Beetham, D. (1994), “Parimet kryesore dhe treguesit për një audit demokratik” në Beetham, D. (ed) Definimi dhe matja e demokracisë (Londër, Thousand Oaks, Nju Delhi: SAGE Publications) fq. 25-43

Leftwich, A. (2000), Shkalla e zhvillimit – Mbi supremacinë e Politikave në zhvillim, (Malden: Blackwell Publishers Inc.)

Komisioni Evropian (2001), Qeverisja Evropiane: A White Paper [online] <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52001DC0428&qid=1427373225217&from=EN>

EC (2014) Raporti i progresit për Maqedoninë
 Mioshiq-Lisjak, N. (2005), Duke kërkuar Godonë: Stumimi i praktikave të qeverisjes së mirë në e-qeverisjene e Kroacisë, [online]
http://s3.amazonaws.com/zanran_storage/www.map.hr/ContentPages/43997489.pdf
 MCIC 2014 Raporti për vlerësimin e korupcionit në Maqedoni
 Risteska, M (2013) “Roli i BE-së në promovimin e qeverisjes së mirë në Maqedoni: midis politikëbërjes demokratike dhe zbatimit efektiv të politikave” në Nationalities papers, Vol.41 No.3/2013
 SEELDI (2014), Anti-korupsioni, i plotësuar: Vlerësim nga Evropa jug-lindore

Lista e anekseve që janë në dispozicion në <http://lotos.crpm.org.mk/>:

-Lista e indikatorëve

-Pyetësi

-Shkresa për komunat

Lista e komunave të përfshira me hulumtimin LOTOS